

RAPORTI VJETOR 2019



Të gjitha të drejtat e rezervuara®
Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Kosovski Penzijski Štedni Fond
Kosovo Pension Savings Trust

Botues

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

Botuar

Maj 2020

Të gjitha të drejtat e rezervuara®

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Kosovski Penzijski Štedni Fond
Kosovo Pension Savings Trust

TABELA E PËRMBAJTJES

0

5-16

Treguesit kryesorë
Misioni dhe ambicia
Parathënie

1

21-38

Organizata dhe
financat

2

41-44

Aktivitetet

3

51-60

Investimi i kursimeve
pensionale

4

63-66

Kontribuimi dhe
pensionimet

5

69-80

Demografia
e kontribuuesve

6

83-84

Korniza ligjore

7

Aneks

Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare -
Operacionet

8

Aneks

Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare -
Mjetet Pensionale

PËRMBLEDHJE E TREGUESVE KRYESORË

PERFORMANCA E INVESTIMEVE PËR 10 VJETËT E FUNDIT (KUMULATIVE)

Periudha	1-vjeçare	2-vjeçare	3-vjeçare	4-vjeçare	5-vjeçare	6-vjeçare	7-vjeçare	8-vjeçare	9-vjeçare	10-vjeçare
Kthimi nga investimet (në euro)	160.8 mln	76.0 mln	178.5 mln	243.1 mln	272.6 mln	339.4 mln	410.5 mln	464.7 mln	468.0 mln	494.5 mln

INVESTIMET

	2019	2018
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€1.5106	€1.3875
Rritja/rënia e çmimit të aksionit gjatë vitit	+8.87%	-5.3%
Kthimi bruto nga investimet për vitin	€158,459,907	€-85,406,464
Kthimet e tjera për vitin	€2,300,000	€700,000

MJETET NËN MENAXHIM

	2019	2018
Mjetet neto nën menaxhim në fund të vitit	€1,966,956,583	€1,681,148,925
Rritja neto e mjeteve nën menaxhim për vitin	285,807,658	46,500,870

KONTRIBUTET DHE KONTRIBUESIT

	2019	2018
Kontributet e arkëtuara për vitin	€187,548,325	€173,852,170
Kontributet e arkëtuara prej themelimit	€1,781,446,174	€1,594,824,669
Llogari të reja të hapura gjatë vitit	43,286	35,121
Numri i llogarimbajtësve në fund të vitit	669,973	626,687
Numri i kontribuuesve aktivë gjatë vitit	379,827	344,453

Të gjitha të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë Raport Vjetor, si p.sh.: mjetet neto ose bruto nën menaxhim, kontributet për vitin, ndryshimet në mjetet nën menaxhim; nuk i përfshijnë kontributet e arkëtueshme në vlerë €12.27 mln (2018: €11.35 mln).

PENSIONIMI

	2019	2018
Llogari të reja me tërheqje kursimesh për vitin	7,808	5,435
Vlera e mjeteve të tërhequra për vitin	€52,583,934	€31,347,494
Numri i llogarive me tërheqje prej themelimit	51,755	43,947
Vlera e mjeteve të tërhequra prej themelimit	€203,403,895	€150,819,961

TARIFAT DHE SHPENZIMET

	2019	2018
Tarifat investuese / operacionale gjatë vitit*	0.370% / 0.069%	0.381% / 0.071%
Tarifat e ngarkuara për vitin	€8,235,843	€7,660,347
Shpenzimet investuese për vitin	€4,702,557	€5,743,872
Shpenzimet operacionale për vitin	€1,205,928	€1,158,745

ALOKIMI I MJETEVE DHE SHËRBIMET

	2019	2018
Kontributet e paalokuara në fund të vitit	€2,405,299	€1,293,572
Numri i klientëve të shërbyer gjatë vitit	159,355	161,467
Numri i llogarive në eTrusti	129,960	102,727

*Detajet për tarifën e mbajtura për vitin 2019 shpalosen në pasqyrat financiare, të bashkëngjitura me këtë raport.

INVESTIMET MË 2019

SHËNIM: FKKP-ja nuk mund të garantojë se performanca e investimeve në të ardhmen do të jetë sikurse në të shkuarën. FKKP-ja i investon mjetet e saj nën menaxhim me qëllim që: së pari të ruajë fuqinë blerëse të kursimeve pensionale dhe së dyti për t'ia rritur atyre edhe më shumë vlerën. Sidoqoftë, të gjitha investimet i nënshtrohen një niveli të riskut varësisht prej shkallës së kthimit të synuar. Kjo njësor vlen edhe për investimet e FKKP-së, të cilat i nënshtrohen një sërë risqesh, por pa u kufizuar vetëm në to, sikurse janë: risku valutor, risku i normës së interesit, risku kreditor, risku i çmimit, risku politik, risku i palës tjetër, risku i likuiditetit, risku i derivativave e të tjerë. Më shumë detaje për secilin risk dhe ndërlidhjen e tij sipas secilit fond investues prezantohen në pasqyrat financiare, të bashkëngjitura me këtë raport.

PLASMANI	VLERA E INVESTIMEVE MË 31 DHJETOR 2019	KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR VITIN 2019
Vanguard Investment Series plc Global Stock Index Fund Euro hedged (ISIN: IE00B03HD316)	€47,484,682	€48,969,050
Nordea 1 Stable Return Fund (X) Euro (ISIN: LU0539147214)	€229,047,644	€17,042,015
Nordea 1 Global Stable Equity Fund (X) (ISIN: LU0257969260)	€126,488,567	€28,881,121
BNY Mellon Real Return Fund (X) (ISIN: IE00B504KX99)	€270,436,971	€23,180,606
AXA Global Inflation Linked Bonds (I) Eur (ISIN: LU0227145629)	€29,528,301	€2,074,769
AXA Optimal Income I EUR (ISIN: LU0184635471)	€41,948,627	€5,740,987
Schroders Global Diversified Growth (I) (ISIN: LU0776411141)	€43,638,302	€5,244,959
Amundi Rendement Plus (I2) (ISIN: FRO011027283)	€85,540,345	€7,190,867
BNP Paribas - PDP Parvest Diversified Dynamic (I) (ISIN: LU0102035119)	€111,532,837	€9,763,153
Schroders * International Strategic Bond Euro Hedged (I) (ISIN: LU0201624265)	--	€574,969
Amundi 3M - (I) (ISIN: FRO00703813)	€273,862,765	€-830,703
iShares Core Corp Bond UCITS ETF EUR (ISIN: IE00B3F81R35)	€61,306,550	€-642,957
iShares Edge S&P 500 Minimum Volatility UCITS ETF EUR (ISIN: IE00BYX8XD24)	€50,394,634	€4,532,116
Amundi IS Corporates ETF-C EUR (ISIN: LU1681039647)	€61,168,064	€-792,988
iShares Edge MSCI USA Quality Factor ETF (ISIN: US46432F3394)	€47,680,019	€-29,170
Fletobligacione Qeveria e Republikës së Kosovës	€298,483,698	€5,299,465
Depozitat me afat BKT, NLB, TEB, ISB, PCB, RBK, BPB, BEK	€185,620,151	€2,261,648
GJITHSEJ	€1,964,162,157	€158,459,907

*Në gusht 2019 Bordi Drejtues e ka tërhequr gjithë investimin nga Schroders ISB.

2019

U angazhuan për herë të parë fondet investuese ETF dhe investimet në Kosovë arritën vlerën rekorde prej gati 500 milionë euro.

Kthimi neto për vitin ishte +8.9% ndërsa mjetet nën menaxhim u rritën për 17.0%.

2018

Suksesshëm u përmbyll procesi për përzgjedhjen e një brokeri për investime në ETF. U tërhoq i gjithë investimi nga një aset-menaxher.

Kthimi neto për vitin ishte -5.3% ndërsa mjetet nën menaxhim u rritën për 2.2%.

2017

U funksionalizua njësia e investimeve dhe riskut, dhe u shtua ndjeshëm vëllimi i angazhimit në këtë fushë. U angazhua një fond investues i tregut të parasë.

Kthimi neto për vitin ishte 6.5% dhe mjetet nën menaxhim u rritën për 15.9%.

2017

Rreth 148 mijë pasqyra u dërguan me e-mail. Numri i llogarive në eTrusti arriti në rreth 80 mijë dhe rreth 15 mijë kontribuues ndjekin FKPK-në në rrjetet sociale.

Kontributet e paalokuara u reduktuan në 0.18% të kontributeve të arkëtuara.

2018

Rreth 178 mijë njoftime për pasqyrat e llogarive u dërguan me e-mail. Numri i llogarive në eTrusti arriti në 102 mijë dhe rreth 10 mijë shërbime u ofruan në rrjetet sociale.

Kontributet e paalokuara u reduktuan në 0.08% të kontributeve të arkëtuara.

2019

Numri i llogarive në eTrusti arriti në gati 130 mijë duke përbërë kështu 30% të llogarive aktive për vitin 2019. U vendos në shërbim e-Kiosku, që kontribuuesit ta shtypin vetë pasqyrën kurdo [24/7].

Kontributet e paalokuara u ngritën në 0.14% të kontributeve të arkëtuara.

ANKRONIME

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DPD	Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve, Ministria e Punëve të Brendshme
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
KUVENDI	Kuvendi i Republikës së Kosovës
QEVERIA	Qeveria e Republikës së Kosovës
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BPV	Bruto Prodhimi Vendor (publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
PTF	Programi i Tërheqjes në Faza (i kursimeve pensionale)

PËRKUFIZIME TERMASH

AKSIONE - Instrument financiar që siguron pronësi në kompani, varësisht nga shkalla e investimit.

LETRAT ME VLERË APO FLETOBLINGACIONE - Instrument financiar i emetuar nga një qeveri ose korporatë, dhe me afat të caktuar të maturimit, që zakonisht paguan në afate të caktuara një shumë të bazuar në kamata fikse ose fleksibile.

MULTI ASETE - Fonde investuese që kanë në përbërje një përzjerje të instrumenteve në klasat e asetëve kryesore financiare (aksione, bono dhe para e gatshme).

RREZIK INVESTUES - Nënkupton gjasat ose mundësitë që të pësohen humbje nga investimi i ndërmarrë kundrejt një niveli të caktuar të fitimit.

BENÇMARK - Një nivel standard referues për ta krahasuar dhe analizuar performancën e investimeve. FKPK-ja e ka si bençmark indeksin e çmimeve të konsumit të Kosovë, që ndryshe njihet si niveli i inflacionit në vend.

KONTRIBUT I DEFINUAR - Është një plan i përcaktuar i kontribuimit, ku kontributet fikse paguhën në një llogari individuale nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Më pas ato kontribute investohen dhe kthimet nga investimet (pozitive ose negative) i kreditohen llogarisë individuale. Në momentin e pensionimit kjo llogari përdoret për të ofruar përfitimin pensional, zakonisht përmes blerjes së anuitetit, i cili më pas mundëson të ardhura të rregullta mujore.

SHIFRA PËR 5 VJET

80.8%

MJETET PENSIONALE NETO

17.3%


ÇMIMI I AKSIONIT

€272.6 mln

KTHIMI NGA INVESTIMET

KTHIMI NGA INVESTIMET

RRITJA/RËNIA VJETORE E ÇMIMIT TË NJËSISË




NUMRI I LLOGARIMBAJTËSVE DHE DEMOGRAFIA E KONTRIBUESVE

VITI	NUMRI I LLOGARIMBAJTËSVE			KONTRIBUES AKTIVË					
	LLOGARIVE [A]	MESHKUJ [B]	% [B]/[A]	FEMRA [C]	% [C]/[A]	MESHKUJ [D]	% [E]/[D]	FEMRA [F]	% [F]/[D]
2015	507,963	356,990	70.3%	150,973	29.7%	297,466	69.0%	92,086	31.0%
2016	541,923	377,192	69.6%	164,371	30.4%	312,672	69.2%	99,341	31.8%
2017	591,527	406,815	68.8%	184,712	31.2%	352,849	67.5%	114,844	32.5%
2018	626,687	426,960	67.9%	199,727	32.1%	344,453	66.6%	114,938	33.4%
2019	669,973	450,845	67.3%	219,128	32.7%	379,827	65.5%	131,209	34.5%

MJETET NETO NËN MENAXHIM TË FKPK-SË KUNDREJT BPV-SË VJETORE TË KOSOVËS

	2015	2016	2017	2018	2019
Mjetet neto nën menaxhim	€1,229,333,328	€1,417,970,874	€1,634,648,056	€1,681,148,926	€1,966,956,583
BPV e Kosovës	€5,807,000,000	€6,070,200,000	€6,282,200,000	€6,659,000,000	€7,006,000,000*
Mjetet neto kundrejt BPV së Kosovës	21.2%	23.4%	26.0%	25.2%	28.1%

KONTRIBUTET KUMULATIVE TË PAALOKUARA



RËNIA E KONTRIBUTEVE TË PAALOKUARA SI PËRQINDJE E TOTALIT TË KONTRIBUTEVE

*Më shumë informacione për këtë rënie të jashtëzakonshme të kontributeve të paalokuara më 2019 mund të gjeni në faqen 45 të këtij raporti vjetor.

MJETET E MENAXHUARA NGA FKPK-JA NË FUND TË 2019-S KANË ARRITUR NË

28.1%

TË BPV-SË REALE TË KOSOVËS

*SIPAS VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS PËR TM4 2019

MISIONI DHE AMBICIA

Misioni ynë është t'i investojmë kursimet pensionale dhe t'i administrojmë llogaritë individuale të kontribuuesve deri në pensionimin e tyre.

Ne angazhohemi që misionin tonë ta arrijmë përmes investimeve të matura të mjeteve dhe procese të efektshme administrative.

Ambicia jonë është që të ofrojmë shërbimet më të mira të mundshme për kontribuuesit si dhe të jemi institucioni më i besuar në Kosovë.

Ambicien tonë përpiqemi ta arrijmë përmes profesionalizmit dhe integritetit të stafit si dhe transparencës institucionale.



PARATHËNIE E PËRBASHKËT E KRYESUESIT TË BORDIT DHE DREJTORIT MENAXHUES

I nderuar lexues,

Raporti Vjetor 2019, së bashku me pasqyrat financiare të bashkëngjitura, është publikimi vjetor më i rëndësishëm i institucionit, përmes të cilit shpalosim çështjet më kryesore të investimeve dhe operacioneve për vitin.

2019-shi ishte një vit tejet pozitiv i ngritjes, ku kthimi bruto nga investimet [prej +161 milionë euro] e kishte fjalën kryesore. Në vlerë nominale ky është edhe kthimi më i lartë ndonjëherë. Ndërsa ngritja e çmimit të njësisë [prej 8.9%] e këtij viti, ishte edhe e dyta më e larta që prej themelimit të FKPK-së - më e larta është e vitit 2009 [me +14.1%]. Nën këto lëvizje, institucioni i mbushi 18 vjet operim, duke i përmbyllur 16 vjet me kthime pozitive dhe vetëm dy [2008 dhe 2018] me kthime negative. Në 18 vjet operim kthimi bruto nga investimet shkoi në 483 milionë euro dhe çmimi i njësisë është ngritur për 51.1%.

FKPK-ja e kishte filluar me një ekspozim të lartë ndaj riskut vitin 2019, meqë korrigjimi i fundvitit 2018 është konsideruar i tepruar. Por më pas, veçanërisht gjatë periudhës maj deri gusht, FKPK-ja ka treguar kujdes të shtuar dhe i ka reduktuar investimet me risk të lartë. Ndërsa në pjesën e fundit të vitit, kemi parë një ambient të përmirësuar ekonomik, me më pak risk të shfaqjes së recesionit ekonomik, me një seri të kënaqshme të fitimeve të korporatave, me relaksim të marrëdhënieve tregtare SHBA-Kinë dhe zbehjen e riskut të ngritjes së normave ose inflacionit.

Nga monitorimi dinamik i pozicionimit të investimeve, FKPK-ja e ka arritur një performancë vjetore [prej 8.9%] gjersa risku i ndërmarrë i portofolit të saj ishte shumë i përmbajtur, me një luhatshmëri vjetore prej 2.3%. Kjo rezultoi në një raport kthim/risk rekord të FKPK-së prej 3.9 [kur aksionet globale patën raport prej 1.6-2.4], duke e përmbushur kështu synimin e maksimizimit të fitimit në raport me riskun e ndërmarrë.

Andaj, Bordi Drejtues, duke pasur parasysh edhe katër parimet themelore, të caktuara me ligj, që janë: i) siguria e mjeteve pensionale, ii) diversifikimi i investimeve, iii) kthimi maksimal në raport me sigurinë e mjeteve pensionale dhe iv) mbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm, vlerëson se institucioni i ka përmbushur kënaqshëm detyrat e vëna. Viti i shkuar kishte ndryshime të rëndësishme edhe në shpërndarjen gjeografike të investimeve. Për herë të parë 25% e investimeve të FKPK-së ishin në Kosovë, duke arritur kështu në 484 milionë euro [2018: 328 milionë euro]. Nga investimet në Kosovë 298 milionë euro ishin në fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës [2018: 209 milionë euro] dhe 186 milionë euro [2018: 119 milionë euro] ishin në depozitat bankare në vend.

Tashmë institucioni ka rreth 1.97 miliardë euro nën menaxhim, që ishte njëherësh edhe rritje rekorde e mjeteve nën menaxhim [prej 286 milionë euro për një vit] dhe përgjegjësia e institucionit për të menaxhuar fondin po rritet shpejt. Për këtë u plotësua gjatë vitit departamenti i investimeve dhe riskut. Por përsëri institucioni vazhdon të ketë një staf të angazhuar prej vetëm 28 vetash, që besojmë është shembull i veçantë në vend.

Sa i përket operacioneve, institucioni vazhdon të kryejë të gjitha detyrat e zakonshme për të ofruar shërbime gjithë kohës e pa ndërprerje, si në zyrën e FKPK-së në Prishtinë, ashtu edhe në zyrat rajonale të ATK-së, përmes zyrtarëve pensionalë. Njëkohësisht numri i shërbimeve online, qoftë përmes portalit eTrusti, qoftë përmes e-mailit dhe rrjeteve sociale po vazhdon të ketë rritje të shpejtë.

Tashmë mbi 140 mijë kontribuues kanë llogari në shërbimin online eTrusti, kurse rreth 18 mijë kontribuues e ndjekin faqen e institucionit në Facebook, ndërsa dhjetëra qytetarë dërgojnë pyetje çdo ditë me e-mail, Facebook ose telefon.

FKPK-ja synon që komunikimi me kontribuuesit të jetë i bazuar në platformat e komunikimit në distancë, si për të ulur koston ashtu edhe rritur eficiencën, përmirësuar shërbimet dhe shtuar ndërveprimin me kontribuuesit. Në asnjë moment institucioni nuk lë anash rëndësinë e menaxhimit të 670 mijë llogarive [që u rrit për 43 mijë më 2019] si dhe ruajtjen e mbrojtjen e të dhënave të tyre.

Me shumë vlerë ishte edhe fakti se Pasqyrat Financiare të FKPK-së vazhduan të jenë plotësisht të pastërta edhe këtë vit, sipas opinionit të Auditorit të Jashtëm, që tregon më së miri gjendjen e zhvillimit profesional dhe teknik e ligjor të institucionit.

Të vetëdijshëm se jo gjithçka mund të përmbledhet në këtë letër, ne inkurajomë që secili i interesuar për institucionin të konsultojë të gjitha raportet [mujaore, tremujore e vjetore], pasqyrat e financiare dhe të gjitha lajmet, vendimet dhe njoftimet e publikuara gjithë kohës në internet.

Duam, për fund, të përgëzojmë përpjekjet e jashtëzakonshme të stafit të FKPK-së si dhe falënderojmë bashkëpunimin korrekt dhe të hapur të BQK-së, ATK-së dhe Kuvendit të Kosovës, të cilët mbajnë nën mbikëqyrje një institucion shumë të ndjeshëm për qytetarët e vendit.

REFLEKTO
PËR
TË ARDHMEN!



01

ORGANIZATA DHE FINANCAT

- 21 - 22 Organizata, Bordi dhe Organogrami
- 23 - 24 Anëtarët e Bordit në fund të vitit
- 25 - 26 Procesi i vendimmarrjes së Bordit Drejtues
- 27 Komisionet e Bordit Drejtues
- 28 - 30 Administrata
- 31 - 33 Mbikëqyrja dhe auditimi
- 34 Financimi
- 35 - 38 Shpenzimet

ORGANIZATA

FKPK-ja është themeluar si institucioni i vetëm për menaxhimin dhe investimin e kontributeve të detyrueshme pensionale të të punësuarve të Kosovës, si dhe për administrimin e llogarive individuale të kursimeve pensionale të kontribuuesve deri në pensionimin e tyre.

FKPK-ja u themelua me Ligj në dhjetor të vitit 2001 si institucion jo-për-profit. Si i tillë, qëllimi i vetëm i FKPK-së është t'i shërbejë vetëm interesit më të mirë të kontribuuesve të saj. FKPK-ja u funksionalizua në tërësi me Bord, Administratë dhe vendosje të proceseve në gusht 2002. Asokohe, Administrata numëronte 22 punonjës dhe kishte pesë njësi. Që nga atëherë, Administrata në mënyrë organike ka evoluar në 28 punonjës dhe tetë njësi.

Gushti i vitit 2002 ishte po ashtu muaji në të cilin u arkëtuan kontributet e para nga punonjësit e sektorit publik. Më 2003, të vetëpunësuarit dhe personat e punësuar në sektorin privat iu bashkangjiten kursimit pensional.

Për herë të parë mjetet pensionale u investuan më 2003 në fonde të parasë së gatshme. Kjo u pasua me investime në aksione më 2004 dhe me investime në fonde që tregtonin me instrumente borxhi më 2006.

Më tej investimet u zgjeruan për të përfshirë fondet multi-asetëshe më 2010, fondet me target riskun më 2011.

Më 2014 e 2015 në portofolin investues u shtuan fondet investuese multi-asetëshe me menaxhim risku, ato të aksioneve me dividend si dhe me menaxhim risku. Më 2017 u rifut në portofol tregu i parasë së gatshme përmes angazhimit të fondit Amundi - 3M I. Më 2018 u përmyll procesi i përzgjedhjes së brokerit për investime në fondet ETF, për t'i dhënë mundësi institucionit kështu më shumë mundësi investuese. Po ashtu për herë të parë FKPK-ja nuk nxori investime të reja jashtë vendit, por tërhoqi nga jashtë.

Në Kosovë investimi i parë ndodhi në depozitat bankare më 2008, ndërsa investimi i parë në fletobligacione afatshkurtra të Qeverisë së Republikës së Kosovës u realizua më 2012. Më 2014 e 2015 u fillua me investimet në fletobligacionet afatmesme (deri në 5 vjet). Më 2017 për herë të parë u investua në fletobligacionet 7-vjeçare. Më 2019 arritën në nivele rekorde investimet në letrat me vlerë të Qeverisë po edhe depozitat bankare, duke shkuar në rreth 500 mln. Këtë vit po ashtu filluan për herë të parë investimet direkte në fondet ETF.

BORDI DREJTUES

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues, anëtarët e të cilit emërohen nga Kuvendi i Kosovës si të mirëbesuarit për mjetet pensionale.


Ligji Nr. 04/L-101 i Republikës së Kosovës për Fondet Pensionale në Kosovë, bashkë me plotësimet dhe ndryshimet e tij [me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116], shtjellon detajisht funksionimin dhe përgjegjësitë e FKPK-së dhe Bordit të tij. Rregullat pensionale të BQK-së nxjerrin legjislacionin dytësor në lidhje me investimin e mjeteve pensionale, matjen e performancës, tërheqjen e kursimeve pensionale dhe kërkesat për raportim të FKPK-së.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit përfshijnë, por nuk kufizohen në: përzgjedhjen ose largimin e menaxhuesve të mjeteve, kujdestarëve, fondeve të hapura për investime si dhe palëve të treta; miratimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; punësimin e personelit ekzekutiv të FKPK-së; miratimin e pasqyrave të FKPK-së.

Bordi mund të ketë shtatë anëtarë me drejtë vote, dhe një anëtar pa të drejtë vote që përfaqëson Qeverinë.

Së paku pesë nga anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë profesionalë, me së paku dhjetë vjet përvojë në fushën e investimeve ose të menaxhimit të fondeve pensionale; së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëmarrësve në Kosovë, dhe së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëdhënësve të Kosovës.

Më 2019 Bordi Drejtues ishte i kompletuar në përbërje, duke pasur pesë anëtarë profesionalë, dy anëtarë përfaqësues dhe një anëtarë të jashtëm në Komisionin e Auditimit, pa të drejtë vote.



ANËTARËT E BORDIT NË FUND TË VITIT



MR.SC. RUZHDI MORINA

Kryesues i Bordit Drejtues, Kryesues i Komisionit për Buxhet si dhe anëtar i Komisionit për Investime

Magjistër i shkencave juridike, drejtimi Ndërkombëtar. Më përvojë të gjatë në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe me eksperiencë të dëshmuar profesionale rreth fondeve pensionale.

ROLI NË BORD:

Profesional

ZGJEDHUR:

Maj 2009

MANDATI AKTUAL:

I katërt



Z. FREDERICK ARTESANI

Kryesues i Komisionit të Investimeve dhe anëtar i Komisionit për Buxhet

Ekonomist dhe këshilltar i pavarur financiar me mbi 36 vjet përvojë në tregjet financiare.

Profesional

Tetor 2008

I katërt



Z. BEHXHET HALITI

Kryesues i Komisionit të Auditimit dhe anëtar i Komisionit të Investimeve

I diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Prishtinës. Prej vitit 2003 është përfshirë në procesin e përpilimit dhe zbatimit të politikave fiskale në Kosovë.

Profesional

Dhjetor 2015

I dytë



Z. HAJDAR KORBI

Anëtar i Komisionit të Investimeve dhe Komisionit të Ankesave

Magjistër i shkencave në Ekonomiks për analizë biznesi nga Universiteti Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar dhe me përvojë mbi 10-vjeçare si lektor i institucionit edukues RIT në Kosovë.

Profesional

Nëntor 2017

I parë



Z. VALDRIN KASUMAJ

Kryesues i Komisionit të Ankesave dhe anëtar i Komisionit të Auditimit

Magjistër i Shkencave Ekonomike në Menaxhment dhe Informatikë, dhe magjistër i Shkencave të Inxhinierisë Mekanike. Me përvojë angazhimi në Odën Ekonomike të Kosovës.

Përfaqësues i punëdhënësve

Nëntor 2017

I parë



PROF. DR. DRITON QEHAJA

Anëtar i Komisionit të Investimeve dhe Komisionit për Buxhet

Profesor i Asociuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gradën e doktorit të shkencave ekonomike dhe sociale.

Profesional

Gusht 2012

I dytë



Z. YMER YMERI

Anëtar i Komisionit të Auditimit dhe Komisionit për Ankesa

I diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-natyrore dhe me titull magjistër i menaxhmentit. Për 15 vjet ka qenë mësues ndërsa prej vitit 2000 është angazhuar në SBASHK.

Përfaqësues i punëmarrësve

Dhjetor 2018

I parë

PROCESI I VENDIMARRJES SË BORDIT DREJTUES PËR INVESTIMET E FKPK-SË

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues, anëtarët e të cilit emërohen nga Kuvendi i Kosovës për administrimin në mirëbesim të mjeteve pensionale. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit përfshijnë, por nuk janë të kufizuara: në adoptimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; definimin e alokimit strategjik të mjeteve për fondet e FKPK-së si dhe përcaktimin e natyrës dhe shumave të çfarëdo ndryshimi në alokim, strategji dhe politikën investuese; përzgjedhjen, monitorimin dhe largimin e instrumenteve të hapura dhe menaxhuesve të mjeteve që zbatojnë strategjinë investuese dhe alokimin e definuar të mjeteve; përzgjedhjen e kujdestarëve të mjeteve dhe palëve të treta; rekrutimin e personelit ekzekutiv të FKPK-së; dhe miratimin e pasqyrave financiare të FKPK-së.

Detyra parësore e Bordit Drejtues të FKPK-së është që të sigurojë që mjetet nën menaxhim janë investuar në mënyrë të kujdesshme dhe në pajtim me kërkesat e Ligjit dhe brenda kornizës së tij të parimeve dhe politikës investuese. Bordi Drejtues e pranon se ka përgjegjësi fiduciare kundrejt pjesëmarrësve dhe përfituesve në FKPK, dhe se do të ndjekë vetëm politikën që nuk e cenon këtë përgjegjësi.

INFORMIMI I BORDIT DREJTUES

Menaxhmenti dhe stafi i FKPK-së i informojnë në baza të rregullta (ditore ose javore - sipas nevojës) anëtarët e Bordit Drejtues me performancën e investimeve të FKPK-së, me gjendjen e kontributeve të pranuar dhe mjeteve të paineduara, me maturimin e investimeve në fletobligacionet e Kosovës dhe depozitat bankare, me ndarjen e investimeve sipas klasave dhe strategjive investuese, dhe e gjithë kjo në raport me ruajtjen e kufijve investues - sipas legjislacionit në fuqi.

INVESTIMI I MJETEVE

Bordi Drejtues merr vendimet e tij fiduciare duke realizuar investimin e të gjitha mjeteve të grumbulluara (dhe kontributeve në vazhdim): për tërheqjen ose përfshirjen e investimeve të reja në fondet e përzgjedhura sipas Parimeve Investuese dhe Politikës së adoptuar, për alokimin e detajuar të mjeteve siç është pasqyruar në matricën e investimeve, për investimet direkte - përfshirë këtu investimet në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës dhe depozitat bankare.

Bordi Drejtues, në pajtim me analizat dhe informacionet e ofruara (përmes stafit dhe menaxhmentit të FKPK-së, por edhe përmes anëtarëve profesionalë në Bord) merr vendime për të shtuar ose hequr investime nga klasat e mjeteve (aksione, multi-asete, tregun e parasë) duke bërë kështu balancimet e nevojshme në linjë me analizat e secilit fond.

Njësia e investimeve dhe riskut, së bashku me Komisionin e Investimeve të Bordit Drejtues, dhe në pajtim me Manualin e Investimeve të FKPK-së, përmes rekomandimeve të ndryshme, duke ngërthyer parashikimet ekonomike, ndryshimet e politikave financiare, ndryshimet e sjelljeve në tregje, publikimeve të rezultateve të kompanive dhe sektorëve dhe çfarëdo faktori tjetër që ndikojnë investimet aktuale ose potenciale, ndihmojnë në menaxhimin aktiv të investimit të mjeteve. Këto rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kthimet nga investimet me risk të menaxhuar, nën mandatin afatgjatë të FKPK-së për investime të kujdesshme në afatgjatë.


Përpara se çfarëdo fondi investues të angazhohet, kalon një kohë e gjatë në procesin e përzgjedhjes (prej thirrjes ndërkombëtare për shprehje të interesit, deri tek studimi dhe intervistimi i detajuar i fondeve të tilla) që përfshin: një analizë të detajuar e matësve të fondit investues dhe indikatorëve të investimit, ashtu sikurse edhe studimin e hollësishëm të parimeve investuese dhe metodologjisë së secilit fond. Një proces i tillë zakonisht kërkon angazhimin e një palë të tretë të specializuar, me një kosto jo të papërfillshme, por në këtë rast FKPK-ja përfiton nga kualifikimet dhe përvoja profesionale e anëtarëve të Bordit të saj që e bëjnë këtë vetë. Në anën tjetër, investimet në Kosovë (në fletobligacione dhe depozita bankare) ndërmerren brenda kornizës së kushteve mbizotëruese të tregut për instrumentet sovraane me të ardhura fikse si dhe vlerësimin e rrezikut relativ të emetuesit.

RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

Bordi Drejtues publikon në uebfaqe të gjitha vendimet e rëndësishme dhe ato që lidhen me investimin e mjeteve, dhe në baza ditore publikohet në uebfaqe performanca e investimeve. Bordi Drejtues dërgon raporte të detajuara (tremujore dhe vjetore) tek institucionet mbikëqyrëse. Për më tepër, anëtarët e Bordit zhvillojnë takime direkte me anëtarët e komisioneve funksionale të Kuvendit të Kosovës, si për të prezantuar performancën e investimeve ashtu edhe për nevojat e institucionit për caktimin e tarifave për financim. E njëjta procedurë vlen edhe për miratimin e raportit vjetor.

FKPK-ja, përmes Menaxhmentit ose Bordit, është e pritshme t'i përgjigjet me transparencë të gjitha kërkesave për informacione të medieve relevante, duke shpalosur në detaje performancën dhe të dhënat e tjera rreth investimeve të FKPK-së.

CIKLI I VENDIMARRJES SË BORDIT DREJTUES



KOMISIONET E BORDIT DREJTUES

Katër komisione të përhershme mbështesin funksionimin dhe vendimmarrjen e Bordit.

KOMISIONI I INVESTIMEVE

Kryesisht shqyrton politikën, parimet dhe strategjinë e investimit të mjeteve pensionale, ashtu sikurse performancën e investimeve dhe fondeve të hapura investuese përmes të cilave FKPK-ja investon mjetet. Komisioni e shqyrton gjithashtu edhe pajtueshmërinë e investimeve me kërkesat ligjore dhe të rregullatorit. Komisioni i bën rekomandime Bordit për investimin dhe tërheqjen e mjeteve pensionale.

KRYESUES:

Frederick Artesani

ANËTARË:

Ruzhdi Morina
Behxhet Haliti
Hajdar Korbi
Driton Qehaja

TAKIME TË MBAJTURA:

Gjashtë

KOMISIONI PËR ANKESA

Shqyrton kërkesat, pretendimet dhe ankesat e kontribuuesve të cilat i drejtohen Bordit ose FKPK-së. Komisioni ia paraqet Bordit rekomandimet dhe siguron që të gjitha rasteve t'iu jepet përgjigje brenda afateve dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

KRYESUES:

Valdrin Kasumaj

ANËTARË:

Hajdar Korbi
Ymer Ymeri

TAKIME TË MBAJTURA:

Gjashtë

KOMISIONI I AUDITIMIT

Në mesin e funksioneve shqyrton raportet e rregullatorit dhe auditorit, dhe i rekomandon Bordit ndërmarrjen e planit të nevojshëm të veprimit për t'i trajtuar gjetjet dhe çështjet. Komisioni po ashtu shqyrton përshtatshmërinë e procedurave të brendshme, dhe në rast nevojë rekomandon ndryshime. Komisioni e shqyrton planin e auditimit për funksionet e auditimit të brendshëm, shqyrton kriteret për auditorin e jashtëm dhe rekomandon adoptimin e tyre nga Bordi.

Behxhet Haliti

Valdrin Kasumaj
Ymer Ymeri

Anëtare e Jashtme:
Mirlinda Ahmeti

Pesë

KOMISIONI PËR BUXHET

Shqyrton nevojat buxhetore të FKPK-së dhe sipas tyre i jep rekomandime Bordit për nivelin e tarifave që duhet të ngarkohen mbi mjetet pensionale. Komisioni gjithashtu i rekomandon Bordit miratimin e buxhetit dhe, kur ka nevojë, ndryshimeve në buxhet. Komisioni po ashtu shqyrton shpenzimet e FKPK-së kundrejt buxhetit.

Ruzhdi Morina

Frederick Artesani
Driton Qehaja

Katër

ADMINISTRATA

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendësdirjtorë: njëri për financa, investime e risk dhe TI e tjetri për operacione dhe burime njerëzore.

Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe moralisht të shëndoshë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të madh, mjedis të shëndoshë pune, dhe përfundimisht, në shërbime më të mira për kontribuuesit; dhe njëkohësisht, të ruhet integriteti institucional i FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi dhe Menaxhmenti, sigurojnë që Administrata aktuale vazhdon t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën e saj, vazhdon të jetë e motivuar, dhe vazhdon të vë në funksion gjithë kapacitetet e saja mendore dhe kadrovike në shërbim të avansimit të proceseve të brendshme dhe shërbimeve për klientë.

Administrata është e ndarë në njësi funksionale për të siguruar efektivitet dhe efikasitet në punë.

Përmirësimi i proceseve administrative, dhënia e ndihmës Bordit Drejtues për analizën e investimeve, si dhe implementimi i vendimeve të Bordit, janë detyrat kryesore të Administratës. Performanca e kësaj të fundit mbikëqyret në vazhdimësi nga Bordi, ndërkaq udhëhiqet në baza ditore e zhvillohet nga Menaxhmenti.

Për vitin 2019 punonjës të përhershëm ishin 27 ndërsa me kontratë për punësim me kohë të pjesshme ishte një (më 2018: 25 të punësuar të përhershëm dhe një i punësuar me orar të pjesshëm).

Gjatë vitit të kaluar po ashtu janë angazhuar, sipas nevojës, edhe studentë, si praktikantë, për t'ju mundësuar krijimin e përvojës profesionale, por edhe për nevojë të shërbimit me klientë dhe departamentit të financave në FKPK.

Punonjësit pjesëtarë të minoriteteve përbënin 7% të fuqisë punëtore (8% të atyre që e kanë deklaruar përkatësinë etnike). Femrat përbënin 30% të fuqisë punëtore (2018: 28%); 85% e stafit ishin më të vjetër se 35 vjet (2018: 84%), dhe 4% e stafit ishin me aftësi të kufizuara fizike të përhershme (2018: 4%).

Me ndryshimet në përbërjen e stafit, moshë mesatare u ul lehtë në 43.7 vjeç (2018: 44.4 vjeç).

MENAXHMENTI

1 DREJTOR MENAXHUES

NJËSIA

SHËRBIMET PËR KLIENTË	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	FINANCAT	INVESTIMET DHE RISKU
-----------------------	-----------------------------	----------	----------------------

PUNONJËS TË PËRHERSHËM

9	4	3	3
---	---	---	---

POZITAT

1 menaxher 7 këshilltarë pensionalë 1 recepcionist	1 menaxher 1 zhvillues i programeve 1 administrator i rrjetit 1 administrator i bazës së të dhënave	1 kontabilist i certifikuar 2 zyrtarë për financa	1 menaxher i departamentit 2 zyrtarë për investime dhe risk
--	--	--	--

PËRSHKRIMI

<p>Ofron shërbimet ndaj klientëve. Kujdeset të informojë për llogaritë individuale që nga pagesa e kursimeve pensionale, bilancet e kursimeve dhe po ashtu këshillon pjesëmarrësit mbi pensionet e asistion ata për tërheqje të kursimeve.</p> <p>Mirëmban marrëdhëniet edhe me punëdhënësit me qëllim të përmirësimit të informacionit për t'i barazuar kontributet në llogaritë individuale. Në përgjithësi, ky staf është afër klientit gjatë gjithë ciklit të kursimit deri në pensionim.</p>	<p>Sigurojnë që e gjithë infrastruktura e teknologjisë së informacionit funksionon gjithë kohën e pa probleme: kujdesen për harduerët, softuerët, licencat, rrjetin e jashtëm e të brendshëm të FKPK-së, sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e të dhënave.</p> <p>Kujdesen që plani i rimëkëmbjes është çdo ditë i vlefshëm dhe e testojnë në baza të rregullta.</p>	<p>Kryejnë të gjitha transaksionet financiare, përfshirë investimin dhe tërheqjen e mjeteve në tregjet financiare; bëjnë llogarimbajten dhe kontabilitetin për mjetet pensionale dhe operacionet e FKPK-së.</p> <p>Kalkulojnë çmimin ditor të aksionit dhe përgatisin pasqyrat financiare, raportet mujore e tremujore dhe raportet e tjera të nevojshme për Bordin e FKPK-së, Rregullatorin dhe Kuvendin, si dhe komunikojnë me menaxhuesit e mjeteve.</p>	<p>Përgatitë analizat mbi: ecurinë e investimeve; riskun dhe luhatshmërinë e portofolios investuese; përputhshmërinë e investimeve me ligjin; mirëmbajtjen e strategjisë investuese të Bordit, përditësimin e uebfaqes në seksionin e investimeve.</p>
---	---	---	--

2 ZËVENDËSDREJTORË

BURIMET NJERËZORE DHE ADMINISTRATA	ZYRA LIGJORE E AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT	AUDITORI I BRENDSHËM	MARRËDHËNIET ME PUBLIK, TRAJNIMET, PËRKTHIMET
------------------------------------	---	----------------------	---

3	1	1	1
---	---	---	---

1 zyrtar i burimeve njerëzore 1 shtëpiak 1 zyrtar i sigurimit	1 zyrtar ligjor	1 auditor i brendshëm	1 zyrtar për marrëdhënie me publik, koordinimin e trajnimeve dhe përkthimeve
---	-----------------	-----------------------	--

<p>Kujdesen për listëprezencën e stafit në punë, respektimin e orarit, përgatitjen e listës së pagave, kompensimeve të tjera dhe mbajnë arkën.</p> <p>Përveç këtyre merren me furnizimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e zyrës; mbajnë arkivin e dokumenteve të institucionit; mbështesin stafin dhe Bordin Drejtues në takime e udhëtime, brenda e jashtë vendit.</p>	<p>Zyra ligjore shqyrton ligjshmërinë e gjithëmbarshme të institucionit karshi legjislacionit në fuqi dhe ndihmon në përpilimin e kontratave, marrëveshjeve; jep opinione ligjore dhe e përfaqëson FKPK-në në sistemin gjyqësor.</p> <p>Zyra ligjore aktualisht është duke kryer disa nga aktivitetet që më parë i kryente Zyrtari i Prokurimit. Megjithatë procesi i centralizimit të prokurimit [në AQP] e ka ulur vëllimin e aktivitetit të brendshëm të prokurimit, duke qenë vetëm në rolin e koordinatorit me AQP.</p>	<p>Siguron Bordin se e gjithë veprimtaria e Menaxhmentit dhe Administratës dhe proceset në FKPK janë në përputhje me procedurat e brendshme, rregullat e BQK-së dhe ligjet në fuqi.</p> <p>Siguron efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të FKPK-së dhe kontroleve të brendshme duke zhvilluar auditime të rregullta tremujore dhe ofruar rekomandime për zgjidhjen e çështjeve të ngritura. Raportet e Auditorit shqyrtohen nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtues.</p>	<p>Mbështetë komunikimin e institucionit me medien, publikun dhe institucionet, zhvillimin e intervistave dhe konferencave, përpilimin e raportit vjetor dhe buletinit tremujor për kontribuuesit; administron uebfaqen dhe merr rolin e zëdhënësit, kur i delegohet; koordinon dhe ndihmon përkthimin e dokumenteve.</p>
---	--	--	---

MBIKËQYRJA DHE AUDITIMI

FKPK-ja mbikëqyret dhe inspektohet nga ekzaminerët BQK-së që është rregullator i fondeve pensionale, dhe i raporton Kuvendit që e ka themeluar atë. Ajo auditohet nga auditori i brendshëm dhe i jashtëm.

FKPK-ja, si një institucion publik i pavarur, është subjekt i mbikëqyrjes dhe i auditimit nga institucione publike dhe private profesionale. Të gjitha këto mbikëqyrje dhe kontrolle financiare, nga të cilat nuk ka rezultuar asnjë gjetje serioze qysh prej inicimit të aktivitetit të FKPK-së [më 2002], kanë vazhduar besimin e Bordit në Menaxhmentin.

Njëkohësisht, Bordi beson se këto mbikëqyrje bashkë me performancat e investimeve, kanë forcuar kredibilitetin dhe rritur besimin e publikut të gjerë në vendimmarrjen e Bordit dhe etikën e punës së Menaxhmentit.

Numri i proceseve audituese dhe inspektuese, por edhe intervali i tyre i realizimit, vazhduan të jenë të njëjta edhe më 2019. Kështu, FKPK-ja çdo tremujor i njofton: BQK-në, Kuvendin dhe Qeverinë për plasmanet e fondeve pensionale, investimet e reja, kthimin nga investimet, por edhe për harmonizimin e mjeteve pensionale. Ky informacion publikohet gjithashtu edhe në uebfaqen e FKPK-së për informim të gjerë publik.

Deri më tani historikisht secili auditor i pavarur që ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të FKPK-së (operacionale dhe të mjeteve pensionale), të cilët janë të përzgjedhur përmes procedurave publike të prokurimit të Kosovës dhe janë miratuar si të tillë nga Banka Qendrore e Kosovës, nuk kanë dhënë opinion të kualifikuar mbi ato pasqyra. Auditori i Jashtëm, përmes letrës së menaxhmentit, mund të japë edhe rekomandime për funksionimin më të mirë të proceseve të FKPK-së.

Përveç raportimit tremujor, mbi përputhshmërinë e investimeve me dispozitat ligjore dhe Rregullat e BQK-së për pensionet, edhe përgjatë 2019-s FKPK-ja çdo muaj i raportoi departamentit të mbikëqyrjes pensionale në BQK për të gjitha aspektet investuese dhe gjendjen e përgjithshme të mjeteve pensionale. Gjithashtu janë dhënë shpjegime dhe të dhëna sa herë është kërkuar nga BQK.

Në rast se investimet e FKPK-së, për shkak të lëvizjeve në tregjet financiare, rastisin të mos jenë në pajtim me ligjin, atëherë FKPK-ja është e obliguar që menjëherë ta njoftojë BQK-në, dhe ka afat prej 180 ditësh për ta sanuar gjendjen. Gjatë vitit 2019 nuk kishte ndonjë rast të tillë.

Deri më 31 maj të çdo viti, FKPK-ja përpilon dhe e dërgon në BQK, Kuvend dhe Qeveri raportin vjetor për vitin paraprak, së bashku me pasqyrat financiare të audituara nga një auditor i pavarur, i cili i përzgjidhet vetëm pas pëlqimit të BQK-së. Raporti vjetor, bashkë me pasqyrat financiare, po ashtu publikohet në uebfaqe.

Gjatë vitit BQK-ja e ka finalizuar inspektimin për vitin paraprak, 2018, ku një numër i madh i dokumenteve është shqyrtuar; që nga procesverbalet e mbledhjeve të Bordit dhe Komisioneve e deri tek të gjitha çështjet investuese dhe operacionale. BQK-ja normalisht kryen dy inspektime gjatë vitit: një të përgjithshëm dhe tjetrin të fokusuar për të verifikuar zbatimin e rekomandimeve, dhe ia raporton gjetjet Bordit të FKPK-së. Bordi e shqyrton raportin dhe i jep komentet përkatëse.

Gjatë 2019-s BQK-ja ka realizuar një inspektim të përgjithshëm. Në rast të gjetjeve serioze BQK-ja duhet gjithashtu t'i raportojë Kuvendit, një veprim i cili deri më tani nuk ka qenë i nevojshëm. Përveç gjetjeve, BQK-ja i bën Bordit Drejtues edhe rekomandime. FKPK-ja e njofton BQK-në edhe për të gjitha vendimet e Bordit që kanë të bëjnë me kontribuesit, qeverisjen e fondit, dhe çështje të tjera.

FKPK-ja e ka të punësuar një auditor të brendshëm, i cili i raporton së paku katër herë në vit Komisionit për Auditim mbi të gjitha aspektet e aktiviteteve të institucionit. Përveç tij, prej 2018 ka filluar angazhimi i një anëtarit të jashtëm në Komisionin e Auditimit, sipas kërkesës së BQK-së. Ky plotësim është bërë sipas Ligjit Nr. 05/L-116, i cili e ndryshon Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë, së paku një anëtar i Komisionit të Auditimit duhet të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit, i cili është i pavarur nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së.

Po ashtu, auditori i brendshëm, ekspert në fushën e auditimit të TI-së, ka realizuar këtë vit auditim të proceseve të brendshme të teknologjisë së informacionit në FKPK.

REKOMANDIME TË NGRITURA NGA AUDITORI I JASHTËM DHE AUDITORI I BRENDSHËM MË 2019 DHE ECURIA

REKOMANDIMET

AUDITORI I JASHTËM

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar që FKPK-ja nuk e ka përditësuar plotësisht Politikën e Kontabilitetit, në të cilën do të përfshiheshin kërkesat e SNRF 9 - Instrumentet Financiarë që është në fuqi nga 01 Janari 2018. Modeli i zhvlerësimit i përdorur duhet të miratohet në një dokument të veçantë. FKPK-ja duhet të marrë parasysh të gjitha ndryshimet në Standardet SNRF dhe të bëjë një manual të duhur të kontabilitetit me të gjitha kërkesat e SNRF-ve.

AUDITORI I BRENDSHËM

Paragrafi 8.5 i politikave dhe procedurave të brendshme ndër të tjera thotë: "Rasti i nënpagesave - Në ditën e fundit të çdo viti, raportet [jo-korrigjuese] në nënpagesë që kanë së paku 33% të detyrimit të paguar, do të alokohen pjesërisht në Llogaritë Individuale. Administratori i bazës së të dhënave është përgjegjës për përpjesëtimin e raporteve origjinale, bartjes dhe barazimit të tyre në softuerin KPAS, dhe rikthimin e raportit origjinal, i cili do të rrijë pezull deri sa pagesat e mbetura të vijne". Rasti i alokimit të pjesës së nënpagesave ndodh më shpesh se njëherë në fund të vitit. Në të kundërtën në rast se zbatohet alokimi parcial sipas kërkesave të paragrafit në fjalë atëherë rrezikohet që të arrihet caku i përcaktuar nga Bordi Drejtues për fondet e paalokuara. Rekomandimi është për menaxhmentin që të ndryshojë paragrafin në fjalë që të bëhet e mundshme alokimi parcial të paktën çdo tremujor dhe paragrafi i tillë i ndryshuar t'i dërgohet për informim Bordit Drejtues.

Gjatë testimit të Rimëkëmbjes së Fatkeqësisë, ndonëse kanë funksionuar të gjitha proceset e testuara si në rrafshin e RMF, e po ashtu edhe në rrafshin kryesor, gjatë procedurës së testimit të platformës "Llogaria ime" në Uebfaqe në rrafshin e RMF, platforma nuk është bërë joaktive për kontribuesit dhe në rast se dikush do të ndryshonte ndonjë të dhënë gjatë periudhës së testimit ajo e dhënë nuk do të ruhej në sistem. Rekomandimi për Menaxhmentin është që, në të ardhmen, në momentin e testimit të platformës "Llogaria ime" në IP adresat e RMF-së të deaktivizohet kjo platformë, ashtu që nëse ndonjë prej kontribuesve dëshiron t'i ndryshojë të dhënat, të jetë i informuar që e ka të pamundur për momentin, për arsye testimi.

Me vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, invalidëve të luftës u jepej e drejta e tërheqjes së fondeve të akumuluar në llogaritë e tyre në FKPK, zyra e shërbimit për klientë e FKPK-së është përballur me një fluks shumë të madh të përfituesve nga ky vendim. Njëkohësisht ka ndodhur që zyra e shërbimit për klientë të ketë mungesë stafi [për shkak të pushimeve të lehonisë, pushimeve shëndetësore, pushimeve vjetore]. Si pasojë kishim disa raste me vonesa në përpunimin dhe miratimin e aplikacioneve për këta përfitues. I rekomandohet Menaxhmentit që të ndërtojë strategji për t'u përballur me situata të tilla, duke qenë kështu edhe në pajtim me procedurat e brendshme por edhe për t'i shërbyer më së miri kontribuesit.


ECURIA/KOMENTI

Kur merren parasysh instrumentet në të cilat investon FKPK-ja, e që i prek ky standard [bonot dhe depozitat], modeli aktual është adekuat në kompleksitet, dhe i arsyeshëm në vlerësim/përcaktim të humbjeve të pritshme. Megjithatë, për vitin 2020 synohet një ndryshim i vogël në formulat e kalkulimit, më saktësisht të hiqet rumbullakësimi i viteve deri në maturim si shumëzues në përcaktimin e vlerës së përlllogaritur; dhe kjo do ta bëjë modelin më të duhur. Nëse FKPK-ja fillon me investime direkte në instrumente dhe/ose emetues të tjerë, atëherë edhe modeli do të rishikohet.

Me rekomandimin e Komisionit të Auditimit, të datës 10.12.2019, rekomandimi i Auditorit të Brendshëm për ndryshimin e procedurës është zbatuar plotësisht.

Duke filluar nga data e rekomandimit, kur baza e të dhënave është në testim të DRC, do të aktivizohet një faqe që tregon se eTrusti është përkohësisht jashtë shërbimit.

Menaxhmenti e ka analizuar situatën e krijuar, duke pasur parasysh si periudhën e pazakontë kur është shfaqur e njëjta [në kohën e pushimeve të verës] ashtu edhe qarkullimin e vendimit në një kohë të shkurtër dhe të shpejtë, pa pasur kohë të përgatitjes për zbatim. Sidoqoftë, do të merren të gjitha masat që situatat të menaxhohen dhe mos përsëritën, duke përdorur sistemin e caktimit të orarit të aplikimeve. Po ashtu, sikurse vlen të përmendet, përkundër vonesave procedurale përfituesit nuk kanë pasur asnjë ankesë për këtë.



Tarifat vjetore të ngarkuara mbi mjetet pensionale për vitin 2019 janë ulur në gjithsej 0.439% të mjeteve (2018: 0.452%). Tarifa investuese u ul nga 0.381% në 0.370% gjersa tarifa operacionale u ul nga 0.071% në 0.069%.

Por në vlerë nominale tarifata e ngarkuara mbi mjetet pensionale u rritën për 7.1%, ose me €575,496 - për shkak të ngritjes së mjeteve nën menaxhim.

Megjithatë edhe këtë vit FKPK-ja nuk i ka shpenzuar të hyrat e gjeneruara nga këto tarifa dhe suficiti prej €2,300,000 është kthyer në fondin e kontribuuesve.

Tarifat e ngarkuara gjeneruan të hyra prej €8,235,843 prej të cilave €6,941,657 ishin destinuar për t'i mbuluar shpenzimet investuese dhe €1,294,186 ato operacionale.

Të ardhurat jotarifore të FKPK-së për vitin ishin €174,030 dhe bënë që të hyrat e përgjithshme të FKPK-së për vitin 2019 të jenë €8,409,873, ose 8.4% më të larta sesa një vit më parë (2018: €7,758,014).

Rreth 70.0% e të hyrave jotarifore ishin prej të hyrave nga investimet e tjera, dhe 30.0% ishin nga të hyrat e tjera prej aktiviteteve investuese, refundimeve të paguara gabim dhe të hyrave të tjera operacionale.

FINANCIMI

Mesatarisht FKPK-ja i ka ngarkuar pjesëmarrësit me tarifë operacionale prej €0.17 në muaj.

FKPK-ja financohet në mënyrë të ngjashme sikurse të gjitha fondet pensionale me kontribut të definuar, d.m.th. duke ngarkuar tarifa mbi mjetet nën menaxhim (mjetet pensionale).

Si një institucion jo-për-profit, tarifata e ngarkuara nga FKPK-ja duhet t'i mbulojnë vetëm shpenzimet e saj. Nivelet e tarifave, sipas rekomandimeve të Bordit Drejtues, miratohen nga Kuvendi i Kosovës; duke i siguruar kështu Kuvendit një mënyrë të tërthortë të kontrollit mbi shpenzimet e FKPK-së.

Sipas ndryshimeve në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-168, FKPK-ja ngarkon tarifën investuese për të mbuluar shpenzimet që lidhen me investimin e mjeteve pensionale; dhe tarifën operacionale për mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Krahasuar me 2018 FKPK-ja i ka ulur për 2019 tarifata e ngarkuara (në përqindje) si për aktivitetet investuese ashtu edhe për ato operacionale.

Tarifa operacionale e FKPK-së, tashmë prej 0.069% vjetore, vazhdon të jetë më e ulëta krahasuar me të gjithë operatorët e ngjashëm në rajon por është edhe ndër më të ulëtat globalisht.

Në anën tjetër, mënyra e aplikimit e tarifës investuese prej 0.370% vjetore nuk është e krahasueshme me asnjërin prej fondeve të ngjashme pensionale rajonale por as me fondet e ngjashme në botë.

Forma standarde e trajtimit të shpenzimeve investuese nga fondet e ngjashme pensionale është që, krahas taksës operacionale që ngarkohet për operim të shtëpisë menaxhuese, shpenzimet investuese të ngarkohen mbi vetë fondin pensional; pra shpenzimet investuese të trajtohen si shpenzime të fondit e jo siç e kemi në Kosovë, ku këto trajtohen si shpenzime të entitetit që menaxhon me fondin.

Ky trajtim po rezulton në shpërputhje midis asaj që FKPK-ja ngarkon si tarifë investuese (gjë që duhet vlerësuar para se viti të fillojë) dhe shpenzimeve që ndodhin në realitet.

Duhet sqaruar këtu se edhe disa prej aktiviteteve të Bordit, të lidhura me investimet, si: intervistimi dhe përzgjedhja e aset-menaxherëve, që janë aktivitete të ndërlidhura me investimet, mbulohen po nga tarifa operacionale.

Vlen të përmendet këtu se për vitin 2019 llogarimbajtësve të FKPK-së mesatarisht u ka kushtuar €2.09 (2018: €1.93) e gjithë kostoja operacionale e këtij institucioni.

- shërbimin e drejtpërdrejtë në zyrë (shërbim, këshillim, informim) çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 16:00;
- dërgimin e pasqyrave vjetore në shtëpi ose përmes postës elektronike;
- shtypjen e pakufizuar të pasqyrave të llogarisë në zyrën e FKPK-së;
- mirëmbajtjen e plotë të llogarisë së kursimeve pensionale;
- sigurimin e llogarisë në një lokacion dhe me serverë rezervë;
- shërbimin elektronik të qasjes *online* në llogarinë personale pensionale dhe shërbimin për komunikim në Facebook;
- njoftimin me postë për daljen në pension;
- aplikimin për tërheqje kursimesh dhe transferet bankare pa kosto të ngarkuar nga FKPK-ja;
- mirëmbajtje falas të llogarisë për tërheqje të kursimeve në faza nga bankat komerciale në vend;
- kamatë mbi mesatare për kursimet në programin për tërheqje në faza;
- shërbimet më të avancuara teknologjike në sektorin pensional në rajon;
- mbulimin e një pjese të shpenzimeve investuese; përzgjedhjen e menaxhuesve të mjeteve, shpenzimet e Bordit Drejtues e të ngjashme.
- mundësinë për të shtypur pasqyrën e llogarisë në çdo kohë përmes e-kiosku jashtë zyrës së FKPK-së në Prishtinë.

SHPENZIMET

FKPK-ja, si shtëpi menaxhuese e fondit, ka shpenzime për investimin e mjeteve pensionale dhe për operacionet e saj.

SHPENZIMET INVESTUESE

Shpenzimet investuese përfshijnë: tarifën që mbajnë menaxhuesit e fondeve për investimin e mjeteve dhe qasjen në tregjet financiare; tarifën e BQK-së për transferimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve; dhe shpenzimet e tjera për brokerët dhe kujdestarët e mjeteve.

Bordi Drejtues gjatë procesit konkurrues të përzgjedhjes së fondeve investuese i merr për bazë tarifën që menaxherët ngarkojnë për investimin e mjeteve, dhe menaxhuesit që ofrojnë tarifa më të ulëta kanë përparësi në përzgjedhje.

Po ashtu duhet pasur parasysh që menaxherët e fondeve ngarkojnë tarifa të ndryshme të menaxhimit në varësi të shumës së investuar si dhe strategjisë së tyre (aktive ose pasive). Po ashtu kthimi potencial i mundshëm ka ndikim në tarifën menaxhuese. Fondet investuese të tregut të parasë p.sh. ngarkojnë tarifa menaxhuese më të ulëta sesa fondet në tregjet e aksioneve apo edhe fletobligacioneve.

Shpenzimet për investime përbënin 79.6% të shpenzimeve të FKPK-së për vitin 2019 [2018: 83.2%]. Ato në vlerë nominale ishin €4,702,557 [2018: €5,743,872]. Në total mjetet e investuara jashtë Kosovës ishin gati njësoj me 2018-n. Më 2019 ishin [mesatarisht] €1,399.5 mln kundrejt 2018 me €1,401 mln.

Duhet theksuar se zakonisht fondet investuese ngarkojnë mesatarisht mbi 1% për menaxhimin e fondeve, kurse FKPK-ja ka arritur që përmes marrëveshjeve individuale dhe selektimeve të matura të sigurojë që tarifën e paguar ndaj fondeve investuese, përmes të cilave i investon mjetet pensionale, të ulën më tej edhe më 2019 duke rënë në rreth 0.370%.

Shpenzimet investuese u realizuan në 67.7% e të hyrave të planifikuara nga tarifa investuese (2018: 89.1%), duke bërë që në vitin 2019 suficitin nga aktivitetet investuese të rritet në €2.30 milion; [nga 2018: €719.5 mijë]. Rritja e ndjeshme e suficitit, ose ulja e shpenzimeve investuese, këtë vit ndërlidhet me investimin e më shumë mjeteve në tregun e parasë së gatshme krahasuar më 2018, me çka janë ulur shpenzimet për investimin e mjeteve përmes fondeve të tilla.

Bordi Drejtues, gjatë 2019-s, vendosi që gjithë shumën e suficitit nga aktivitetet investuese [prej €2,300,000] ta kthejë në fondin e kontribuuesve. Përveç kësaj shume janë kthyer edhe një pjesë e mjeteve nga suficitin i aktivitetit operacional. Në këtë mënyrë shpenzimi optimal i tarifave menaxhuese, duke mos i ngarkuar kontribuuesit pa nevojë.

Nuk duhet harruar në këtë analizë se në momentin kur përcaktohet tarifa investuese për vitin e ardhshëm synimi i FKPK-së është të jetë sa më afër me vlerësimin e nevojave për të njëjtën. Por, është tejet e vështirë të parashikohet qoftë performanca e investimeve qoftë alokimi strategjik i mjeteve [për shkak të faktorëve të jashtëm të cilët mund të ndikojnë edhe në tregje e edhe në vendimmarrjen e Bordit për investime], gjë që e bën të pashmangshëm suficitin [apo deficitin] nga aktivitetet investuese.

Është hera e parë, të paktën në pesë vjetët e fundit, që parashikimi i shpenzimeve investuese bie në nivelin prej 89%.

TARIFAT MENAXHUESE NGA FONDET INVESTUESE

Fondet investuese ngarkojnë tarifa menaxhuese për investimin e mjeteve varësisht (dhe kryesisht) prej produkteve që ofrojnë dhe pozicionit që e mbajnë në treg.

Duke paguar këto tarifa, në disa raste, FKPK-ja ka qasje në tregjet financiare me kosto më të ulët sesa përmes investimeve direkte. Por, në secilin rast përfitohet shumë nga njohuria mbi investimet e ekspertëve të këtyre fondeve.

Fondet investuese aktive, që realizojnë investime, hulumtime dhe transaksione ditore, kanë shpenzime më të mëdha dhe arsyeshëm ngarkojnë tarifa më të larta.

Ndërsa fondet investuese pasive, që ndjekin një indeks të caktuar në bursa, kanë tarifa më të ulëta menaxhuese, e ku në rastin e FKPK-së bën pjesë vetëm fondi Vanguard - GSIF.

Fondet e hapura	2019		2018	
	Norma neto e tarifave vjetore	Tarifat e ngarkuara	Norma vjetore e tarifave	Tarifat e ngarkuara
Vanguard - GSIF	0.13%	€365,610	0.13%	€476,025
BNY Mellon - RRF	0.60%	€1,246,615	0.60%	€488,895
AXA - GILB	0.35%	€153,678	0.35%	€345,106
Schroders - SISF	0.50%	€100,784	0.50%	€50,969
Schroders - GDG	0.65%	€293,788	0.65%	€813,018
Nordea 1 - GSEF	0.43%	€414,968	0.43%	€689,736
Nordea 1 - SRF	0.56%	€1,129,320	0.56%	€942,218
Amundi - 3M I	0.54%	€221,064	0.55%	€16,719
AXA - WFOI	0.55%	€238,363	0.55%	€716,717
BNP Paribas - PDP	0.44%	€450,555	0.65%	€867,595
Amundi - RPI2	0.20%	€161,370	0.20%	€253,115
Corp Bond Eur ETF	0.20%	€46,473	--	--
S&P500 Minvol ETF	0.25%	€64,637	--	--
Amun EurCorp ETF	0.16%	€37,062	--	--
MSCI USA Qual ETF	0.15%	€2,768	--	--
Pictet - HDS	--	--	0.63%	44,293
TOTALI I TARIFAVE		€4,558,953		€5,704,406
Tarifat e BQK-së për transfere dhe të tjera		€91,952		€30,550
Brokerët, kujdestarët dhe garancionet		€51,652		€8,916
TOTALI I SHPENZIMEVE INVESTUESE		€4,702,557		€5,743,872

79.6%

2019

83.2%

2018

SHPENZIMET OPERACIONALE

Shpenzimet operacionale⁽¹⁾ përfshijnë të gjitha shpenzimet e tjera që nuk janë direkt shpenzime investuese e të cilat përbëhen prej kompensimeve, shtypjes dhe postimit të pasqyrave të llogarive, qirasë së zyrës, dhe shpenzimeve të tjera për operim.

Megjithatë, shpenzimet operacionale financojnë edhe të gjitha shpenzimet e Bordit Drejtues, ku pjesa kryesore e aktivitetit të Bordit është vendimmarrja rreth investimeve.

Për vitin 2019 shpenzimet operacionale ishin €1,205,928 (2018: €1,158,745) dhe përbënin 20.4% të totalit të shpenzimeve të FKPK-së (2017: 17.2%). Siç mund të shihet, shpenzimet operacionale ishin më të larta këtë vit (për 47,183 euro) sesa vitin e shkuar, duke u rritur kështu për 4.1%. Rritja e shpenzimeve operacionale mund të vlerësohet e lehtë, dhe shumica e linjave buxhetore u reduktuan ose qëndruan të njëjta me vitin paraprak.

Më 2019 buxheti i paraparë operacional për mallra dhe shërbime u realizua në masën prej 93.2% (2018: 95.6%). Niveli i realizimit i shpenzimeve operacionale mund të vlerësohet tejte i kënaqshëm edhe për vitin 2019.

Kostoja e stafit është prezantuar pa përfshirë shpenzimet për trajnime, udhëtime dhe shpenzimet e tjera për staf, meqë këto shpenzime janë prezantuar në linja të veçanta. Kostoja e stafit, megjithëse e reduktuar për 1% nga 2018-ta, në vlerë nominale u ngrit, dhe përsëri zuri pjesën më të rëndësishme të shpenzimeve operacionale edhe këtë vit, me 48.5% (2018: 49.6%). Reduktimi i kësaj kostoje ndodhi për shkak të lëvizjes së stafit.

Ndërsa shpenzimet për Bordin u ulën në 16.0% e shpenzimeve operacionale (2018: 17.9%). Shpenzimet për shtypjen dhe shpërndarjen e pasqyrave këtë vit u rritën në 11.5% (2018: 9.3%), që nënkupton dërgimin e më shumë pasqyrave me Postë.

Rritja të dukshme të shpenzimeve këtë vit kishim tek mirëmbajtja e softuerit, për shkak se më 2018 në një pjesë të gjatë i kishte skaduar kontrata mirëmbajtësit të sistemit të llogarive (deri në përtëritjen e saj nga AQP), por dhe për shkak se më 2019 ka filluar përdorimi i softuerit Bloomberg, për nevoja të departamentit të investimeve.

Detajet për secilën linjë buxhetore prezantohen në tabelën e faqes vijuese, ndërsa shpjegimet shtesë në pasqyrat e bashkëngjitura financiare.



20.4%
2019

16.8%
2018

[1]

Për më shumë informacione ju lutemi referojuni pasqyrave financiare të audituara, të cilat, sikurse kërkohet me Ligjin për Fondet Pensionale, përgatiten në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

SHPENZIMET OPERACIONALE	2019		2018	
Kostoja e stafit	€584,453	48.5%	€574,375	49.6%
Shpenzimet për Bordin Drejtues	€193,275	16.0%	€207,862	17.9%
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondenca	€138,368	11.5%	€107,951	9.3%
Mirëmbajtja e softuerit	€87,368	7.2%	€38,289	3.3%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	€92,696	7.7%	€53,584	4.6%
Shpenzimet për operim të zyrës	€22,595	1.9%	€82,801	7.1%
Tarifa e BQK-së për mbikëqyrje	€19,413	1.6%	€18,188	1.6%
Trajnimet, udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit	€16,057	1.3%	€10,050	0.9%
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	€11,259	0.9%	€10,380	0.9%
Shpenzimet e interesit të qirasë	€10,540	0.9%	-	-
Auditimi i jashtëm	€9,050	0.8%	€9,050	0.8%
Komunikimi	€7,263	0.6%	€8,298	0.7%
Rimëkëmbja nga fatkeqësitë - qiratë dhe shpenzimetë ndërlidhura	€6,600	0.5%	€6,600	0.6%
Tarifat e shërbimeve bankare	€1,744	0.1%	€2,300	0.2%
Edukimi publik dhe shpalljet	€1,060	0.1%	€15,136	1.3%
Shpenzimet e tjera	€4,187	0.3%	€13,881	1.2%
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERACIONALE	€1,205,928	100%	€1,158,745	100%

02

AKTIVITETET

41 Aktivitetet

42 Menaxhimi i llogarive

45-46 Barazimi i kontributeve

47- 48 Shërbimi për klientë

AKTIVITETET

BORDI DREJTUES

Bordi Drejtues gjatë vitit 2019 ka operuar në përbërje të plotë. Pas luhatjeve ekstreme në tremujorin e fundit të 2018-s, që sollën performancë negative për investimet, Bordi u shtoi fokusin në riskun afatshkurtër dhe afatmesëm dhe ndërmori një seri vepimesh për të përmirësuar kthimin nga investimet me risk të menaxhuar, përmes zbatimit të pikëpamjes së alokimit të mjeteve në situatat me dhe pa risk. Një nga vendimet më të rëndësishme ishte ulja në nivelin më të ulët historik e investimeve në tregun e aksioneve direkte dhe, njëkohësisht, shuma e mjeteve të drejtuara në tregun e parasë së gatshme dhe fondet e multi-aseteve u rrit ndjeshëm. Po ashtu, kishim një vit rekord të lëvizjes së mjeteve të investuara.

Ribalancimet taktike, për të përshtatur sa më mirë politikën investuese me parashikimet e lëvizjes së tregjeve, u aktivizuan disa herë gjatë vitit, duke tërhequr nga fondet aktive rreth €1.33 miliardë dhe duke shtuar në fondet aktuale, në katër fonde të reja ETF, rreth €1.43 miliardë. Diferenca mes mjeteve të tërhequra dhe atyre të shtuara u financua nga gjendja e keshit në BQK nga viti paraprak dhe nga kontributet e reja.

MENAXHMENTI

Përveç dhënies së ndihmës për Bordin dhe ekzekutimin e vendimeve të tij, Menaxhmenti siguron që të gjitha proceset ditore (operacionet) funksionojnë pa ndërprerje. Kjo nënkupton se: të dhënat dhe informacionet për kontribuuesit janë të sigurta, se kontribuuesve u shërbehet me standarde të larta profesionale dhe se përfituesit e pensionit i marrin kursimet pensionale në kohë.

Po ashtu sigurohet se raportet periodike, përfshirë raportin vjetor, përpilohen dhe u dërgohen institucioneve mbikëqyrëse dhe Rregullatorit në afat ose sa herë kërkohet; se transferimet e mjeteve pensionale drejt fondeve investuese dhe llogarisë së FKPK-së realizohen saktë; e se komunikimi me menaxhuesit e mjeteve dhe brokerët bëhet në standardet më të larta profesionale dhe përpikmëri ligjore.

Njëkohësisht shërbimi online eTrusti, që ka rreth 130 mijë përdorues, si dhe uebfaqja e FKPK-së, duhet të jenë 24 orë në funksion; që kontribuuesit të informohen për gjendjen e pasqyrës së llogarisë sa herë kanë nevojë, e që komunikimi me publikun, dhe palët e treta, të jetë në dispozicion çdo ditë pune.

Ndërsa ribalancimet vazhdonin për investimet jashtë vendit, Bordi vazhdoi të shtonte investimet në Kosovë. Në fund të vitit 2019 ato zinin 1/4 e të gjitha investimeve, duke shkuar në total në rreth €485 mln. Një vit më parë kjo shifër ishte rreth €320 mln.

Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishin €299 mln ndërsa plasimet në depozitat bankare në vend ishin €186 mln. Gjithsesi, veprimet e shtimit të investimet brenda vendit erdhën si pasojë e kërkesës së shtuar nga Qeveria e Kosovës për të emetuar letra me vlerë, dhe si dhe gatishmërisë së deklaruar vazhdimisht nga Bordi i FKPK-së për të shtuar prezencën e investimeve brenda vendit, sa herë (dhe sa më shumë) është e mundur.

Përveç vendimeve investuese, dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve operative të institucionit, Bordi ka zhvilluar takime të rregullta në Kuvendin e Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës. Ka kryer takime, vizita dhe konsultime tek menaxherët e aseteve për t'u siguruar që investimet dhe vendimmarrja investuese është e duhur.

Mbi të gjitha, duhet garantuar se të gjitha transaksionet financiare janë në përputhje të plotë me rregullat, ligjet dhe standardet (edhe ndërkombëtare) në fuqi, dhe se asnjë vendim ose veprim të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin dhe/ose interesin e kontribuuesve.

Gjatë vitit Menaxhmenti ishte i fokusuar në: a) mbështetjen profesionale të Bordit në vendimmarrjen rreth investimeve (brenda e jashtë vendit); b) procesin e investimeve në fondet ETF; c) plotësimin me staf të departamentit të investimeve dhe riskut; d) informimin dhe vetëdijesimin e kontribuuesve për kontribuimin pensional; e) shtimin e numrit të llogarive në eTrusti, për të ulur kështu koston dhe lehtësuar komunikimin me kontribuuesit; f) mbështetjen e proceseve për shtimin e investimeve në bankat që operojnë në Kosovë e) avancimin e vazhdueshëm të teknologjisë së brendshme të informacionit dhe digjitalizimin e plotë të proceseve; dhe g) përbushjen e të gjitha kërkesave të BQK-së dhe auditorit të jashtëm për gjithë zinxhirin operues të institucionit.

MENAXHIMI I LLOGARIVE

Rreth 453 mijë njoftime për gjendjen e llogarisë u dërguan me Postë dhe e-mail.

Në ciklin e vitit 2019 janë dërguar 452,708 pasqyra, nga cilat 253,258 me postë dhe 172,450 me e-mail (2018: 382,291 me postë dhe 204,691 me e-mail). Këtë vit numri i llogarive të reja u shtua për rreth 43 mijë, por njëkohësisht numri i përdoruesve të shërbimit eTrusti është rritur për rreth 30 mijë brenda 2019-s, duke e ulur kështu nevojën e dërgimit të pasqyrave me Postë. Po ashtu nga lista e dërgimit përjashtohen pasqyrat e llogarimbajtësve që nuk kanë pasur asnjë transaksion në tri vjetët e fundit. Ndërsa, FKPK-ja vazhdon të ketë mungesë të adresave fizike dhe e-mailave për një mbi 20 mijë kontribuues. Të njëjtëve ka qenë e pamundur t'ju dërgohet pasqyra.

Për shkak të pensionimit (ose vdekjes) së kontribuuesve 7,808 llogari janë "tërhequr" rishtazi gjatë 2019 (2018: 5,435). Total i llogarive me tërheqje arriti në 51,755. Pasqyrat e llogarisë nuk dërgohen as për këtë kategori të llogarimbajtësve.

FKPK-ja hapi 43,286 llogari të reja individuale (2018: 35,121), duke e çuar numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura qysh prej themelimit në 669,973. Nga llogaritë e reja të hapura gjatë vitit (pra nga 43,286) 41,775 prej tyre ishin për kontribuuesit nismëtarë, d.m.th. që filluan kontribuimin më 2018, kurse pjesa tjetër ishin raste të kontribuimit për vitet e mëhershme, për të cilat FKPK-ja e ka marrë qoftë pagesën qoftë informacionin më 2018.

Gjatë vitit ishin 33,317 punëdhënës dhe 22,890 të vetëpunësuar që kishin paguar kontribute për vitin e raportimit (2018: 30,487 dhe 24,461, përkatësisht).

Përveç tyre, ishin edhe 3,893 punëdhënës dhe 4,002 të vetëpunësuar që paguan kontribute vetëm për vitet paraprake (2018 përkatësisht: 3,979 dhe 4,230).

Në total, për vitin 2019, ishin 3.74 mln transaksione të postuara në llogaritë e kontribuuesve dhe mbi 515 mijë në llogari të punëdhënësve (2018: 3.54 mln, përkatësisht 542 mijë).

Të përfshira në transaksionet e llogarive të punëdhënësve janë 37,911 raste (2018: 37,679) të refondimit të: a) kontributeve të paguara gabimisht apo mbipagesave; dhe b) gjobave në ATK. Për informim, gjobat përbëjnë gjobat dhe interesat që i ngarkon ATK-ja mbi punëdhënësit (dhe të vetëpunësuarit) për vonesë në pagesë apo mosdeklarim të saktë të kontributeve pensionale - dhe të cilat punëdhënësit i kanë paguar së bashku me kontributin pensional.

Këto transaksione refonduese në 99% të rasteve ishin mbipagesat (transaksionet) e bëra nga punëdhënësit gjatë të njëjtë vit, pra gjatë 2019-s. Më 2018 të njëjtat përbënin 98% të rasteve, ndërsa më 2017 përbënin 95%.

Punëdhënësit mesatarisht kanë deklaruar dhe paguar për 9.56 (ose 79.7%) muaj të 2019, pothuajse njëjtë me vitin e shkuar; dhe të vetëpunësuarit për 3.37 (ose 84.3%) tremujor të 2019, diçka më pak se një vit më parë.

9.6

NUMRI MESATAR I MUAJVE PËR TË CILËT PUNËDHËNËSIT KANË PAGUAR KONTRIBUTE

2018: 9.6

2019

3.4

NUMRI MESATAR I TREMUJORËVE PËR TË CILËT TË VETËPUNËSUARIT KANË PAGUAR KONTRIBUTE

2018: 3.4

2019



BARAZIMI I KONTRIBUTEVE

Kontributet e pabarazuara ranë në 0.14% të gjithsej kontributeve të arkëtuara.

FKPK më 2019 nuk ka kthyer mjete të pabarazuara në ATK, siç ishte bërë dy vjet rresht - meqë shuma që i takonte periudhës 2013-2019 ishte relativisht e vogël (rreth 200 mijë euro). Sidoqoftë FKPK-ja kur kthen mjete në ATK, paraprakisht e ka të dëshmuar se janë shterur mundësitë e gjetjes së informacionit, për disa arsye: punëdhënësit nuk i kanë ruajtur informacionet individuale të pagesave ose i kanë paguar me të dhëna të gabuara, bizneset e kanë mbyllur ose ndryshuar aktivitetin, dhe/ose kanë paguar gabimisht tatimet e gjoba si kontribute pensionale.

Megjithatë, vlen ta rikujtojmë se edhe kur bëhet transferimi i mjeteve nga FKPK-ja në ATK [për arsyet e lartcekura], ligji në fuqi ia ka ruajtur kontribuuesve të drejtën që kurdo që sigurojnë informacione për këto kontribute do të rimbursohen me vlerën e kontribuimit, duke ia shtuar edhe mesataren e kthimit nga investimet e FKPK-së për periudhën prej momentit të transferimit të tyre në ATK.

Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së vazhdojnë ta kenë në listë të angazhimeve barazimin e mjeteve për periudhat më të reja se 6 vjet, e sidomos në gjetjen e informacioneve për pagesat vjetore.

Kështu edhe për vitin 2019 Bordi Drejtues kishte vënë objektivin për mjetet e paalokuara, duke i dhënë kështu këtij procesi vëmendje në proceset e përditshme të institucionit:


Kontributet e pabarazuar më 31 dhjetor 2019 arritën në €2,405,299 [2018: €1,293,572]. Në pamje të parë duket që kemi rritje të mjeteve të pabarazuara po kjo vjen për arsye të afateve të raportimit (të pasqyrave financiare që mbyllen më 15 janar 2020 për vitin 2019) dhe kohës kur mjetet që nuk janë kontribute pensionale (që i takojnë vitit 2019) janë kthyer në ATK.

Kështu më 20 janar 2020 FKPK-ja ka kthyer në ATK €573 mijë të cilat i takojnë vitit 2019. Po ashtu FKPK-ja nuk i ka kthyer ende në ATK edhe rreth €200 mijë, që janë kontribute të paidentifikuara që i përkasin periudhës 2013-2019. Pra duke i zbritur këto dy shuma qartësisht mjetet e pabarazuara për fundvitin 2019 do të binin në €1.25 milionë, që do të ishte vlerë më e ulët e mjeteve të pabarazuara sesa e fundvitit 2018.

Duhet cekur këtu se përveç faktit se është përmirësuar dukshëm saktësia e raportimit të kontributeve pensionale [përmes portalit EDI në ATK], po ashtu vërehet se kontribuuesit gjithnjë e më shumë po kujdesen për gjendjen e kursimeve pensionale, duke reflektuar kështu rritje të vetëdijësimit për rëndësinë e kontribuimit pensional.

Megjithëkëto ndryshime pozitive, FKPK-ja do të vazhdojë të angazhohet që informacionet dhe pagesat të jenë të plota, në mënyrë që të shmanget në maksimum mundësia e dëmtimit të interesit të kontributdhënësve.

KONTRIBUTET KUMULATIVE TË ALOKUARA DHE TË ARKËTUARA



SHËRBIMET PËR KLIENTË

Totali i numrit të shërbimeve të ofruara nga zyrat e FKPK-së gjatë 2019-s për individë dhe punëdhënës ishte 159,355. Kjo shënon një rënie të lehtë prej 1.3% krahasuar me 161,467 shërbimet e ofruara gjatë 2018-s.

Numri i pasqyrave të llogarive të shtypura (falas) për kontribuuesit vizitorë ishte 109,648. Me 69% [2018: 56%] ky shërbim rriti dukshëm dominimin këtë vit duke qenë më i kërkuari nga kontribuuesit. Arsyet prapa kësaj janë dy: kërkesat për viza në ambasada shoqërohet me kërkesën që pasqyrat e llogarive të FKPK-së të jenë dëshmi për punësim; por edhe për shkak të performancës së investimeve (më 2018) e ngriti interesimin e kontribuuesve për gjendjen e kursimeve pensionale.

Një numër (në rritje të shpejtë) i shërbimeve të FKPK-së gjithashtu ofrohet në zyrat rajonale të ATK-së përmes Zyrtarëve Pensionalë të ATK-së. Shërbimet e ofruara nga ta, e që përbëheshin kryesisht nga shtypja e pasqyrave të llogarive, numëruan 61,100 [2018: 45,323 sosh]. FKPK-ja në vazhdimësi mbanë kontakte dhe konsultime me këto zyra për t'iu ofruar shërbimet më të mira kontribuuesve.

Shërbimet e tjera (më kryesore) të ofruara nga stafi i FKPK-së ishin: a) 27,233 autorizime të kërkesave për qasje në portalin eTrusti; b) 7,961 aplikacione të miratuara për pension; c) 3,642 adresa të kontribuuesve të ndryshuara; d) 1,483 njoftime për pension të shtypura; e) mbi 3 mijë kontrollime të llogarive të realizuara.

FKPK-ja vazhdon ta trajtojë me prioritet masivizimin e shërbimit eTrusti. Numri i llogarive në eTrusti gjatë 2019 u rrit për 27% në 129,960 [2018: 102,727], duke përbërë 19% të të gjitha llogarive dhe 34% të llogarive aktive në fund të 2019. Tashmë, për shkak se një numër i madh i kontribuuesve kanë llogari në eTrusti, promovimi i këtij shërbimi bëhet nga vetë kontribuuesit.

Portali eTrusti iu shërben kontribuuesve qasje të lehtë dhe pa kosto në llogarinë e kursimeve pensionale, dhe mundëson përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve, uljen e kostos dhe rritjen e transparencës. Shërbimet e ofruara në këtë portal janë të shumta. Përdoruesit e eTrusti-t mund të kontrollojnë bilancin e llogarisë së tyre dhe transaksionet, dhe ndryshe nga shërbimet e rëndomta online. Kontribuuesit aty mund të kontrollojnë gjendjen totale të kursimeve pensionale, çmimin ditor të njësisë, numrin e aksioneve, të gjitha pagesat e kontributeve nga secili punëdhënës prej momentit të hapjes së llogarisë; por po ashtu mund të dërgojnë pyetje tek stafi i FKPK-së.

Përveç të gjitha shërbimeve që janë ofruar në zyrë, FKPK-ja i ka përgatitur dhe dërguar gjithë kontribuuesve aktivë pasqyrat vjetore të kontribuuesve. Po ashtu përmes rrjeteve sociale i jemi përgjigjur mbi pesë mijë pyetje dhe komenteve të kontribuuesve.

Përveç shërbimeve që kryhen nga zyra e FKPK-së dhe zyrat rajonale të ATK-së, kontribuuesit kanë kryer vetë edhe 13,237 shërbime, duke qenë kështu sa 8% e shërbimeve të tjera, dhe me tendencë rritjeje.

PASQYRA TË LLOGARIVE SHTYPURA PËR KONTRIBUESIT NË ZYRËN E FKPK

109,648

GJITHSEJ NUMRI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ZYRA E FKPK DHE ZYRAT E ATK - PËR INDIVIDËT DHE PUNËNDHËNËSIT

2019
159,355
2018
161,467

RRITJA E NUMRI I TË LLOGARIVE NË eTRUSTI

2019:
▲ 27%

2018:
▲ 29%

#eTRUSTI është shërbim i bazuar në internet që ofrohet për të gjithë kontribuuesit prej vitit 2010.

Procedurat e regjistrimit kryhen përmes internetit, duke e verifikuar identitetin e kontribuuesit dhe konfirmuar e-mailin.


03

INVESTIMI I KURSIMEVE PENSIONALE

- 51-52 Parimet dhe politika e investimeve
- 54 Shpërndarja e mjeteve sipas investimeve
- 55-56 Shpërndarja gjeografike
- 57 Emertuesit kryesorë
- 58 Klasat e asetëve dhe valutat
- 59-60 Performanca e investimeve dhe krahasimi

Siguria e kursimeve pensionale; diversiteti i investimeve; maksimizimi i kthimit për nivelin e ndërmarrë të riskut, dhe mirëmbajtja e likuiditetit adekuat; janë në përthamën e parimeve të matura investuese të FKPK-së.

ÇMIMI I NJËSISË PREJ THEMELIMIT



PARIMET DHE POLITIKA E INVESTIMEVE

FKPK-ja vazhdoi t'iu përmbahet plotësisht deklaratës së parimeve dhe politikave të reja investuese, baza e të cilave janë vendosur më 2014. Kjo deklaratë e Parimeve Investuese bazohet në objektivin kryesor afatgjatë të investimeve të FKPK-së që është: së pari të ruajë dhe së dyti të rrisë kapitalin e kontribuuesve, në terma nominalë dhe ata realë. Kjo Deklaratë e ka vendosur Indeksën e Çmimeve të Konsumit të Kosovës si *benchmark* kundrejt së cilës do të matet performanca e investimeve të FKPK-së.

Udhëzuesi i Politikave Investuese (UPI), duke e pranuar që duhet të ketë një ekuilibër mes kontribuuesve që janë afër pensionimit dhe atyre që nuk janë, bën thirrje për një politikë e cila përmban një masë të arsyeshme por jo të tepruar të alokimit në mjete afatgjata nga të cilat pritet kthim dhe luhatshmëri me e lartë, të tilla si aksionet; e kombinuar me një alokim më të madh në investime nga të cilat pritet luhatshmëri më e vogël dhe kthime më stabile sesa tek aksionet.

Me këtë theks të rritur ndaj riskut, objektivi i UPI-t është të ofrojë më shumë mbrojtje kur tregjet janë në rënie, por megjithatë t'i korrë shpërblimet kur tregjet rriten. Edhe gjatë vitit 2019 pozicionimi i investimeve të FKPK-së ishte më shumë kah mbrojtja e investimeve nga lëvizjet afatshkurtra, duke u bazuar në tronditjet e forta që tregjet patën gjatë tremujorit të fundit të 2018-s. Si rezultat, përkundër mirëmbajtjes së një portofoli përgjithësisht konservativ, u arrit një kthim i kënaqshëm nga investimet, që buroi nga një meanxhim i fortë i riskut.

Bordi çdo tremujor (por edhe më shpesh) e ka kontrolluar kornizën e limiteve të alokimit të mjeteve, dhe e ka konfirmuar nëse ka tejkalim të kufijve në klasat e asetëve ose në strategjinë investuese që menaxhuesit e fondeve i aplikojnë.

Njëkohësisht, përmes analizave të kujdesshme, janë verifikuar nëse investimet e FKPK-së përmbushin në përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

Politika investuese bazohet në një gërshetim të: a) klasave të asetëve - pra të instrumenteve financiare të investimeve direkte dhe atyre në kuadër të fondeve investuese; dhe b) strategjisë investuese të përvetësuar nga fondi investues. Në të gjitha këto pikëprerje të klasave të asetëve dhe strategjive ekzistojnë kufijtë e lejuar për t'u investuar në to.

FKPK-ja këtë vit rriti prezencën e investimeve në Kosovë, duke i shfrytëzuar maksimalisht mundësitë ligjore dhe potencialin financiar për të investuar mjete, dhe aktualisht janë vetëm dy opsione investuese: investimi në fletobligacionet e Qeverisë dhe depozitat e bankave.

Në tabelën në vijim janë prezantuar klasat e asetëve të ndërlidhura me strategjitë përkatëse, alokimi faktik i mjeteve më 31 dhjetor 2019 dhe kufijtë përkatës të përcaktuar me strategjinë e Bordit Drejtues në fuqi në atë datë.

KLASA E ASETIT	STRATEGJIA	ALOKIMI FAKTIK	KUFIJTË
Kesh/Tregu i parasë/Bono të KS	Ofrim interesi	25.0%	1%-50%
Obligacione të KS	Ofrim interesi	13.9%	0%-20%
Obligacione	Me synim kthimin	7.7%	0%-25%
Multi-asete	Menaxhim/targetim risku	39.6%	25%-55%
Aksione	Menaxhim/targetim risku	6.4%	0%-20%
Aksione	Me synimin kthimin	7.4%	0%-35%

Fondet multi-asete nënkuptojnë fondet që në përbërje kanë edhe aksione edhe instrumente borxhi të shteteve dhe korporatave botërore. Këto fonde synojnë të zgjedhin aksione dhe instrumente borxhi me potencialin më të madh (të perceptuar) për të gjeneruar kthime pozitive, nën besimin se luhatshmëria më e ulët e instrumenteve të borxhit do të kundërpeshojë luhatshmërinë e aksioneve dhe do të zvogëlojë rrezikun e përgjithshëm. Kur mendohet mbrojtja e strategjisë investuese, këto fonde ndryshojnë alokimin në aksione dhe obligacione edhe për të ulur nënseksione të riskut brenda secilës klasë të mjeteve. Ato, gjithashtu, mund të vendosin alokime përmes derivateve (siç janë *futures* - marrëveshje për ekzekutimin e instrumenteve financiare në të ardhmen, me një datë dhe çmim të ripërcaktuar), në mënyrë që të mbrohen nga tregjet që shkojnë në drejtim të padëshiruar.

Fondet që përshtasin menaxhimin e riskut me shënjestrimin e tij, përcaktojnë një nivel (cak) risku për luhatshmërinë e portofolit investues dhe në baza të rregullta ata i rialokojnë mjetet për luhatshmërinë e pritshme me atë nivel të risk të përcaktuar. Fondet me strategji dividendi në portofolin investues përzgjedhin vetëm aksione nga korporatat stabile e që rregullisht paguajnë dividend. Me "Ofrim interesi" bëhet fjalë për plasmane direkte në instrumente që paguajnë interes, si p.sh. depozitat bankare dhe fletobligacionet e Kosovës. Investimet në instrumente drejtimore nuk kanë një element shoqëruar të administrimit të rrezikut dhe përfaqësojnë një pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në rreziqet dhe përfitimet e tregjeve financiare. Në faqen në vijim janë ofruar informacionet se ku bëjnë pjesë secili prej plasmaneve të FKPK-së.

SHPËRNDARJA E MJETEVE SIPAS INVESTIMEVE

€484.1 mln investimet në Kosovë - në fletobligacione e depozita bankare.

Në fund të vitit mjetet nën menaxhim të FKPK-së, €1,967.4 mln, ishin të shpërndara si në vijim: €1,480.0 mln ishin të investuara në tregjet financiare globale përmes fondeve investuese (2018: €1,347.3 mln); €298.5 mln ishin të investuara në fletobligacione të Kosovës (2018: €209.0 mln); €185.6 mln ishin të afatizuara me bankat BKT, NLB, TEB, ISB, PCB, RBK, BPB dhe BEK (2018: €119.4 mln në BKT, NLB, TEB, ISB, PCB, RBK, BPB dhe BEK); ndërkaq €3.0 mln ishin në BQK të painvestuara (2018: €126.6 mln) dhe €0.3 mln ishin në llogarinë e brokerit Erste Bank Austri (2018: nuk kishte).

Bordi Drejtues gjatë vitit mori 22 vendime për tërheqjen ose shtimin e mjeteve brenda fondeve investuese të angazhuara. Një vendim ishte për tërheqje të plotë të investimit nga ai fond (Schroders SISF) me vlerë prej 62.4 milionë, ndërsa katër vendime ishin për shtime të fondeve të reja investuese, në vlerë prej 217.6 milionë në fonde ETF (si investim në klasë të re instrumentesh financiare).

Gjatë vitit, me qëllim ribalancimi, Bordi Drejtues ka lëvizur në total 1.43 miliardë euro, duke tërhequr dhe shtuar fonde sipas parashikimeve për lëvizjen e tregjeve financiare dhe në pajtim në obligimet ligjore që Bordi ka.

Bordi Drejtues mbajti, përgjithësisht, një pozicionim më të theksuar konservator, duke e ulur ndjeshëm ekspozimin ndaj instrumenteve me risk më të lartë.

Kështu në fund të 2019-s 24.8% e mjeteve ishin në para të gatshme, 21.6% në instrumente të borxhit, 39.7% në multi-asete dhe vetëm 13.9% në aksione.

Gjatë vitit nga investimet në Thesarin e Kosovës maturuan 55.1 mln ndërsa Bordi i shtoi gjatë vitit në këtë instrument edhe 140.0 mln. Në fund të vitit investimet e FKPK-së në Thesarin e Kosovës ishin 298.5 mln, duke zënë kështu 15.3% të totalit të investimeve, e rritur kështu lehtësisht nga një vit më parë (2018: 13.4%). Me një mesatare të alokimit prej 5.3% gjatë vitit 2019, investimet në Thesarin e Kosovës kanë kontribuar mesatarisht me rreth 3.6% (2018: 2.4%) në totalin e performances së investimeve të FKPK-së.

Megjithatë duhet pasur parasysh se performanca në investimet në Thesarin e Kosovës varet nga jetëgjatësia e investimit si dhe periudha e maturimit të investimeve. Bordi Drejtues i FKPK-së vazhdon ta ketë në prioritet shtimin e investimeve në vend.

Ndërsa depozitat në bankat lokale arritën në vlerën e 185.7 mln në fund të 2019-s, nga 119.3 mln sa ishin një vit më parë. Këtë vit maturuan 77.5 mln në depozitat bankare dhe Bordi vendosi të depozitoheshin edhe 141.5 mln në tetë banka në Kosovë (BEK, BKT, BPB, ISB, NLB, PCB, RBK dhe TEB). Viti u mbyll kështu duke pasur 9.4% të mjeteve të FKPK-së në këto depozita.

INVESTIMI	KLASA/STRATEGJIA	MJETET (mln)	ALOKIMI
Vanguard - Global Stock Index Fund	Aksione/Me synim kthimin	€47,484,682	2.4%
Nordea 1 - Stable Return Fund	Multi-asete/Menaxhim risku	€229,047,644	11.6%
Nordea 1 - Global Stable Equity Fund Unhedged	Aksione/Menaxhim risku	€126,488,567	6.4%
BNY Mellon - Real Return Fund	Multi-asete/Kthim absolut	€270,436,971	13.7%
AXA - Global Inflation Linked Bonds Fund	Instrumente të borxhit/Me synim kthimin	€29,528,301	1.5%
AXA - World Fund Optimal Income	Multi-asete/Kthim absolut	€41,948,628	2.1%
Schroders - Global Diversified Growth Fund	Aksione/Dividend	€43,638,302	2.2%
Amundi - Amundi Rendement Plus I2	Multi-asete/Menaxhim risku	€85,540,345	4.3%
Amundi - 3M I	Tregu i parasë së gatshme	€273,862,765	13.9%
BNP Paribas IP - Parvest Diversified Dynamic	Multi-asete/Menaxhim risku	€111,532,837	5.7%
Corp Bond Eur ETF	Obligacione - Drejtimore	€61,306,550	3.1%
S&P500 Minvol ETF	Aksione - Drejtimore	€50,394,634	2.6%
Amundi EurCorp ETF	Obligacione - Drejtimore	€61,168,064	3.2%
MSCI USA Qual ETF	Aksione - Drejtimore	€47,680,019	2.4%
Thesari Kosovës	Fletobligacione të KS/Ofrim interesi	€298,483,698	15.3%
BKT, NLB, TEB, ISB, PCB, RBK, BPB, BEK	Depozita/Ofrim interesi	€185,713,008	9.4%
TOTALI I MJETEVE TË INVESTUARA		€1,968,213,025	99.8%
Mjete të painvestuara (mjetet në BQK dhe para e gatshme në tranzicion)		€3,279,603	0.2%

Shënim: Detajet për secilin fond investues prezantohen në pasqyrat financiare në kapitujt aneks 7 dhe 8 të këtij raporti.

EVROPË
€1,196,327,631
60.82%

AMERIKË
€524,768,380
26.68%

AZI
€87,237,215
4.44%

OQEANI
€23,193,416
1.18%

AFRIKË
€2,069,278
0.11%



NR.	SHTETI	%	MJETET
1.	Kosovë	25.0%	€492,053,260
2.	SHBA	24.1%	€474,374,603
3.	Francë	10.1%	€199,638,970
4.	Mbretëri e Bashkuar	7.0%	€137,919,727
5.	Gjermani	4.5%	€89,385,232
6.	Itali	2.4%	€47,357,067
7.	Holandë	1.9%	€38,312,217
8.	Japoni	1.9%	€37,471,701
9.	Kanadë	1.9%	€36,415,889
10.	Spanjë	1.6%	€31,267,036
11.	Luksemburg	1.5%	€28,924,375
12.	Zvicër	1.2%	€23,803,056
13.	Irlandë	1.1%	€22,382,376
14.	Australi	1.0%	€18,806,457
15.	Danimarkë	0.9%	€17,699,860
16.	Greqi	0.6%	€12,051,095
17.	Hong-Kong	0.6%	€11,783,973
18.	Belgjikë	0.6%	€11,527,062
19.	Suedi	0.6%	€11,399,538
20.	Kinë	0.6%	€11,240,311
21.	Portugali	0.6%	€10,909,886
22.	Kore e Jugut	0.5%	€10,516,737
23.	Meksikë	0.3%	€6,638,287
24.	Indi	0.3%	€6,281,548
25.	Hungari	0.3%	€5,591,821
26.	Izrael	0.2%	€4,617,231
27.	Zelandë e Re	0.2%	€4,401,775
28.	Brazil	0.2%	€4,207,542
29.	Norvegji	0.2%	€3,321,938
30.	Austri	0.2%	€3,131,624
31.	Finlandë	0.1%	€2,315,229
32.	Tajlandë	0.1%	€2,047,595
33.	Singapor	0.1%	€1,987,950
34.	Afrikë e Jugut	0.1%	€1,864,095
35.	Tajvan	0.1%	€1,783,988
36.	Indonezi	0.1%	€1,734,383
37.	Poloni	0.1%	€1,407,154
38.	Turqi	0.1%	€1,343,463
39.	Ishujt Kajman	0.1%	€1,261,821
40.	Peru	0.1%	€1,133,927
41.	Të tjera	7.0%	€136,644,788

Paratë e investuara përmes fondeve të hapura investohen nga menaxherët e këtyre fondeve në aksione, instrumente borxhi, para të gatshme dhe në instrumente të tjera financiare të korporatave botërore dhe të shteteve sovraane. Në fund të vitit FKPK-ja kishte investime direkte dhe indirekte në instrumente financiare të 2,705 emetuesve botërorë [2018: 2,531].

SHËNIM: Në këto llogaritje nuk janë përfshirë paraja e gatshme dhe mjetet në BQK.

THESARI I KOSOVËS BINDSHËM ME ALOKIMIN MË TË LARTË

EMETUESIT KRYESORË

Lista e 25 emetuesve kryesorë [prej gjithsej 2,705] prezantohet më poshtë. FKPK-ja ekspozohet ndaj këtyre emetuesve në mënyrë indirekte, përmes fondeve investuese, gjersa plasmanet në Thesarin e Kosovës, depozitat me afat [në bankat lokale dhe ato ndërkombëtare] janë direkte.

Thesari i Kosovës bindshëm në krye të listës së top investimeve individuale me 15.2% të mjeteve të alokuara, e dyfishuar prej 12.4% që ishte vitin e shkuar. Investimet në fondet e përziera me interes fiks, prej 4.5% ishin të dytat ndërsa Thesari i SHBA-ve, i reduktuar ndjeshëm në 2.7%, nga 5.58% para një viti, ishte i treti.

Kufizimet ligjore kërkojnë që FKPK-ja të mos tejkalojë plasimet siç vijojnë: a) jo më shumë se 30% në Thesarin e Kosovës; b) jo më shumë se 20% e mjeteve në fletobligacione borxhi të një emetuesi të vetëm të vlerësuar me AA ose më lartë; c) 10% në fletobligacione të vlerësuar me A ose më lart; d) 5% në fletobligacione të vlerësuar BBB ose më ulët; e) jo më shumë se 5% e mjeteve në një emetues të vetëm për aksione; dhe f) deri 1% në fletobligacione të vlerësuar BB+ ose më ulët. FKPK-ja nuk i ka tejkalluar asnjë nga këta kufij për investimet në një emetues të vetëm më 31 dhjetor 2019.

EMETUESI	MJETET (mln)	ALOKIMI I MJETEVE
1. Thesari i Republikës së Kosovës	€299.16	15.2%
2. Fonde të përziera	€88.31	4.5%
3. Thesari i SHBA-ve	€53.99	2.7%
4. Para të gatshme në banka	€52.23	2.7%
5. Fonde të përziera në aksione	€42.92	2.2%
6. NLB Bank Kosovë	€39.64	2.0%
7. Fonde të përziera alternative	€37.02	1.9%
8. TEB Bank Kosovë	€33.42	1.7%
9. BKT Bank Kosovë	€31.85	1.6%
10. PCB Bank Kosovë	€28.26	1.4%
11. Thesari i Republikës së Italisë	€22.32	1.1%
12. Intesa Sanpaolo SpA	€20.61	1.0%
13. Societe Generale SA	€20.53	1.0%
14. Groupe Credit Mutuel	€20.52	1.0%
15. Fonde të përziera - tregu i parasë	€20.01	1.0%
16. BEK Bank Kosovë	€19.84	1.0%
17. BPB Bank Kosovë	€17.56	0.9%
18. Groupe BPCE	€17.44	0.9%
19. UniCredit SpA	€15.41	0.8%
20. AT&T Inc	€12.90	0.7%
21. Thesari i Mbretërisë së Spanjës	€12.25	0.6%
22. Thesari i Republikës së Greqisë	€11.88	0.6%
23. Thesari i Australisë	€11.53	0.6%
24. Johnson & Johnson	€11.08	0.6%
25. HSBC Holdings PLC	€10.77	0.5%

BONOT PËRBËNIN 44.2% TË MJETEVE TË INVESTUARA

Mjetet e investuara të FKPK-së, direkt dhe indirekt, në fund të vitit përbëheshin 44.2% prej instrumenteve të borxhit [nga të cilat 23.7% në bono thesari dhe 20.5% bono korporatash], 34.9% prej aksioneve, 20.6% nga paraja e gatshme, dhe 0.3% e aseteve ishin në derivativa.

Nga 44.2% e totalit të investimeve që zinin instrumentet e borxhit dhe 20.6% në tregun e parasë së gatshme, 95.1% e tyre ishin në instrumente që nuk ishin të klasifikuara me nivel të lartë të rrezikut, 4.9% ishin pa rejting.

Investimet në Kosovë, përkundër se nuk kanë rejting, vlerësohen *de-facto* nga ligji me siguri të lartë të kthimit nga investimi.

Investimet në Kosovë përbëheshin nga investimet në Thesarin e Kosovës [sa 15.2% e të gjitha investimeve] dhe nga depozitat bankare [sa 9.4% e të gjitha investimeve].

Ndërsa investimet jashtë Kosovës që ishin në instrumente pa rejting ishin sa 0.6% e të gjitha investimeve.

Ndërsa sa i përket valutave, plasmanet, direkte dhe indirekte, në fund të vitit ishin në instrumente të valutave kryesore botërore, si në vijim: EUR 69.3%, dhe të mbrojtura [hedged] si në vijim: USD 21.3%; GBP 3.0%; JPY 1.3%; CAD 1.3%; DKK 1.1%; dhe të tjera 2.7%.

REJTINGU I PLASMANEVE NË INSTRUMENTE TË BORXHIT DHE NË INSTRUMENTET INDIREKTE TË PARASË SË GATSHME

RISKU	REJTINGU	CILËSIA E PLASMANIT	INSTRUMENTET E BORXHIT DHE PARAJA E GATSHME
	--	Investimet në Kosovë	24.6%
	--	Jashtë Kosovës	0.6%
	AAA	I dorës së parë	4.9%
	AA	I lartë	3.4%
	A	I mesëm i epërm	9.6%
	BBB	I mesëm i ulët	10.5%
	BB	I ulët	2.1%
	B	Me risk të moderuar	0.4%
	C dhe më i ulët	Me risk të lartë	0.1%

PERFORMANCA E INVESTIMEVE

Kthimi bruto për vitin ishte €160.8 mln ose një ngritje prej 8.9% e çmimit të njësisë

Performanca e investimeve të FKPK-së arriti të jetë mjaft e kënaqshme për vitin 2019. Kthimi bruto nga investimet ishte 160.8 mln, ndërsa çmimi i njësisë u ngrit për 8.9%. Kthimi nga investimet i këtij viti, në vlerë nominale, njëkohësisht është edhe më i larti ndonjëherë për institucionin.

Kjo u arrit njëkohësisht duke respektuar katër parimet e vendosura në Ligjin për Fondet Pensionale, të cilat janë: 1) siguria e fondit pensional; 2) shumëllojshmëria e investimit; 3) fitimi maksimal në përputhje me sigurinë e fondit pensional dhe 4) mirëmbajtja e likuiditetit adekuat.

Pothuajse 75% e mjeteve të FKPK-së gjatë 2019-s ishin investuar në tregjet financiare ndërkombëtare. Edhe pse viti u përmbyll me rritje të fortë të performancës së tregjeve, përgjatë vitit disa risqe dhe pasiguri i përcollën ato: me vlerësimin shumë të lartë të aksioneve, me përqendrimin e fitimit të pritshëm të korporatave, me luftën tregtare të pazgjidhur deri në fundviti dhe me tensionet gjeopolitike gjithandej globit.

Si rrjedhojë e kësaj klime të pasigurt investuese, dhe për të qenë në linjë me mandatin (për të siguruar alokim të kujdesshëm të investimeve) shpërndarja e investimeve është përshtatur përmes planit të vazhdueshëm taktik.

Vitin e kishim filluar me një ekspozim të lartë ndaj riskut, meqë korrigjimi i fundvitit 2018 ishte konsideruar i tepruar. Por më pas, veçanërisht gjatë periudhës maj deri gusht, FKPK-ja ka treguar kujdes të shtuar dhe i ka reduktuar investimet me risk të lartë. Ndërsa në pjesën e fundit të vitit, kemi parë një ambient të përmirësuar ekonomik, me më pak risk të shfaqjes së recesionit ekonomik, me një seri të kënaqshme të fitimeve të korporatave, me relaksim të marrëdhënieve tregtare SHBA-Kinë dhe zbehjen e riskut të ngritjes së normave ose inflacionit. Si rezultat i kësaj, FKPK-ja e ka ngritur paksa pozicionimin e saj në aksione.

Nga monitorimi dinamik i pozicionimit të investimeve, FKPK-ja e ka arritur një performancë vjetore prej 8.9% gjersa risku i ndërmarrë i portofolit të saj ishte shumë i përmbajtur, me një luhatshmëri vjetore prej 2.3%. Kjo rezultoi në një raport kthim/risk rekord të FKPK-së prej 3.9 [kur aksionet globale patën raport prej 1.6-2.4], duke e përmbushur kështu synimin e maksimizimit të fitimit në raport me riskun e ndërmarrë.

Përveç kësaj, Bordi e ka ngritur (në rekord) vlerën e investimeve në Kosovë, si në letrat me vlerë ashtu edhe depozitat bankare. Në fund të 2019-s përafërsisht 25% e mjeteve (rreth 500 milionë euro) ishin të investuara në vend.

PERFORMANCA KUNDREJT BENÇMARKUT

Bordi Drejtues i FKPK-së e ka caktuar Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Kosovë, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si cak (bençmark) për performancën e saj investuese.

Bordi Drejtues beson se tejkalimi i këtij caku është kyç për ta mbajtur vëmendjen tek ruajtja e vlerës reale të kontributeve në afatgjatë.

Kthimi tejet pozitiv nga investimet e FKPK-së prej +8.9% e tejkaloi dukshëm nivelin e inflacionit për vitin 2019, që ishte 1.1%.

Në këtë mënyrë, FKPK-ja vazhdoi dukshëm jetë më mirë se bençmarku i saj prej themelimit, më 2002. Për këtë periudhë FKPK-ja ka pasur rritje të çmimit të njësisë prej 51.1% kundrejt rritjes prej 39.0% të CPI në Kosovë.

KRAHASIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT TË FKPK-SË DHE INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT NË KOSOVË PREJ THEMELIT E DERI NË FUND TË 2019-S



PLASMANI	ALOKIMI MESATAR	KONTRIBUIMI NETO	KTHIMI BRUTO [mln]	PERFORMANCA
Vanguard GSIF	7.9%	33.3%	€48.97	+2.64%
SP500 MinVol ETF	1.4%	17.6%	€4.53	+0.24%
MSCI US Quality	0.1%	-1.7%	€-0.03	-0.00%
Schroders SB	1.1%	2.8%	€0.57	+0.03%
Schroders GDG	2.4%	11.7%	€5.24	+0.28%
AXA - GILB	2.1%	5.4%	€2.07	+0.11%
AXA - WFOI	2.3%	13.2%	€5.74	+0.31%
BNY Mellon - RRF	11.2%	11.2%	€23.18	+1.25%
Nordea 1 - GSEF	5.2%	29.9%	€28.88	+1.56%
Nordea 1 - SRF	10.9%	8.5%	€17.04	+0.92%
Amundi 3M	20.8%	-0.2%	€-0.83	-0.04%
Corp Bond Eur ETF	1.2%	-2.8%	€-0.64	-0.03%
BNP Paribas - PDP	3.2%	16.5%	€9.76	+0.53%
Amundi - RPI2	4.4%	8.9%	€7.19	+0.39%
Amundi EurCorp ETF	1.2%	-3.4%	€-0.79	-0.03%
Bono Thesari të Kosovës ⁽¹⁾	8.1%	3.1%	€4.85	+0.25%
Letra me Vlerë të Kosovës ⁽¹⁾	1.9%	0.5%	€0.45	+0.02%
Depozita me afat në Kosovë ⁽¹⁾	12.8%	2.2%	€2.26	+0.28%
Suficiti i kthyer	--	--	€2.30	--
GJITHSEJ	100.0%	8.7%	€160.76	8.9%

⁽¹⁾ Mesatarja e ponderuar.

04

KONTRIBUIMI DHE PENSIONIMET

- 63 Fillimi dhe pasivizimi i kontribuimit
- 64 Kontribuimi
- 65 Kur dhe si mund të tërhiqen kursimet pensionale?
- 66 Pensionimet dhe pagesat e benefiteve

FILLIMI DHE PASIVIZIMI I KONTRIBUIMIT

Kontributet e arkëtuara vjetore u rritën për 7.9%. Pagesa e benefiteve u ngrit për 67.7%. Kontribuuesit nismëtarë ishin sa 11.0% e kontribuuesve aktivë.

Kontribuues aktivë FKPK-ja i quan personat që paguan kontribute për vitin e raportimit, në këtë rast për vitin 2019. Në anën tjetër, kontribuues nismëtarë FKPK-ja i quan ata kontribuues aktivë, 11.0% e tyre, që për herë të parë paguan kontribute në dhe për vitin 2019 [2018: 10.8%].

Kontribuuesit nismëtarë numëruan gjithsej 41,775, ndërsa ishin 37,348 të tjerë, ose 9.8% e kontribuuesve aktivë, të cilët pushuan [kontribuan më 2018 por jo më 2019]; dhe në këtë numër nuk janë përfshirë 7,808 kontribuues nga llogaritë e të cilëve u tërhoqën kursimet gjatë vitit 2019. Ndërkaq, 11.4% e kontribuuesve nismëtarë u punësuan⁽¹⁾ për herë të parë në moshën 40+ vjeçare [2018: 11.9%].

Mosha mesatare e kontribuuesve nismëtarë ishte 26 vjeç, gjersa 65% e tyre ishin 25 vjeç ose më të rinj [2018: përkatësisht 27 dhe 57% e tyre ishin 25 vjeç ose më të rinj].

Të vetëpunësuarit, që përbënin rreth 1.7% të kontribuuesve nismëtarë [2018: 2.1%], ishin në mesatare më të moshuar. Mosha e tyre mesatare ishte 34 vjeç, dhe 57% e tyre ishin 33 vjeç ose më të rinj.

Pjesa e femrave nismëtare ishte 44.9% për të punësuarat [2018: 43.6%]; dhe 34.6% [2018: 35.2%] për të vetëpunësuarat.

Në anën tjetër shifrat tregojnë se femrat u pasivizuan në norma më të ulëta sesa që po nisin të kontribuojnë, duke përbërë kështu 35.6% nga të punësuarit dhe 21.3% nga të vetëpunësuarit që u pasivizuan [2018: përkatësisht 34.2% dhe 21.0%].

Pasivizimi kontribuuesve edhe këtë vit më së shumti iu ndodhi grupmoshave 20-25 vjeç [2018: 20-25 vjeç]. Më tej, 50% e kontribuuesve të 2018-s që ishin pasiv gjatë vitit ishin 29 vjeç ose më të rinj tek të punësuarit dhe 40 vjeç ose më të rinj tek të vetëpunësuarit [2018: 50% e kontribuuesve 28 dhe 41 vjeç, respektivisht]. Këto të dhëna [të qëndrueshme ndër vite] krijojnë bazë për të gjykuar se ka një stabilitet më të vogël të punës për moshat më të reja dhe/ose angazhimi i tyre është sezonal.

Përqindja e kontribuuesve [duke përfshirë të vetëpunësuarit] që janë bërë pasivë më 2018 por që u rikthyen në skemën e kontribuimit më 2019 ishte 28.3% [2018: 16.9%].

Analizimi i të dhënave për pesë vjetët e fundit nxjerr në pah se 192,078 kontribuues të punësuar, dhe 19,806 kontribuues të vetëpunësuar, kanë kontribuar së paku një muaj në secilin nga këto pesë vjet [2018: 181,539 dhe 19,479].

KONTRIBUIMI

Janë €1,781.4 mln kontribute të arkëtuara qysh prej themelimit të institucionit dhe 1,967.4 mln mjete nën menaxhim.

Totali i kontributeve të arkëtuara gjatë 2019-s ishte €186.6 mln [2018: €172.7 mln], që janë pagesa të kontributeve pensionale që punëmarrësit dhe të vetëpunësuarit i kanë bërë gjatë vitit 2019.

Kontributet e arkëtuara gjatë 2019-s u rritën për 7.9% krahasuar me vitin paraprak. Më 2018 ato ishin rritur për 8.1% dhe më 2017 me 5.4%.

Kontributet që nuk janë nën menaxhim, ose €210.5 mln [2018: €176.7 mln], janë kontribute të tërhequra me rastin e pagesave të benefiteve ose refondimeve, dhe më nuk janë pjesë e fondit.

Punëdhënësit e rinj, që ishin 4,853, që shënoi një rritje domethënëse prej 12.5% krahasuar me vitin paraprak [2018: 4,313]. Punëdhënësit të rinj konsiderohen bizneset, institucionet etj. të cilat për herë të parë kontribuojnë për punonjësit e tyre.

Në anën tjetër numri i punëdhënësve që u pasivizuan ishte 3,948 duke njohur një rënie prej -1.9% [2018: 4.8%] në krahasuar me numrin e vitit paraprak [2018: 4,025].

Punëdhënës që pasivizohen FKPK-ja i konsideron bizneset ose institucionet ose organizatat të cilat kanë kontribuar për punonjës gjatë vitit paraprak por jo edhe në vitin e raportimit.


Por më 2019 përveç se kishim rritje të numrit të punëdhënësve të rinj dhe rënie të punëdhënësve të pasivizuar, edhe numri i kontribuuesve aktivë për vitin pësoi ngritje me 7.9%, kundrejt 6.3% që ishte rritur më 2018, dhe arriti në 33,317 [2018: 30,487].

Në fund të vitit, bilanci mesatar për të gjitha llogaritë e kursimeve pensionale të kontribuuesve ishte €3,284 [2018: €2,947].

KONTRIBUTET DHE MJETET NËN MENAXHIM

VITET	TË ARKËTUARA (mln)	MJETET NËN MENAXHIM (mln)
2002-2015	€1,110.8	€1,229.5
2016	€151.5	€188.6
2017	€159.8	€216.8
2018	€172.7	€46.6
2019	€186.6	€285.9
GJITHSEJ	€1,781.4	€1,967.4

PËRBËRJA E MJETEVE NETO NËN MENAXHIM



1

Termi "Punësim" është përdorur në kontekstin më të gjerë të mundshëm. FKPK-ja nuk është në pozitë të dijë nëse kontributet e nismëtarëve janë vërtetë si rrjedhojë e punësimit të tyre të parë. Për më tepër, FKPK-ja nuk mund të dijë se ai punësim a është i përhershëm, me afat, a për një punë të caktuar [kontratë mbi vepër].

KUR DHE SI MUND TË TËRHIQEN KURSIMET PENSIONALE?

Kur mund të tërhiqen kursimet pensionale nga kontribuuesi:

- a)** kur arrin moshën e pensionit [aktualisht me ligj është caktuar moshë 65 vjeç];
- b)** kur merr ndihmë invaliditeti nga MPMS; ose
- c)** kur vdes para tërheqjes së kursimeve pensionale, e që në këtë rast trashëgimtarët ligjor të tij/saj e tërheqin gjithë bilancin e kursyer.

Programi i Tërheqjes në Faza (PTF)

PTF është i tillë që përfituesit në këtë skemë tërheqin nga kursimet e tyre çdo muaj nga €200 ose 1% të bilancit në momentin e pensionimit (cilido qoftë më i ulët), derisa e gjitha shuma të shterojë.

Përfituesit mund të zgjedhin njërin nga katër bankat që ofrojnë shërbimin PTF: TEB, NLB Prishtina, Banka për Biznes ose Banka Ekonomike, duke përfituar kështu nga një trajtim specifik, sipas kontratës së FKPK-së me këto banka.

Si mund të tërhiqen kursimet pensionale?

Kontribuuesit që tërheqin kursimet pasi arrijnë moshën e pensionit zgjedhin të marrin 0% ose 20% të kursimeve në një pagesë dhe shuma tjetër iu drejtohet në PTF.

Sidoqoftë, nëse një kontribuues ka një bilanc në llogari me më pak se €3,000¹⁾ kursime atëherë e gjitha shumta tërhiqet me një pagesë. Kontribuuesit që tërheqin kursimet për shkak të invaliditetit do të marrin kursimet e tyre përmes PTF në shumë prej €200¹⁾ deri në: i) periudhën që u mbaron invaliditeti; ose ii) derisa kursimet e tyre shterojnë - cilado të ndodhë e para. Në anën tjetër, përfituesit e kontribuuesve të vdekur mund të zgjedhin që të tërheqin të gjitha kursimet menjëherë ose t'i transferojnë ato në llogarinë e tyre të kursimeve pensionale në FKPK.

¹⁾ *Tërheqja minimale mujore dhe pragjet e tërheqjes përcaktohen nga Rregulloret e BQK-së.*

Ndërsa numri i shtetasve të huaj që i tërhoqën mjetet ishte 32 (që përbënin 0.3% të të pensionuarve), dhe shuma e tërhequr nga ta ishte rreth €170 mijë.

Përveç këtyre, ishin 880 raste që tërhoqën kursimet nga trashëgimtarët e kontribuuesve që vdiqën para se t'i tërhiqnin fondet e tyre nga FKPK-ja [2018: 868], duke përbërë kështu 8.5% të aplikacioneve të miratuara [2018: 15.8%]. Në 35.5% të rasteve të vdekjeve kontribuuesit ishin më të rinj se 55 vjeç kur vdiqën, 21.0% ishin 55-59, 32.0% ishin 60-64 vjeç dhe 11.5% mbi 65 vjeç.

Shumat e drejtuara në PTF ishin në vlerë €31.2 mln, ndërsa €1.2 mln u tërhoqën nga përfituesit me një pagesë të vetme [2018: €24.9 mln, përkatësisht €6.4 mln].

Nga 3,599 persona që ishin në PTF gjatë vitit, 82.4% e tyre edhe e shfrytëzuan mundësinë e tërheqjes së 20% të bilancit menjëherë.

Bilanci mesatar i llogarive të pensionuara për këtë vit ishte €6,650 e ngritur nga €5,654 që ishte një vit më parë.

TËRHEQJET

VITET	KONTRIBUTE (mln)	MJETE (mln)
2004-2014	€50.2	€53.3
2015	€15.8	€19.3
2016	€16.0	€19.2
2017	€22.1	€27.7
2018	€24.8	€31.3
2019	€41.9	€52.6
TOTALI	€170.8	€203.4

PENSIONIMET DHE PAGESAT E BENEFITEVE


Gjatë 2019-s janë realizuar fitime prej 20.4% nga të gjitha llogaritë e pensionuara. Më 2018 kjo shifër ishte 20.8%.

Gjatë 2019-s Administrata ka miratuar 7,808 aplikacione të reja për tërheqjen e kursimeve pensionale [2018: 5,435]. Totali i fondeve që u paguan për tërheqjet e kursimeve gjatë vitit 2019 ishte €52.6 mln, e që përbëheshin nga kontributet nominale prej €41.9 mln dhe fitime të realizuara prej €10.7 mln [2018: €31.3 mln, përkatësisht €24.8 mln dhe €6.5 mln]. Totali i llogarive me tërheqje prej themelimit arriti në 51,755 dhe vlera e shpague për këto llogari shkoi në €203.4 mln.

Numri i personave që tërhoqën mjetet gjatë vitit 2019 pasi kishin arritur moshën e pensionimit [65 vjeçare] ishin 4,938 ose 63.2% e aplikacioneve të miratuara [2018: 4,354, ose 80.2%].

Risi këtë vit ishte vendimi i cili i jepte të drejtë të gjithë invalidëve të luftës t'i tërhiqnin retroaktivisht kursimet pensionale, duke bërë që numri dhe vlera që kjo kategori tërhoqi të rritet ndjeshëm. Pikërisht për këtë për shkak të invaliditetit mjetet i tërhoqën 1,430 persona, ose 18.3% e aplikacioneve të miratuara [2018: 172 ose 3.4%].

MJETET E TËRHEQURA QË U DREJTUAN NË PTF



05

DEMOGRAFIA E KONTRIBUTEVE

- 69-70 Kontribuuesit
- 71-71 Shpërndarja gjeografike e kontribuuesve
- 73 Moshë e kontribuuesve
- 74 Kontribuuesit sipas llojit të ndërmarrjeve
- 77-78 Kontribuimi mesatar
- 79 Niveli i kontribuimit
- 80 “Sa duhet të kurseni?”

KONTRIBUESIT

Ky kapitull përmbledh të dhënat kryesore demografike për kontribuuesit e FKPK-së më 2019 dhe bën krahasimet me vitin paraprak.

Është me rëndësi të theksohet se ky kapitull paraqet rezultatet e analizave vetëm për kontribuuesit aktivë, dhe jo të të gjithë llogarimbajtësve të FKPK-së, e që në fund të 2019-s ishin 669,973 në numër.

Këtë vit ishin 379,827 kontribuues aktivë [2018: 344,453]. Me së paku një kontribut si punonjës gjatë vitit shfaqen 352,065, dhe si të vetëpunësuar 22,890; në këto shifra të numëruar dy herë janë 4,872 kontribuues, të cilët shfaqen gjatë 2019-s edhe si të punësuar edhe si të vetëpunësuar.

Është tejet pozitiv fakti që për çdo muaj të vitit 2019 kishin kontribuues aktivë më shumë sesa një vit më parë. Po ashtu në mesatare këtë viti kishim gati 69 mijë kontribuues më shumë sesa një vit më parë. Arsye kryesore për këtë mund të jetë rritja e punësimit në vend, por gjithsesi ndikim ka edhe rritja e vetëdijësimi për kontributet pensionale dhe kalimi i të punësuarve nga tregu informal në atë formal.

Mjaft pozitiv këtë vit ishte edhe rritja e bilancit mesatar të të gjitha llogarive në FKPK, që në fund të 2019-s arriti në €3,284 [një ngritje kjo prej 11.4% nga fundviti 2018 kur ishte €2,947]. Rritja e bilancit mesatar këtë vit më së shumti rritet nga kthimi pozitiv nga investimet e FKPK-së, e më pak nga kontributet e reja të kontribuuesve. Ndërsa ky bilanc mesatar [€3,284 euro], nëse do të tërhiqej nga 200 euro në muaj, do të ishte i mjaftueshëm për rreth 16 muaj pension.

Pra përkundër gjithë këtyre ndryshimeve pozitive, bilanci mesatar i të gjitha llogarive është tejet i ulët. Andaj edhe FKPK-ja vazhdon të apelojë që çelësi i kursimit adekuat për pension është kontribuimi i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm.

Kuptohet se arsyeja e kësaj gjendjeje, përveç periudhës së qëndrimit në skemë, është vlera e kontribuimit mujor, që [sidomos për moshat nën 35 vjeç] vazhdon të jetë në nivele të tejet të ulëta.

Me rëndësi është të bëhen edhe disa krahasime mes numri të popullsisë aktive për punë dhe kontribuuesve aktivë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në raportin e TM4 2019 për tregun e punës në vend, popullsia në moshe pune në vend [e moshës 15 deri 64 vjeç] është 1,214,084. Ndërsa fuqia aktive për punë [sipas ASK] llogaritet 506,622, ndërsa pjesa tjetër llogaritet si pasive.

Nën këto kushte, rezultojnë se 379,827 punëmarrës dhe të vetëpunësuar që kontribuan në FKPK gjatë 2019-s përbëjnë 75.0% të fuqisë aktive për punë. Kjo përqindje pastaj rezultojnë më e ulët po të krahasojmë me numrin mesatar të kontribuuesve aktivë në FKPK për 2019-n [324,755] me fuqinë aktive për punë [506,622]. Kështu i bie se 64.1% e fuqisë aktive për punë ishin formalisht të angazhuar në një punë këtë vit.

Andaj, nga këtë të dhëna krahasuese, konkluzioni më i mundshëm mund të jetë shkalla ende e lartë e informalitetit në vend. Dhe kjo në veçanti duket të jetë e vlefshme për sektorin e bujqësisë dhe atë të ndërtimtarisë, në të cilët sektorë ka shpërputhje të madhe në mes të statistikave të punësimit dhe numrit të kontribuuesve në FKPK.

FKPK-ja po i thekson këto gjëra duke besuar se kështu po e përmbush një pjesë të përgjegjësisë sociale që ka: që secili shtetas i Kosovës të ketë kursyer mjaftueshëm për pensionin e vet.

NUMRI I KONTRIBUESVE AKTIVË PËR ÇDO MUAJ NË PESË VJETËT E FUNDIT

	2019	2018	2017	2016	2015
JANAR	348,563	233,144	249,428	223,240	213,584
SHKURT	245,376	237,040	251,291	224,354	213,361
MARS	267,092	264,573	276,991	251,045	238,066
PRILL	298,846	243,872	257,976	232,024	217,922
MAJ	309,239	245,694	259,962	234,600	220,157
QERSHOR	317,408	273,306	284,804	258,103	257,153
KORRIK	328,746	266,564	263,527	236,259	222,381
GUSHT	337,859	249,513	263,255	236,899	222,434
SHTATOR	344,652	274,065	285,900	261,168	245,847
TETOR	352,653	268,030	262,775	235,655	223,038
NËNTOR	366,797	257,866	259,977	232,732	219,408
DHJETOR	379,833	256,425	269,739	245,464	242,841
MESATARJA VJETORE	324,755	255,841	265,469	239,295	227,181

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E KONTRIBUESVE

Meqë një pjesë e madhe e kontribuuesve (rreth 1/3) paguhen nga Ministria e Administratës Publike, zyra e së cilës është e regjistruar në Prishtinë, nuk është e mundur të bëhen analiza mbi atë se ku kanë punuar kontribuuesit gjatë vitit. Kjo është arsyeja përse FKPK-ja prezanton vetëm analiza të bazuara sipas komunave të adresave të kontribuuesve që FKPK-ja i ka në regjistrat e saj.

Sikurse shihet në tabelë, numri i kontribuuesve është ngritur nëpër të gjitha komunat. Megjithëse zakonisht sa herë ka zgjedhje nacionale ose lokale kemi rritje të numrit të kontribuuesve, për shkak se angazhohen staf shtesë, më 2019 kemi të bëjmë me shtim të numrit të kontribuuesve për çdo muaj më shumë sesa më 2018. Ky është tregues që kishim rritje të punësimit dhe/ose kontribuuesve që kalojnë në ekonominë formale.



Rritja e numrit të kontribuuesve aktivë në numër ishte më e larta në Prishtinë, por në përqindje, tek 10 komunat me rritjen më të lartë, printe Vushtrria me rritje prej 13.6%.

Në listën e 10-s së parë numri i kontribuuesve zuri mbi 65% të të gjithë kontribuuesve.

Rënia e lehtë e numrit të kontribuuesve në Prishtinë këtë vit (nga 18.9% në 18.4%) është tregues pozitiv, por nuk mund të vlerësohet ende nëse ky është një ndryshim afatgjatë apo i momentit. Kjo pasi vendi ka nevojë të jashtëzakonshme për uljen e përqendrimit të lartë në qendër, dhe zhvillimi i zonave të tjera (periferike) ndihmon në krijimin e stabilitetit afatgjatë dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

NR.	KOMUNA	NUMRI I KONTRIBUESVE	PJESËMARRJA	NDRYSHIMI ME 2018	
				NË NR.	NË %
1.	PRISHTINË	69,881	18.4%	4,631	7.1%
2.	PRIZREN	30,933	8.1%	3,254	11.8%
3.	FERIZAJ	23,011	6.1%	1,408	6.5%
4.	GJILAN	21,693	5.7%	2,059	10.5%
5.	PEJË	20,683	5.4%	1,647	8.7%
6.	GJAKOVË	19,813	5.2%	1,790	9.9%
7.	PODUJEVË	17,760	4.7%	411	11.9%
8.	MITROVICË	16,326	4.3%	1,883	2.6%
9.	VUSHTRRI	15,570	4.1%	1,860	13.6%
10.	LIPJAN	12,573	3.3%	1,319	11.7%
11.	GLLOGOC	12,297	3.2%	1,177	10.6%
12.	SUHAREKË	10,763	2.8%	1,164	12.1%
13.	SKËNDERAJ	9,967	2.6%	1,058	11.9%
14.	FUSHË KOSOVË	9,832	2.6%	945	10.6%
15.	RAHOVEC	8,668	2.3%	982	12.8%
16.	ISTOG	7,777	2.0%	819	11.8%
17.	MALISHEVË	7,741	2.0%	884	12.9%
18.	VITI	7,423	2.0%	851	12.9%
19.	KAMENICË	6,450	1.7%	598	10.2%
20.	KLINË	6,188	1.6%	357	6.1%
21.	KAÇANIK	5,917	1.6%	535	9.9%
22.	OBILIQ	5,815	1.5%	481	9.0%
23.	DEÇAN	5,365	1.4%	545	11.3%
24.	SHTIME	4,939	1.3%	352	7.7%
25.	DRAGASH	4,379	1.2%	654	17.6%
26.	GRAÇANICË	2,183	0.6%	189	9.5%
27.	LEPOSAVIQ	2,150	0.6%	238	12.4%
28.	SHTËRPECË	1,637	0.4%	198	13.8%
29.	MITROVICË E VERIUT	1,502	0.4%	66	4.6%
30.	HANI I ELEZIT	1,473	0.4%	69	4.9%
31.	ZVEÇAN	1,305	0.3%	219	20.2%
32.	ZUBIN POTOK	1,105	0.3%	121	12.3%
33.	JUNIK	613	0.2%	46	8.1%
34.	MAMUSHË	598	0.2%	45	8.1%
35.	NOVOBËRDË	583	0.2%	79	15.7%
36.	RANILLUG	504	0.1%	35	7.5%
37.	KLLOKOT	501	0.1%	56	12.6%
38.	PARTESH	396	0.1%	56	16.5%
	TË TJERË	3,513	0.9%	847	31.8%

‡ Ky është numri i kontribuuesve me vendbanim jashtë Kosovës ose për të cilët FKPK-ja nuk kishte informacion se cilës komunë i takojnë.

MOSHA E KONTRIBUESVE

Mosha mesatare e kontribuuesve në vitin 2019 u rrit lehtë në 41.0 vjeç nga 40.7 sa ishte në vitin paraprak. Ndërsa mediana nuk ndryshoi, pra mbeti 38 vjeç sikur një vit më parë.

MESATARJA
MESHKUJ:
42.1



MEDIANA
MESHKUJ:
40.0



Ndryshime të lehta kishim tek mesatarja sipas gjinisë, ndërsa mediana nuk ndryshoi fare nga viti i shkuar.

MESATARJA
FEMRA:
37.8



MEDIANA
FEMRA:
35.0



Në përgjithësi nuk kishte ndryshime të rëndësishme në pjesëmarrjen e grupmoshave si përqindje e kontribuuesve aktivë. Pozitive është se pak më shumë se 2/3 e kontribuuesve aktivë ose 68.7% (2018: 67.7%) ishin nën moshën 45 vjeç edhe këtë vit.

Ndryshimi më i madh (i ngritur për 2.2%) ishte tek grupmosha 15-24 vjeç. Ndërsa të gjitha kategoritë e tjera kishin ulje, përveç moshës 65+ që kishte një rritje të lehtë.

GRUPMOSHA	2019	2018
15-24	16.7%	14.5%
25-34	29.1%	29.4%
35-44	22.9%	23.8%
45-54	17.9%	18.6%
55-64	12.4%	12.8%
65+	0.9%	0.8%

KONTRIBUESIT SIPAS LLOJIT TË NDËRMARRJEVE

Lloji i ndërmarrjeve përcaktohet sipas regjistrimit të tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare ose në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Duhet theksuar se ndërmarrjet publike dhe shoqërore (të tilla si kompanitë rajonale të ujësjellësit apo mbeturinave, Posta e Kosovës, ngrrohtoret e qytetit, etj.) shumica e tyre janë të regjistruara si shoqëri aksionare; andaj paraqiten së bashku me ndërmarrjet e tjera publike në kuadër të grupit të shoqërive aksionare.

Më 2019 kishim një rritje të fortë të kontribuuesve në numër tek tri llojet e ndërmarrjeve: organizatat buxhetore (me +25.4%), SH.P.K.-të (me +16.0%) dhe OJQ-të (me 28.2%). Ndërsa e ulët ishte rritje e kontribuuesve tek shoqëritë aksionare (me +2.7%), dhe bizneset individuale (me 2.2%).

Kategoria e ortakëve (me -2.0%) dhe të vetëpunësuarve (-23.9%) njohën rënie, por arsyeja është vështirë të identifikohet, meqë mund të jetë edhe për shkak të ndryshimit të formës juridike të entitetit (psh: nga biznes individual në SH.P.K.).

Për ta ilustruar "angazhimin" do të përdoret shembulli në vijim: nëse dy punonjës gjatë vitit kanë kontribuar njëri 8 muaj e tjetri 4 muaj, atëherë ata në numër përbëjnë dy kontribuues, por në angazhim përbëjnë ekuivalentin e një kontribuuesi që ka kontribuar gjatë gjithë vitit.

LLOJI I NDËRMARRJES	KONTRIBUES NË NUMËR	ANGAZHIMI		NDRYSHIMI ME 2018	
		KOEFICIENTI I ANGAZHIMIT	KONTRIBUES EKUIVALENTË	KONTRIBUES NË NUMËR	KONTRIBUES EKUIVALENTË
Organizata buxhetore	119,736	0.716	85,731	25.4%	4.7%
SH.P.K.	168,289	0.602	101,310	16.0%	16.7%
Biznes individual	71,361	0.652	46,527	2.2%	0.2%
Të vetëpunësuar	28,466	0.843	23,997	-2.0%	-2.3%
Shoqëri aksionare	30,386	0.748	22,729	2.7%	-3.1%
OJQ	22,726	0.377	8,568	28.2%	14.5%
Ortakëri	4,234	0.611	2,587	-23.9%	-28.6%
Të tjera	14,069	0.490	6,894	21.7%	3.8%



KONTRIBUIMI MESATAR

Kontribuimi mesatar (mujor) për kategorinë e të punësuarve u ul paksa në €44.38 nga €44.84 që ishte një vit më parë. Punësimi sezonal (ose afatshkurtër) vazhdon të jetë një faktor me ndikim në nivelin e kontribimit mesatar mujor.

Ndërsa për të vetëpunësuarit mesatarja e kontribimit u rrit krejt lehtë në €33.96 për muaj nga €33.84 që ishte vitin e shkuar.

Kontribuimi mesatar mujor pati luhatje shumë të lehta, krahasuar me 2018, tek të gjitha grupmoshat, përveç moshës 65+.

Sikurse edhe pritej, kontribuimi mesatar mujor rritet në raport të drejtë me moshën e kontribuuesve, duke qenë ky tregues edhe zhvillimit profesional por edhe kujdesit të shtuar ndaj kursimeve pensionale.

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR

VITI	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2017	€39.97	€33.49
2018	€44.84	€33.84
2019	€44.38	€33.96

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GRUPMOSHAVE

	2019		2018		2017	
	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
15-24	€28.81	€20.82	€28.54	€21.18	€26.58	€20.45
25-34	€41.00	€25.82	€40.63	€26.04	€38.57	€26.52
35-44	€51.09	€35.37	€50.83	€35.45	€48.15	€34.97
45-54	€51.30	€37.16	€50.80	€37.15	€48.02	€37.32
55-64	€57.02	€39.40	€56.42	€38.52	€53.45	€37.77
65+	€64.32	€36.43	€60.35	€41.83	€58.03	€37.85

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GJINISË

VITI	FEMRA		MESHKUJ	
	PUNËMARRËSE	TË VETËPUNËSUARA	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2017	€37.35	€26.17	€41.29	€35.02
2018	€41.39	€26.22	€46.65	€35.50
2019	€40.59	€26.53	€46.47	€35.63

NIVELI I KONTRIBUIMIT

Ligji kërkon që kontributi minimal për të vetëpunësuarit, si dhe të punësuarit me kohë të plotë, të bazohet në pagat minimale mujore të Kosovës, e që janë: €130 për personat e moshës deri 35 vjeç; dhe €170 për moshat mbi 35 vjeç.

Këtë vit kishim rritje të numrit të kontribuuesve (punëmarrës) që kontribuan nën minimumin e kërkuar ligjor. Kjo shifër iu afrua 7%-shit, nga rreth 3% që ishte vitin e shkuar.

Kategoria e të vetëpunësuarve kishte pothuajse identike nivelet e kontribuit me një vit më parë, me 52.1% të të gjithë kontribuuesve të kësaj kategorie që paguajnë vetëm sa minimumi (46.5%) ose më pak se minimumi (5.6%).

Kuptohet se kategoria e punëmarrësve, ku bëjnë pjesë të gjithë të punësuarit e sektorit publik, përmbush shumë më kënaqshëm pagesat e kontributeve pensionale.

NIVELET E KONTRIBUIMIT TË PUNËMARRËSVE

	PAGESA		
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
DERI 35 VJEÇ	4.14%	0.29%	45.57%
MBI 35 VJEÇ	2.65%	2.62%	44.72%

NIVELET E KONTRIBUIMIT TË TË VETËPUNËSUARVE

	PAGESA		
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
DERI 35 VJEÇ	0.37%	9.73%	14.57%
MBI 35 VJEÇ	5.18%	36.74%	33.41%

“SA DUHET KURSYER?”

FKPK-ja e sheh si përgjegjësi të sajën, edhe sociale, që t'i këshillojë kontribuuesit se sa do të duhet të kursenin për të arritur një shumë që mund t'ju ofrojë më shumë siguri pas pensionimit.

Andaj në vijim prezantojmë disa këshilla e sugjerime të rëndësishme.

Shembull: nëse supozohet se çmimi i aksionit të FKPK-së çdo muaj do të rritet me një normë konstante prej 4% në vit, një person i cili punësohet në ditëlindjen e tij të 25-të dhe që kontribuon në minimumin ligjor për 40 vjet deri në pensionim, do të ketë një bilanc të akumuluar në llogarinë e tij në FKPK prej €18,142.

Megjithatë, duke qenë se inflacioni e gërryen vlerën e parasë, nëse inflacioni është p.sh. 2% në vit, vlera e sotme e atij bilanci do të ishte €8,216.

Kjo vlerë, e kursyer përmes kontribuit minimal, do të ishte e pamjaftueshme për të blerë një anuitet ekonomikisht të favorshëm të jetës.

Në rrethanat aktuale një person i tillë do të pensionohej në programin e tërheqjes me faza, me mundësi të tërheqjes në një pagesë fillestare të 20% të totalit të bilancit, tërheqjen e shumës së mbetur nga €200 në muaj, që nuk mjaftojnë as për 4 vjet (më saktësisht: 41 muaj).

Produkti i anuitetit të jetës vazhdon të mos ofrohet ende në Kosovë, dhe pa të në treg është e vështirë të përlllogaritet bilanci i kursimeve që do të nevojitet për të blerë një anuitet minimal të jetës.

Në anën tjetër, është paksa e vështirë për t'u besuar se kursime më të ulëta se €25,000 (në vlerën e sotme), do të mjaftonin për të blerë një pension minimal.

Me këtë vlerë si qëllim, një person që punësohet në moshën 25 vjeçare dhe punon deri në pensionim pa pasur asnjë rritje të pagës, duhet kontribuar €41.50 në muaj çdo muaj (punëmarrësi dhe punëdhënësi së bashku). Por nëse i njëjti person çdo vit do të kishte rritje të pagës prej 1%, do të duhet të fillonte me kontribute mujore prej €34.30 dhe të përfundonte me €74.23 në prag të datëlindjes së 65-të.

Në rastin e fundit, kontributet mesatare mujore do të ishin €51.74, për afro €10 më shumë se në rastin e parë, gjë që e qartëson rëndësinë e kontribuit sa më të hershëm dhe me shuma sa më të larta të mundshme.

Natyrisht, ekzistojnë sot shumë persona në Kosovë që në vazhdimësi hyjnë e dalin nga puna, ose janë inkuadruar më vonë në skemë dhe kanë më pak vite për të kursyer; për ta do të jetë shumë e vështirë që të sigurojnë pension të mjaftueshëm vetëm përmes kursimeve obligative pensionale.

Stafi i FKPK-së është këtu për të ndihmuar dhe mund ta këshillojë çdokënd që dëshiron të dijë se si dhe sa duhet të kursejë për një pension më të mirë; ndërkohë që FKPK-ja dhe Bordi i saj do të bëjnë çmos të rrisin vlerën e kursimeve të kontribuuesve me qëllim sigurimin e një pensioni me sa më pak brenge.

06

LEGJISLACIONI

83 Korniza ligjore

84 Ndryshimet e propozuara

KORNIZA LIGJORE DHE NDRYSHIMET

Organizimi, funksionimi dhe vendimmarrja e FKPK-së bazohet në Ligjin Nr. 04/L-101, së bashku me plotësimet dhe ndryshimet me: Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe me Ligjin Nr. 05/L-116, dhe qeveriset nga Bordi Drejtues.

Organizimi ligjor i FKPK-së saktësohet tutje edhe me legjislacionin sekondar: përmes rregulloreve për pensione të BQK-së, dhe udhëzimeve e njoftimeve shpjeguese të ATK-së për mënyrën e deklarimit, kontribuimit, korrigjimit dhe tatimit të kontributeve pensionale.

Këtë vit nuk kishte iniciativa për ndryshime e plotësime në ligjet në fuqi, por nuk kishte as rregullore dhe rregulla të reja.

Në faqen vijuese kemi paraqitur çështje që janë shqetësim [edhe i arsyeshëm] i kontribuuesve, për të cilat FKPK-ja nuk ka bazë dhe/ose qartësi ligjore për t'i trajtuar. Andaj do të ishte e nevojshme shqyrtimi dhe diskutimi për ndryshimin dhe plotësimin e bazës aktuale ligjore brenda së cilës operon FKPK-ja.

PROPOZIMET PËR PLOTËSIME/NDRYSHIME LIGJORE

1. TËRJEQJA E KURSIMEVE PENSIONALE NË RASTIN E DORËHEQJES NGA SHTETËSIA

Stafi i FKPK-së ka pranuar kërkesa dhe shqetësime të shumta të shtetasve kosovarë që janë të gatshëm të dorëhiqen ose janë dorëhequr nga shtetësia kosovare, të cilët kanë emigruar ose janë në proces të emigrimit, por që aktualisht nuk kanë të drejtë ligjore për t'i tërhequr kursimet pensionale nga FKPK-ja. Kjo çështje kërkon trajtim të hollësishëm bazuar edhe në përvojat e shteteve të tjera, meqë FKPK-ja nuk ka qartësi të plotë juridike për ta trajtuar këtë çështje.

2. PENSIONIMI I PARAKOHSHËM

Numri i kontribuuesve që kanë kaluar në pensionim të parakohshëm, pra para moshës 65 vjeçare [qoftë si ish-pjesatarë të TMK, pjesëtar të FSK-së, Trepçës ose zyrtarë policorë], është në rritje dhe FKPK-ja ka vazhdimisht ka pranuar kërkesa nga kontribuues të tillë që kërkojnë tërheqjen e kursimeve pensionale nga FKPK-ja. Por FKPK-ja nuk ka bazë ligjore për të marrë vendime të tilla, meqë këto kategori nuk janë parashikuar e as trajtuar në legjislacionin aktual brenda të cilit operon FKPK-ja. Prandaj, duhet të rregullohet raporti i këtyre përfituesve me llogarinë e FKPK-së, pra, a mund të i tërheqin edhe kontributet nga FKPK apo jo.

3. INVESTIMET

Të lejohet FKPK-ja të investojë përmes fondeve në investime alternative. Kjo do të sigurojë rritje të diversifikimit, duke komplementuar mjetet financiare të kuotuar. Menaxherët e fondeve të aseteve alternative kanë një historik të dëshmuar të kthimeve më të larta, pjesërisht pasi përfitojnë nga nxjerrja e një primum shtesë për shkak të jo-likuiditetit ndaj aseteve tradicionale të kuotuar. Për më tepër, për afate kohore të caktuara ata kanë histori të kthimeve më të mira kundrejt rrezikut. Jetëgjatësia e këtyre investimeve varion nga 5 deri në 10 vjet, duke përbushur kështu një objektiv investimi afatgjatë. Investimet alternative mbulojnë klasa të ndryshme të aseteve, siç janë kapitali privat, infrastruktura ose pasuritë e paluajtshme. Nëse një klasë e tillë e aseteve do të konsiderohet në të ardhmen, alokimi fillestar do të ishte i kufizuar mes 5% deri 10% e mjeteve nën menaxhim.

4. TËRHEQJA E KURSIMEVE PENSIONALE NË RASTET E SËMUNDJEVE TË RËNDA

Të definohet lejimi ose moslejimi i kontribuimit në rastet e tërheqjes së kursimeve në bazë të invaliditetit [lejuar me ligjin aktual].

Ka shumë kërkesa për tërheqje të parakohshme për shkak të sëmundjeve të kontribuesve, qoftë terminale apo të tjera andaj duhet të shqyrtohet dhe të përcaktohet nëse fushëveprimi i FKPK-së duhet të jetë vetëm fond pensional apo edhe invalidor e shëndetësor.

Këto janë disa prej ndryshimeve që kërkojnë vëmendje të shpejtë, ndërsa, ka edhe ndryshime të tjera të vogla që do ta përmirësonin mbarëvajtjen dhe funksionimin më të mirë të FKPK-së. Ekipi i FKPK-së është i gatshëm të jap kontributin e tij, në rast të formimit të grupit punues për ndryshimet ligjore.

ANEKS

7

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS OPERACIONET

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË OPERACIONEVE	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-26

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton L.L.C.
Rexhep Mala 18
10000 Prishtine
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802

Për Bordin e Drejtorëve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës - Operacionet ("FKPK") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në pasuritë neto të FKPK - Operacione dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që ka përfunduar më këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës- Operacionet më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona në kuadër të këtyre standardeve janë të përshkruara më poshtë në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare në këtë raport. Ne jemi të pavaruar nga FKPK në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe gjithashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEK-së. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e FKPK, për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likujdohë FKPK-në, ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të FKPK-së.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtrimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i moszbulimit të gabimeve materiale nga mashtrimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se risku i mashtrimit mund të përmbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të FKPK.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijmësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në dëshmitë e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që FKPK mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në dëshmitë tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që FKPK të ndërprejë operimin e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës - Operationet për, përpos të tjerave për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësi të rëndësishme eventuale në kontrollat e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Grant Thornton LLC

Prishtinë,
10 prill 2020



Suzana Stavriqi
Auditor ligjor



	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
		EUR	EUR
Mjetet			
<i>Mjetet qarkulluese</i>			
Paraja në dorë dhe në bankë	4	143,678	688,467
Afatizimet bankare	5	5,268,026	4,602,762
Llogaritë e arkëtueshme	6	614,998	483,036
Shpenzimet e parapaguara		21,556	13,173
		6,048,258	5,787,438
<i>Mjetet joqarkulluese</i>			
Pronat, impiantet dhe pajisjet	7	702,473	636,264
Pasuritë me të drejta të përdorimit	8	139,376	-
Mjetet e patrupëzuara	9	54,900	61,497
		896,749	697,761
Gjithsej mjetet		6,945,007	6,485,199
Detyrimet			
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	10	984,586	868,207
Detyrimet e qirasë	8	46,256	-
		1,030,842	868,207
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Detyrimet e qirasë	8	101,765	-
		101,765	-
Mjetet neto të FKPK-së - Operacionet		5,812,400	5,616,992

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK dhe nënshkruar në emrin e tyre më 31 mars 2020.


Z. Ruzhdi Morina
Kryesues i Bordit Drejtues




Z. Adrian Zalli
Drejtor Menaxhues


Z. Vërshim Hatipi
Zëvendës drejtor - Financa | Investime dhe Risk | TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Të hyrat			
Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	12	8,235,843	7,660,347
Të hyrat nga mjetet e tjera	13	174,030	97,667
Gjithsej të hyrat		8,409,873	7,758,014
Shpenzimet			
<i>Shpenzimet e investimeve</i>			
Tarifat neto të instrumenteve për investime të hapura	14	(4,558,953)	(5,704,406)
Tarifat e BQK-së për transfere dhe mirëmbajtje		(91,952)	(30,550)
Brokerët, kujdestarët dhe shpenzimet për garanci		(51,652)	(8,916)
		(4,702,557)	(5,743,872)
<i>Shpenzimet Administrative</i>			
Kostoja e stafit	15	(584,453)	(574,375)
Shpenzimet për Bordin Drejtues	16	(193,275)	(207,862)
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondenca		(138,368)	(107,951)
Mirëmbajtja e softuerit		(87,368)	(38,289)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7-9	(92,696)	(53,584)
Shpenzimet për operim të zyrës		(22,595)	(82,801)
Tarifa e BQK-së për mbikëqyrje		(19,413)	(18,188)
Trajnimet, udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit		(16,057)	(10,050)
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	17	(11,259)	(10,380)
Shpenzimet e interesit të qirasë	8	(10,540)	-
Auditimi i jashtëm		(9,050)	(9,050)
Komunikimi		(7,263)	(8,298)
Rimëkëmbja nga fatkeqësitë - qiratë dhe shpenzimetë ndërlidhura		(6,600)	(6,600)
Tarifat e shërbimeve bankare		(1,744)	(2,300)
Edukimi publik dhe shpalljet		(1,060)	(15,136)
Shpenzimet e tjera		(4,187)	(13,881)
		(1,205,928)	(1,158,745)
Gjithsej shpenzimet		(5,908,485)	(6,902,617)
Provizionet për humbjet e pritura kreditore, neto (rritja) / zvogëlimi		(333)	252
Suficiti neto për vitin		2,501,055	855,649

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Suficiti	Rezervat	Gjithsej
		EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2018		461,343	5,000,000	5,461,343
Suficiti neto për vitin		855,649	-	855,649
Kthimi prej suficitit tek FKPK-MP	11	(700,000)	-	(700,000)
Më 31 dhjetor 2018		616,992	5,000,000	5,616,992
Ndryshimi nga implementimi fillestar i SNRF 16	2.3	(5,647)	-	(5,647)
Ri-paraqitur më 1 janar 2019		611,345	5,000,000	5,611,345
Suficiti neto për vitin		2,501,055	-	2,501,055
Kthimi prej suficitit tek FKPK-MP	11	(2,300,000)	-	(2,300,000)
Më 31 dhjetor 2019		812,400	5,000,000	5,812,400

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale			
Suficiti neto për vitin		2,501,055	855,649
Rregullimet për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	7-9	92,696	53,584
Të hyrat nga interesi	13	(121,765)	(82,072)
Lëvizjet neto në provizionet për humjet e pritura kreditore	5	333	(252)
		2,472,319	826,909
Interesi i arkëtuar		115,867	86,253
		2,588,186	913,162
Ndryshimet në mjetet dhe detyrimet operacionale:			
(Rritja) në detyrimet e qirasë – skontimi neto		(43,460)	-
Rritja / (Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme/akruale		116,379	(189,457)
Zvogëlimi / (Rritja) në llogaritë e arkëtueshme/parapagimet (përfshijë interesin e arkëtueshëm nga llogaritë rrjedhëse)	4	(140,544)	21,520
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale		2,520,561	745,225
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës, impjanteve dhe pajisjeve	7	(94,480)	(606,986)
Blerja e softuerëve dhe licencave	9	(11,370)	(38,978)
(Rritja) në afatizimet bankare		(5,259,500)	(4,600,000)
Zvogëlimi në afatizimet bankare		4,600,000	5,100,000
Rrjedhja neto e parasë (përdorur në) / nga aktivitetet investuese		(765,350)	(145,964)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Kthimi i suficitit në FKPK-MP		(2,300,000)	(700,000)
Rrjedhja neto e parasë (përdorur në) aktivitetet financuese		(2,300,000)	(700,000)
(Zvogëlimi) në paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj			
		(544,789)	(100,739)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		688,467	789,206
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	143,678	688,467

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplementuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168 dhe Nr. 05/L-116; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK, në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga anëtarët ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 04/L-101, një anëtar pa të drejtë vote do t'i përfaqësojë interesat e Qeverisë. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, Bordi Drejtues ka vepruar pa këtë anëtar që e përfaqëson Qeverinë.

Këto pasqyra financiare janë për FKPK-Operacionet (ose "FKPK-0") i cili është subjekti i menaxhimit dhe administrimit të kursimeve pensionale të kontribuuesve (mjeteve pensionale). Pasqyrat financiare për FKPK-Mjetet Pensionale (ose "FKPK-MP"), janë përgatitur ndaras nga pasqyrat financiare të subjektit.

Drejtori dhe 28 punonjës të përhershëm i menaxhuan operacionet ditore të FKPK-së gjatë vitit 2019 (2018: Drejtori dhe 26 punonjës të përhershëm).

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të FKPK-O janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-O i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare sipas konventës së kostos historike siç ndryshohen me rivlerësimin e aseteve dhe detyrimeve financiare. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në EUR, e cila është valuta funksionale dhe raportuese e FKPK-O. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshatjes me prezantimin e vitit aktual.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

i) Aplikimi fillestar i standardit të ri si dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën aktuale të raportimit

Standardi i ri si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, ishin në fuqi për periudhën aktuale:

- **IFRS 16 "Qiratë"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019;
- Ndryshimet në standarde të ndryshme: Pasoja tatimore të pagesave në instrumentet e klasifikuara si ekuitet (ndryshimet në SNK 12); Plani i ndryshimit, zhdukja ose zgjidhja (Ndryshimet në SNK 19), Kostot e huazimit të pranueshme për kapitalizim (Ndryshimet në SNK 23); Interesat afatgjatë në asocime dhe ndërmarrësi të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28); Interesat e mbajtura më parë në operacione të përbashkëta (Ndryshimet në SNRF 3 dhe SNRF 11); Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9) - të gjitha në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019;
- KIRFN 23 "Pasiguritë mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat" – në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

Implementimi i standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve të mësipërme nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-O, me përjashtim të SNRF 16 detajet e të cilit janë dhënë në vijim.

Implementimi i SNRF 16 "Qiratë"

Implementimi i këtij standardi të ri ka rezultuar që KPST-O të njohë një pasuri me të drejta të përdorimit dhe detyrimet e qirasë të ndërlidhura me të, ku të gjitha qiramarrjet e mëparshme operative përveç atyre të identifikuara me vlerë të ulët ose me afat më të shkurtër se 12 muaj nga data e aplikimit fillestar.

Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, me efektin kumulativ të miratimit të SNRF 16 të njohur në pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto të FKPK-O, si një korigjim në bilancin fillestar të suficitit për periudhën aktuale. Periudhat e mëparshme nuk janë ri-paraqitur.

KPST-O ka zgjedhur të mos i përfshijë kostot fillestare direkte në matjen e pasurisë me të drejta të përdorimit për qiratë operative në ekzistencë në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, apo 1 janarin 2019. Në këtë datë, FKPK-O gjithashtu ka të zgjedhur për ta matur pasurinë me të drejta të përdorimit me një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar për pagesat e parapaguara ose të akorduara të qirasë që kanë ekzistuar deri në datën e tranzicionit.

Në tranzicion, për qiramarrjet e llogaritura më parë si qira operative me një afat të qirasë më të vogël se 12 muaj dhe për ato me vlerë të ulët, KPST-O ka aplikuar përjashtimet opsionale për të mos i njohur si pasuri me të drejta të përdorimit, por për t'i llogaritur si shpenzime të qirasë sipas metodës drejtvizore për afatin e mbetur të qirasë.

Në kalimin në SNRF 16, niveli i huamarrjes së përshkallëzuar i aplikuar mbi detyrimet e qirasë të njohur sipas SNRF 16 ishte 6.49%.

KPST-O ka përfitur nga përdorimi i shikimit prapa për përcaktimin e afatit të qirasë gjatë trajtimit të opsioneve për zgjatje apo ndërprerje të qirasë.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (vazhdim)

Në vijim paraqitet harmonizimi i ndikimit në suficit në pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto të FKPK-0 me rastin e implementimit të SNRF 16 më 1 janar 2019:

	Më 1 janar 2019
	EUR
Njohja fillestare e pasurive me të drejta të përdorimit	185,834
(Njohja fillestare e) pasurive në detyrimet e qirasë	(191,481)
Ndryshimi nga implementimi fillestar i SNRF 16	(5,647)

ii) Standardet e reja si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara që ende nuk janë përvetësuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, janë publikuar por ende nuk kanë hyrë në fuqi:

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i asetëve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar);
- **Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)** – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020;
- **Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo-rrjedhëse (Ndryshimet në SNK 1)** – në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

FKPK-0 ka zgjedhur të mos përvetësojë këto standarde, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime përpara se ato të hyjnë në fuqi. FKPK-0 parashikon që përvetësimi i këtyre standardeve dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-0 në periudhën e zbatimit fillestar.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Instrumentet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si asete, detyrime ose ekuitet në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra apo shpenzime. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-O ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë, qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një aset dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare

Metodat e matjes

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Kostoja e amortizuar dhe norma efektive e interesit

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën aseti ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryegjësë, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj vlere fillestare dhe shumës së maturimit dhe, për asetet financiare, përshtatjet për çdo provizion të dëmtimit.

Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrët flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nëpërmjet jetës së pritur të asetit ose detyrimit financiar në vlerën bartëse bruto të një aseti financiar (koston e amortizuar para çfarëdo provizioni për dëmtim) ose koston e amortizuar të një detyrimi financiar. Llogaritja nuk merr parasysh humbjet e pritura të kreditit dhe përfshin kostot e transaksionit, primet ose zbritjet dhe tarifën e pikat e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, siç janë tarifën e origjinës.

Kur FKPK-O rishikon vlerësimet për flukset monetare të ardhshme, vlera bartëse e aseteve ose detyrimeve financiare përkatëse është e rregulluar për të pasqyruar vlerësimin e ri të skontuar duke përdorur normën efektive të interesit fillestare. Çdo ndryshim njihet në fitim ose humbje.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën bruto të bartur të aseteve financiare, përveç:

- Pasuritë financiare të blera ose të buruara nga provizionet (BBNP);
- Pasuritë financiare që nuk ishin BBNP, por më pas u bënë me kredit të dëmtuar ("Faza 3"), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (dmth. pas provizionimit ECL).

Njohja fillestare dhe matja

Asetet dhe detyrimet financiare njihen kur FKPK-O bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit, datën kur FKPK-O zotohet për blerjen ose shitjen e asetit.

Në njohjen fillestare, FKPK-O mat një aset ose detyrim financiar me vlerën e saj të drejtë plus ose minus, në rastin e një aseti ose detyrimi financiar që nuk matet me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që janë në rritje dhe që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të asetit ose detyrimit financiar, siç janë tarifën dhe komisionet.

Kostot e transaksionit të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes pasqyrohen si shpenzime në fitim dhe humbje. Menjëherë pas njohjes fillestare, një provizion i humbjes së pritshme kreditore (HPK) njihet për asetet financiare të matura me koston e amortizuar dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj), gjë që rezulton në një humbje kontabël që njihet në fitim dhe humbje për një aset të sapo njohur.

Kur vlera e drejtë e aseteve dhe detyrimeve financiare ndryshon nga çmimi i transaksionit me njohjen fillestare, FKPK-O njihet diferenca si në vijim:

- Kur vlera e drejtë dëshmohet me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik (dmth. një input i Nivelit 1) ose bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, diferenca njihet si fitim ose humbje;
- Në të gjitha rastet e tjera, diferenca shtyhet dhe afati i njohjes së fitimit ose humbjes së ditës së shtyrë përcaktohet individualisht. Ai amortizohet përgjatë jetës së instrumentit, shtyhet derisa vlera e drejtë e instrumentit të mund të përcaktohet duke përdorur të dhëna të vëzhgueshme nga tregu, ose kur ajo realizohet nëpërmjet shlyerjes.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.1. Asetet financiare

i) Klasifikimi dhe matja pasuese

FKPK-O klasifikon asetet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme matëse:

- *Kostoja e amortizuar*: Pasuritë që mbahen për arkëtim të flukseve monetare kontraktuale ku ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (VPKI) dhe që nuk janë klasifikuar në VDFH, maten me koston e amortizuar. Vlera e bartur e këtyre asetëve korrigjohet për çfarëdo provizionimi të njohur dhe të matur për humbjet e pritura kreditore. Të ardhurat e interesit nga këto asete financiare përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit;
- *Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse [VDATGj]*: Asetet financiare që mbahen për arkëtim të flukseve monetare kontraktuale si dhe për shitjen e atyre asetëve, ku flukset monetare të asetëve përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe të interesit dhe që nuk janë klasifikuar në VDFH, maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Lëvizjet në vlerën e bartur merren përmes ATGj, përveç njohjes së fitimeve ose humbjeve nga provizionimi, të ardhurat nga interesi dhe fitimet ose humbjet në këmbim valutor të instrumenteve që njihen në fitim dhe humbje. Kur aseti financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGj riklasifikohet nga ekuiteti në fitim dhe humbje dhe njihet në 'Të ardhurat neto nga investimet'. Të ardhurat nga interesi i këtyre asetëve përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit;
- *Vlera e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (VDFH)*: Asetet që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose VDATGj maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Një fitim ose humbje në një investim borxhi që më pas matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe nuk është pjesë e një plasmani mbrojtës, njihet në fitim ose humbje dhe paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes tek 'Të ardhurat neto të tregtimit' në periudhën në të cilën shfaqet, përveç nëse buron nga instrumente borxhi të klasifikuara me vlerë të drejtë ose që nuk mbahen për tregtim, në të cilin rast ato paraqiten ndaras tek 'Të ardhurat neto nga investimet'. Të ardhurat nga këto asete financiare përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Instrumentet e borxhit

Instrumentet e borxhit janë ato instrumente që përmbushin përkufizimin e një detyrimi financiar nga perspektiva e emetuesit, të tilla si huatë, obligacionet e qeverisë dhe të korporatave dhe të arkëtueshmet tregtare të blera nga klientët në marrëveshjet e faktoring-ut pa rekurs.

Klasifikimi dhe matja pasuese e instrumenteve të borxhit varen nga:

- modelin e biznesit të FKPK-O për menaxhimin e asetit; dhe
- karakteristikat e rrjedhës së parasë të aktivitetit.

Në bazë të këtyre faktorëve, FKPK-O klasifikon instrumentet e borxhit në njërin nga kategoritë e matjes: (a) Kostoja e amortizuar; (b) VDATGj; ose (c) VDFH. FKPK-O ka klasifikuar instrumentet e saj të borxhit të përbërë nga investime në bonot dhe obligacionet e Thesarit të Kosovës, si dhe investimet në afatizimet bankare të vendosura me bankat tregtare në Kosovë, të matura me koston e amortizuar. FKPK-O nuk ka instrumente borxhi të klasifikuara si VDATGj ose VDFH.

Modeli i biznesit: modeli i biznesit pasqyron se si FKPK-O menaxhon asetet në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare, dhe instrumentet klasifikohen në një nga tri kategoritë e matjeve të përmendura më lart. Si e tillë, investimet në afatizimet bankare si dhe ato në bonot dhe obligacionet e Thesarit të Kosovës klasifikohen me koston e amortizuar.

VPKI: ku modeli i biznesit është t'i mbajë asetet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe të shesë, FKPK-O vlerëson nëse flukset monetare të instrumentit financiar përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (Testi VPKI). Gjatë vlerësimit, FKPK-O shqyrton nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, dmth interesi përfshin vetëm konsideratën për vlerën kohore të parasë, rrezikun e kredisë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit që është në përputhje me marrëveshjen bazë të huadhënies. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk përputhet me një marrëveshje bazë të huadhënies, instrumenti financiar përkatës klasifikohet dhe matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

FKPK-O riklasifikon investimet në instrumente borxhi kur dhe vetëm kur ndryshon modeli i tij i biznesit për menaxhimin e këtyre asetëve. Riklasifikimi bëhet nga fillimi i periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit. Këto ndryshime pritet të jenë shumë të rralla dhe asnjë nuk ka ndodhur gjatë periudhës.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.1. Asetet financiare (vazhdim)

i) Klasifikimi dhe matja pasuese (vazhdim)

Instrumentet e aksionit dhe fondet e hapura investuese

Instrumentet e aksionit janë instrumente që plotësojnë përkufizimin e kapitalit nga perspektiva e emetuesit; që është, instrumente që nuk përmbajnë një detyrim kontraktual për të paguar dhe që reflektojnë një interes të mbetur në asetet neto të emetuesit. Shembuj të instrumenteve të aksionit përfshijnë aksionet e zakonshme me të cilat FKPK-O nuk posedon, por edhe aksionet në fonde të hapura investive të cilat FKPK-O i mban.

FKPK-O më pas mat të gjitha investimet e tilla me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, përveç rasteve kur menaxhmenti i FKPK-O, në njohjen fillestare, pakthyeshem e përcakton një investim në aksione me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur këto investime nuk mbahen vetëm për qëllime të gjenerimit të kthimit nga investimet. Në raste të tilla, çfarë nuk ka pasur asnjë gjatë periudhës raportuese, fitimet ose humbjet në vlerën e drejtë njihen në HTGj dhe nuk rriklasifikohen më pas në fitim ose humbje, as kur ato heqen. Humbjet nga dëmtimet (zhvlerësimet), dhe anulimet e humbjeve nga dëmtimet, nuk raportohen ndaras nga ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë. Dividendët, kur paraqesin kthim nga këto investimeve, vazhdojnë të njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera kur përmbushet e drejta e FKPK-O për t'i pranuar ato pagesa.

FKPK-O ka klasifikuar investimet e saj në fondet e hapura si të matura në VDFH dhe nuk ka investime të kapitalit të klasifikuar si VDHTGj.

Fitimet ose humbjet nga investimet në fondet e hapura të matura në FVPL dhe janë përfshirë si të hyra ose shpenzime në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

ii) Dëmtimi

FKPK-O mbi bazën e parashikimit vlerëson humbjet e pritshme kreditore (HPK) të lidhura me asetet e instrumenteve të borxhit të bartura me kosto të amortizuar. FKPK-O në çdo datë raportimi njih një provizion humbjesh për humbjet e tilla. Matja e HPK pasqyron:

- Një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme;
- Vlerën kohore të parasë; dhe
- Informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të tepërta në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

iii) Ç'regjistrimi jo përmes modifikimit

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga aseti kanë skaduar, ose kur ato janë transferuar dhe ose (a) FKPK-O transferon substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, ose (b) FKPK-O as nuk transferon e as nuk mban substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe FKPK-O nuk ka mbajtur kontroll. Nuk pati raste të tilla gjatë periudhës raportuese.

3.2.2. Detyrimet financiare

i) Klasifikimi dhe matja pasuese

Në periudhën aktuale dhe paraprake të raportimit, detyrimet financiare klasifikohen dhe më pas maten me koston e amortizuar.

ii) Çregjistrimi

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.3. Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i rëndit asetet dhe detyrimet financiare në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për asete dhe detyrime identike;
- Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, mënjanë nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e aseteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe
- Niveli 3: shënimet hyrëse për asetet e detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Në datën e raportimit, nuk kishte instrumente financiare të FKPK-O të matura sipas vlerës së drejtë.

3.3 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre ose më pak muajsh.

3.4 Prona, impiantet dhe pajisjet dhe qiramarrjet

3.4.1 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet e operacioneve të FKPK-O përbëhen nga: Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme; mobilie, instalime dhe pajisje të ngjashme; pajisje të tjera të zyrës; dhe automjete; të cilët barten si kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimet nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin çmimin e blerjes dhe të gjitha kostot që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje operative për përdorimin e tij të synuar. Mirëmbajtja dhe riparimet, zëvendësimet dhe përmirësimet e rëndësishme të vogël janë njohur kur kanë ndodhur. Përmirësimet të konsiderueshme dhe zëvendësimi i pasurive kapitalizohen.

Ndërtimet në vijim raportohen me koston e ndërtimit përfshirë kostot e ngarkuara nga palët e treta. Pas përfundimit, të gjitha kostot e akumuluar të pasurive transferohen në kategorinë përkatëse të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe më pas i nënshtrohen normave të aplikueshme të zhvlerësimit.

Toka dhe ndërtimet në vijim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi ngarkohet në bazë të metodës drejtvizore përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të mjeteve, duke i përdorur normat si në vijim:

Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme	33%
Mobiliet, instalimet dhe pajisjet	20%
Pajisjet e tjera të zyrës	20%
Veturat	20%

Fitimet dhe humbjet nga shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën në të cilën ato kanë ndodhur. Jeta e dobishme e pronës, impianteve dhe pajisjeve - nëse është e nevojshme - shqyrtohet dhe përshtatet së paku në baza vjetore.

3.4.2 Qiramarrjet

Për çdo kontratë të re të lidhur me ose pas 1 janarit 2019, FKPK-O konsideron nëse është një kontratë, ose përmban një qira. Një qira përcaktohet si "një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një pasuri (pasurinë themelore) për një periudhë kohe në këmbim të një shume". Për të zbatuar këtë përkufizim, FKPK-O vlerëson nëse kontrata përmbush tri vlerësime kryesore, të cilat janë:

- kontrata përmban një pasuri të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë implicite duke u identifikuar në kohën kur pasuria është vënë në dispozicion të FKPK-O;
- FKPK-O ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i pasurisë së identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij të përcaktuara në fushëveprimin e kontratës
- FKPK-O ka të drejtë të drejtojë përdorimin e pasurisë së identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

FKPK-O vlerëson nëse ka të drejtë të drejtojë 'si dhe për çfarë qëllimi' pasuria përdoret gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Prona, impiantet dhe pajisjet dhe qiramarrjet (vazhdim)

Matja dhe njohja e qirave

Në datën e fillimit të qirasë, FKPK-O njuh një pasuri me të drejta të përdorimit dhe një detyrim të qirasë në bilancin e gjendjes. Pasuritë me të drejta të përdorimit maten me kosto, e cila përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga FKPK-O, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe heqjen e pasurisë në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë e bërë para datës së fillimit të qirasë (duke minusuar çdo incentivë të pranuar).

FKPK-O zhvlerëson pasuritë me të drejta të përdorimit sipas metodës drejtvizore nga data e fillimit të qirasë e deri te më e hershmitja: përfundimi i jetës së dobishme të pasurisë me të drejta të përdorimit ose i afatit të qirasë. FKPK-O vlerëson gjithashtu pasurinë me të drejta të përdorimit për dëmtime kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, FKPK-O mat detyrimin e qirasë në vlerën e tanishme të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të skontuar duke përdorur normën e interest, të nënkuptuar në qira nëse ajo normë është e disponueshme lehtësisht, ose norma e huamarrjes së përshkallëzuar të FKPK-O. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë ato substancialisht fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shumat që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet që arsyeshëm pritet të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet për pagesat e bëra dhe do të rritet për kamatë. Ajo rivlerësohet për të pasqyruar çdo rivlerësim ose modifikim, ose nëse ka ndryshime në pagesat substancialisht fikse. Kur detyrimi i qirasë rivlerësohet, rregullimi përkatës pasqyrohet në pasurinë me të drejta të përdorimit, ose në fitim dhe humbje nëse pasuria me të drejta të përdorimit tashmë ka rënë në zero.

FKPK-O ka zgjedhur t'i llogarisë qira afatshkurtra dhe ato me vlerë të ulët duke përdorur qasje praktike. Në vend që të njihet një pasuri me të drejta të përdorimit dhe detyrimi i qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si shpenzime në fitim ose humbje sipas metodës drejtvizore gjatë afatit të qirasë. Të dyja, pasuritë me të drejta të përdorimit dhe detyrimet e qirasë, janë paraqitur si bilance të veçanta në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.5 Mjetet e patrupëzuara

Mjetet e patrupëzuara përbëhen nga softuerët e licencuar kompjuterik. Këto fillimisht paraqiten sipas koston dhe më pas sipas koston së tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga prishjet, nëse ka të tilla.

Amortizimi regjistrohet kur këto mjete janë të disponueshme për përdorim sipas metodës drejtvizore ku kostoja e mjetit të patrupëzuar shlyhet përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit, duke i përdorur normat si në vijim:

Softuerët - 20%

Licencat amortizohen sipas kohëzgjatjes së licencës deri në maksimum 5 vjet.

3.6 Dëmtimi i aseteve jo-financiare

Vlera bartëse e aseteve jo-financiare rishikohet për dëmtime kur ngjarjet ndryshojnë ose në rast se ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera bartëse nuk është e rikuperueshme. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla, dhe aty ku vlera bartëse e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar, mjetet regjistrohen në shumën e tyre të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e pajisjeve të tilla është më e madhja në mes të çmimit neto të shitjes dhe vlerës përdoruese.

Në vlerësimin e vlerës përdoruese, rrjedhat e ardhshme të parashikuara të parasë zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para-tatimore, e cila e reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqeve përkatëse për mjetet.

Humbjet nga dëmtimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.7 Tatimi

FKPK-ja si fond i mirëbesimit është i liruar nga tatimi në fitim i korporatave.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Kostoja e pensionit

FKPK-0 nuk mban provizione e as nuk ka kurrfarë obligimi ndaj pensioneve të të punësuarve, përtej kontributeve të paguara në skemën e lartpërmendur të pensioneve.

3.9 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Menaxhmenti gjithashtu duhet të ushtrojë gjykim në zbatimin e politikave kontabël të FKPK-0. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme.

Ky shënim shpallorë fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimet dhe kompleksitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit që kanë një rrezik të theksueshëm për të rezultuar në përshtatje materiale gjatë vitit të ardhshëm financiar. Informata të hollësishme për secilën nga këto vlerësime dhe gjykime përfshihen në shënimet përkatëse së bashku me informacionin në lidhje me bazën e llogaritjes për çdo element të linjës së prekur në pasqyrat financiare.

Jeta e dobishme e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit

Menaxhmenti e ka rishikuar jetëgjatësinë e pasurive të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit më 31 dhjetor 2019. Menaxhmenti ka vlerësuar se jetëgjatësia e pasurive përfaqëson dobishmërinë e pritshme të tyre. Vlerat bartëse të pasurive të tilla janë analizuar në Shënimet 7 dhe 9. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërsimit teknologjik.

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore për asetet financiare të matura me koston e amortizuar është një sferë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të theksueshme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë (p.sh. gjasat e mospagesës së Thesarit të Kosovë dhe humbjet që rezultojnë). Shpjegimi i këtyre inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit të përdorura në matjen e HPK është detajuar më tej në Shënimin 3.11.3, i cili gjithashtu përcakton ndjeshmëritë kyçe të HPK ndaj ndryshimeve në këto elemente.

Disa gjykime të rëndësishme gjithashtu janë të nevojshme për zbatimin e kërkesave të kontabilitetit për matjen e ECL, si:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë;
- Zgjidhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e HPK;
- Vendosja e numrit të peshave relative të skenarëve parashikues për çdo lloj produkti / tregu dhe HPK-në përkatëse; dhe
- Krijimi i grupeve të aseteve të ngjashme financiare për qëllime të matjes së HPK.

3.10 Rezerva

Rezerva operacionale është pjesë e mjeteve neto që iu takojnë FKPK-0, ato kanë një nivel maksimal prej 5,000,000 EUR dhe fondet mund të përdoren vetëm me vendimin e Bordit Drejtues në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme, rrethanave të paparashikueshme, ose për blerjen e pasurive të paluajtshme për qëllime të operacioneve të FKPK-së (siç janë zyrat). Rezerva fillimisht është financuar në vitin 2013 nga suficiti i akumuluar dhe mund të rimbushet vetëm nga suficiti nga aktivitetet operacionale me vendim të Bordit Drejtues. Kur fondet nga rezerva përdoren për t'i mbuluar kostot e periudhës raportuese ato do të njihen në fitim apo humbje për periudhën.

3.11 Menaxhimi i riskut financiar

3.11.1 Risku i tregjeve

Risku i tregjeve vjen nga ndryshimet në çmimet e tregjeve, për shembull normat e këmbimit valutor dhe normat e interesit do të ndikojnë të hyrat e FKPK-0 ose vlerën e instrumenteve financiare në posedim të tij. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregjeve është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregjeve përbrenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimet.

Risku i këmbimit valutor

Mjetet dhe detyrimet e FKPK-0 nuk janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve në normat e këmbimit valutor meqë të gjitha transaksionet dhe bilancet janë në valutën vendore.

Risku i normave të interesit

Risku i normave të interesit vjen nga vlera reale ose vlera e rryedhave të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Menaxhmenti i FKPK-0 kryesisht është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit neto të riskut të normave të interesit, dhe vendos kufijtë për të reduktuar potencialin e mospërputhjes së normave të interesit. Në datat e raportimit të gjitha asetet e FKPK-0 që bartnin interes (afatizimet bankare) kishin kamatë fikse të interesit.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.11.2 Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, qasjen në fonde përmes mekanizmave adekuatë për kredi, si dhe aftësisë për të arkëtuar në kohë - sipas kushteve të paracaktuara - shumat e pritshme nga palët e treta.

Tabela në vijim paraqet maturimet e mbetura kontraktuale të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPK-O. Tabela është përpiluar në bazë të rrjedhjes së pazbritur të parasë.

	Më 31 dhjetor 2019			Më 31 dhjetor 2018		
	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare						
Paraja në dorë dhe në bankë	143,678	-	-	688,467	-	-
Afatizimet bankare	-	-	5,268,026	-	-	4,602,762
Llogaritë e arkëtueshme	614,998	-	-	483,036	-	-
	758,676	-	5,268,026	1,171,503	-	4,602,762
Detyrimet financiare						
Llogaritë e pagueshme	984,586	-	-	868,207	-	-
	984,586	-	-	868,207	-	-
Hendeku i maturimit	(225,910)	-	5,268,026	303,296	-	4,602,762

3.11.3. Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato asete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

	Më 31 dhjetor 2019		Më 31 dhjetor 2018	
	Vlera bartëse	Vlera reale	Vlera bartëse	Vlera reale
	EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare				
Paraja në bankë	143,678	143,678	688,467	688,467
Afatizimet bankare	5,268,026	5,270,661	4,602,762	4,605,065
Llogaritë e arkëtueshme	614,998	614,998	483,036	483,036
	6,026,702	6,029,337	5,774,265	5,776,568
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme	984,586	984,586	868,207	868,207
	984,586	984,586	868,207	868,207

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.11.4 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-O nëse një klient ose palë tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale. Risku kreditor kryesisht buron direkt nga investimet në afatizimet bankare, dhe përfaqëson riskun më të lartë për mjetet e FKPK-O.

Matja e riskut kreditor

Vlerësimi i ekspozimit kreditor për qëllime të administrimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve, pasi ekspozimi ndryshon me ndryshimet në kushtet e tregut, përveç flukseve monetare dhe kalimin e kohës. Vlerësimi i riskut kreditor nënkupton vlerësim të mëtejshëm në lidhje me gjasat që të ndodhin mospagesat.

FKPK-O mat riskun kreditor duke përdorur Probabilitetin e Mospagesës (PM), Ekspozimin në Mospagesë (ENM) dhe Humbjen marrë Parasysh Mospagesën (HPM). Kjo është metoda e përdorur me qëllim të matjes së Humbjes së Pritshme Kreditore (HPK) sipas SNRF 9.

Ekspozimet e kredive janë kategorizuar në një nga tre fazat, varësisht nga rritja e rrezikut kreditor që nga njohja fillestare e instrumenteve përkatëse të bartura me koston e amortizuar, përkatësisht: depozitat me afat me bankat komerciale.

Kur ka një rritje të ndjeshme në riskun kreditor, një instrument zhvendoset nga humbja e pritur 12-mujore në humbje të pritur përgjatë jetës.

Gjatë vlerësimit, risku fillestar kreditor i një instrumenti financiar matet kundrejt riskut të tanishëm kreditor, duke marrë parasysh jetën e mbetur të instrumentit.

Në fazat një dhe dy, të ardhurat nga interesi janë interesi efektiv mbi vlerën e bartur bruto; në fazën e tretë është interesi efektiv në koston e amortizuar.

Për të llogaritur humbjet e pritshme 12-mujore dhe përgjatë jetës, për instrumente përkatëse aplikohet model për risk kreditor (PM, HPM), parashikimet e bilancit (parapagimet, tërheqjet e objektit) dhe normat e interesit (faktorët e zbritjes).

Nga ana e riskut kreditor, modelet PM dhe HPM duhet të plotësojnë modelin e dëmtimit (zhvlerësimit).

Modeli i PM vlerëson probabilitetin e mospagesës (PM) në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Konsiderohen të gjitha informatat relevante;
- Rrethanat e tanishme ekonomike reflektohen duke përdorur vlerësimin "më të mirë" më shumë se atë "konservator";
- Siguron gjasat e ndodhjes së parazgjedhur brenda 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së instrumentit;
- Përfshin parashikimet ekonomike të ardhshme.

Modeli HPM vlerëson përqindjen e humbjes në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Konsideron të gjithë informacionin e duhur dhe përfshin elemente të parashikimit;
- Reflekton rrethanat aktuale ekonomike (dmth., përdor vlerësimin më të mirë dhe jo vlerëimin e rënies ekonomike);
- Konsideron vetëm shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt mbledhjes së arkëtiveve.

Modeli i dëmtimit për depozitat me afat

Modeli i dëmtimit për depozitat me afat me bankat lokale merr parasysh historikun e mospagesës nga bankat përkatëse (çfarë nuk ka pasur), koeficientët bazikë financiarë dhe matje tjera, si dhe jetën e mbetur të instrumentit. Secilit skenar i jepet një probabilitet përkatës, i cili më pas përdoret për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore.

Nëse një instrument zhvendoset nga faza e parë në fazat dy ose tre varet nga dëshmitë objektive të dëmtimit ose matësat bazë siç janë:

- vonesa ose delikuenca në pagesat e interesit ose të kryegjësë të depozitave; ose
- po bëhet e mundur që banka të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar; ose
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës incion revokimin e licencës së bankës; ose
- Koeficienti i tashëm bie nën 0.9; ose
- Raporti kredi / depozit tejkalon 1.1 ose bie nën 0.4; ose
- Koeficienti i mjaftueshmërisë së kapitalit bie nën 8.5%; ose
- Përqindja e kredive të këqija tejkalon 13%.

Duke pasur parasysh inputet e mësipërme, të gjitha depozitat me afat janë vlerësuar duke përdorur modelin e dëmtimit të fazës 1, atë 12-mujor, dhe nuk pati lëvizje në faza gjatë viteve që përfundojnë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018. Rritja neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore gjatë vitit ishte 333 EUR, duke bërë që bilanci përfundimtar më 31 dhjetor 2019 të jetë 2,636 EUR (2018: ulja neto prej 252 EUR dhe bilanc përfundimtar prej 2,303 EUR).

4 PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
ProCredit Bank - Llogari rrjedhëse	115,813	58,733
Banka për Biznes – Llogari rrjedhëse	19,047	544,426
Raiffeisen Bank Kosovo – Llogari rrjedhëse	6,841	84,662
NLB Prishtina - Llogari rrjedhëse	531	244
Banka Ekonomike – Llogari rrjedhëse	386	92
ISh Bankasi – Llogari rrjedhëse	324	44
TEB Bank – Llogari rrjedhëse	300	-
Banka Kombëtare Tregtare - Dega Prishtinë – Llogari rrjedhëse	272	187
Paraja në dorë	164	79
Gjithsej paraja në dorë dhe në bankë	143,678	688,467

Llogaritë rrjedhëse të FKPK-0 nuk ofrojnë interes, me përjashtim të llogarisë me Bankën për Biznes e cila me fillim nga 1 gushti 2018 ofron kamatë progressive bazuar në bilancin ditor në llogari. Interesi i fituar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 në këtë llogari ishte 6,357 EUR nga të cilat 228 EUR ishin të arkëtueshme në datën e raportimit (2018: 2,022 EUR nga të cilat 427 EUR ishin të arkëtueshme).

5 AFATIZIMET BANKARE

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Afatizimet bankare para provizioneve për humbjet e pritshme kreditore	5,270,662	4,605,065
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore	(2,636)	(2,303)
Afatizimet bankare pas provizioneve për humbjet e pritshme kreditore	5,268,026	4,602,762

Provizionet për humbjet e pritshme kreditore për instrumentet e borxhit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë nxjerrë në përputhje me modelin e humbjes së pritshme kreditore siç detajohet në politikat e rëndësishme kontabël. Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore ishin:

	2019	2018
	EUR	EUR
Më 1 janar	2,303	2,555
Shtesat e provizioneve për shkak të plasmaneve të reja	2,636	2,303
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit / çnjohjes	(2,303)	(2,555)
Lirimi i provizioneve për shkak të ndryshimit të riskut kreditor	-	-
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore	333	(252)
Më 31 dhjetor	2,636	2,303

5 AFATIZIMET BANKARE (VAZHDIM)

	2019	2018
	EUR	EUR
Më 1 janar	4,602,762	5,107,118
Plasmanet e reja	5,259,500	4,600,000
Interesi i fituar	115,408	80,050
Interesi i arkëtuar	(109,311)	(84,658)
Kryegjëja e maturuar	(4,600,000)	(5,100,000)
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritshme kreditore	(333)	252
Më 31 dhjetor	5,268,026	4,602,762

Më 31 dhjetor 2019 investimet e FKPK-O në depozitat me afat të matura me koston e amortizuar përbëheshin nga 5 depozita me afat original të maturimit 1 vjeçar, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 0.90 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 2.08%. Më 31 dhjetor 2018, investimet në depozitat me afat të matura me koston e amortizuar përbëheshin nga 3 depozita me afat original të maturimit 1 vjeçar, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare prej 0.96 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 2.38%.

6 LLOGARITË E ARKËTUESHME

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Të arkëtueshmet neto nga FKPK-MP	553,143	410,601
Rabatet e arkëtueshme nga fonde të hapura për investime	56,826	71,961
Të arkëtueshmet e tjera	5,029	474
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	614,998	483,036

Më 31 dhjetor 2019 vlera e të arkëtueshmeve nga FKPK-MP në shumë 553,143 EUR ka të bëjë me tarifën e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve në shumë 553,030 EUR, si dhe diferencën pozitive nga refundimet e kontributeve të gabuara në shumë 113 EUR (2018: përkatësisht 415,160 EUR dhe diferencën negative në vlerë 4,559 EUR); të cilat u arkëtuan pas datës së raportimit.

7 PRONAT, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme	Mobiliet instalimet dhe pajisjet	Pajisjet e tjera të zyrës	Veturat	Toka dhe ndërtimet në vijim	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR

Kostoja

Më 1 janar 2018	319,948	22,414	58,950	53,365	-	454,677
Shtesat gjatë vitit	14,344	1,489	-	-	591,153	606,986
Hudhjet gjatë vitit	(16,820)	(403)	(6,304)	-	-	(23,527)
Më 31 dhjetor 2018	317,472	23,500	52,646	53,365	591,153	1,038,136
Shtesat gjatë vitit	72,870	410	21,200	-	-	94,480
Hudhjet gjatë vitit	(16,519)	(783)	(6,314)	-	-	(23,616)
Më 31 dhjetor 2019	373,823	23,127	67,532	53,365	591,153	1,109,000

Zhvlërësimi i akumuluar

Më 1 janar 2018	(276,817)	(20,301)	(45,794)	(53,365)	-	(396,277)
Ngarkesa gjatë vitit	(21,124)	(878)	(7,120)	-	-	(29,122)
Të eliminuara me hudhjet	16,820	403	6,304	-	-	23,527
Më 31 dhjetor 2018	(281,121)	(20,776)	(46,610)	(53,365)	-	(401,872)
Ngarkesa gjatë vitit	(22,452)	(875)	(4,944)	-	-	(28,271)
Të eliminuara me hudhjet	16,519	783	6,314	-	-	23,616
Më 31 dhjetor 2019	(287,054)	(20,868)	(45,240)	(53,365)	-	(406,527)

Vlera neto në libra

Më 31 dhjetor 2019	86,769	2,259	22,292	-	591,153	702,473
Më 31 dhjetor 2018	36,351	2,724	6,036	-	591,153	636,264

Ndërtimet në vijim dhe avanset

Më 23 nëntor 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendimin nr. 06/117 për shpronësim në emër të interesit publik të pronës së ndërmarrjes shoqërore "P.SH. Shoqata SH.A.M. Vllaznim Union ", me lokacion në ngastrën kadastrale, P-7207-0, në Lakërishtë, Zona Kadastrale e Prishtinës, Komuna e Prishtinës, për qëllime të përmbushjes së nevojave për akomodim të FKPK-së.

Sipas ligjeve të privatizimit në fuqi - duke qenë se shpronësimi ka ndodhur në interesin publik - FKPK-ja është dashur të paguajë vetëm 20% të vlerës së pasurisë në vlerë prej 249,012 EUR (vlerësuar nga një anketues i pavarur me vlerë prej 1,245,060 EUR), pretendimet e ligjshme të kreditorëve të pranuar si të tilla nga Autoriteti i Likuidimit në shumën 340,142 EUR, dhe tarifat administrative prej 2,000 EUR. Andaj, në qershor të vitit 2018, FKPK-ja i ka paguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit shumën e plotë të kërkuar prej 591,153 EUR.

Autoriteti i Likuidimit ka refuzuar kërkesa në shumën prej 133,618 EUR, ndërkohë që vendimet e tyre mund të apelojnë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Sipas marrëveshjes së shpronësimit, FKPK është zotuar dhe obligohet të paguajë çdo dhe të gjitha pretendimet e venduara në favor të ankuesve nga Dhoma e Posaçme, dhe shumat e tilla do të shtojnë koston e përfitimit të parcelës së shpronësuar.

Titulli i pronës i është transferuar FKPK-së në regjistrin kadastral gjatë vitit 2019. Në datën e lëshimit të këtij raporti, FKPK-ja është në fazën e dizajnit të projektit për ndërtimin e zyrave qendrore të saj.

Gjatë viteve 2019 dhe 2018 FKPK-0 ka hudhur asetet e zhvlerësuar plotësisht.

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, nuk kishte peng mbi asetet e FKPK-0.

8 PASURITË ME TË DREJTA TË PËRDORIMIT DHE DETYRIMET E QIRASË

	Pasuritë me të drejta të përdorimit		Detyrimet e qirasë
	EUR		EUR
Më 1 janar 2018	-	Më 1 janar 2018	-
Shtesat gjatë vitit	-	Shpenzimet e interesit gjatë vitit	-
Zhvlërësimi gjatë vitit	-	Pagesat gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2018	-	Më 31 dhjetor 2018	-
Ndryshimi nga implementimi fillestar i SNRF 16	185,834	Ndryshimi nga implementimi fillestar i SNRF 16	191,481
Ri-paraqitur më 1 janar 2019	185,834	Ri-paraqitur më 1 janar 2019	191,481
Shtesat gjatë vitit	-	Shpenzimet e interesit gjatë vitit	10,540
Zhvlërësimi gjatë vitit	(46,458)	Pagesat gjatë vitit	(54,000)
Më 31 dhjetor 2019	139,376	Më 31 dhjetor 2019	148,021

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2019, KPST-O ka vetëm një qira, për zyrën e saj, të identifikuar si një pasuri me të drejta të përdorimit dhe është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e qirasë të shoqëruar me të njëjtën tregohen poa ashtu në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qiraja ka afat nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2023, ku të dy palët kanë mundësinë e ndërprerjes së qirasë duke dhënë një paralajmërin 9-mujor. Norma e përshkallëzuar e huamarrjes për detyrimet e qirasë të njohura në aplikimin fillestar më 1 janar 2019 ishte 6.49%, ndërsa zhvlërësimi i pasurisë me të drejtë të përdorimit bëhet sipas metodës drejtvizore përgjatë jetëgjatësisë së qirasë.

Duke pasur parasysh që qiraja paguhet në avans, pagesa fillestare nuk është përfshirë në detyrimet e qirasë. Me 31 dhjetor 2019, detyrimet e skontuara të qirasë në vlerë prej 148,021 EUR përbëhen nga 46,256 EUR si detyrime afatshkurta të qirasë ndërkaq 101,765 EUR si detyrime afatgjata të qirasë. Detyrimet e paskontuara të qirasë janë në shumë 162,000 EUR nga të cilat 54,000 EUR janë afatshkurtra ndërkaq 108,000 EUR janë afatgjata.

9 MJETET E PATRUPËZUARA

	Softuerët dhe Licencat
	EUR
Kostoja	
Më 1 janar 2018	412,888
Shtesat gjatë vitit	38,978
Hudhjet gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2018	451,866
Shtesat gjatë vitit	11,370
Hudhjet gjatë vitit	(7,520)
Më 31 dhjetor 2019	455,716
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2018	(365,907)
Ngarkesa gjatë vitit	(24,462)
Të eliminuara prej hudhjeve	-
Më 31 dhjetor 2018	(390,369)
Ngarkesa gjatë vitit	(17,967)
Të eliminuara prej hudhjeve	7,520
Më 31 dhjetor 2019	(400,816)
Vlera neto në libra	
Më 31 dhjetor 2019	54,900
Më 31 dhjetor 2018	61,497

10 LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Të pagueshmet për aktivitetet investuese	824,824	711,780
Akraulet për shtypje dhe dërgesë të pasqyrave individuale të llogarisë	115,409	93,301
Të pagueshmet dhe akraulet e tjera	44,353	63,126
Gjithsej të pagueshme	984,586	868,207

Më 31 dhjetor 2019 bilanci i të pagueshme për aktivitetet investuese përfshinë tarifat e menaxhimit të faturuara nga drejtuesit e investimeve të hapura në vlerë prej 824,081 EUR, si dhe tarifat e brokerimit në vlerë prej 743 EUR (2018: 711,037 EUR dhe 743 EUR, respektivisht).

11 SUFICITI

	2019			2018		
	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Të hyrat për vitin						
Të hyrat nga tarifat	1,294,186	6,941,657	8,235,843	1,212,535	6,447,812	7,660,347
Të hyrat e tjera	132,822	41,208	174,030	82,072	15,595	97,667
	1,427,008	6,982,865	8,409,873	1,294,607	6,463,407	7,758,014
Shpenzimet për vitin	(1,205,928)	(4,702,557)	(5,908,485)	(1,158,745)	(5,743,872)	(6,902,617)
Provizionet për humbjet e pritura kreditore, neto (rritja) / zvogëlimi	(333)	-	(333)	252	-	252
Suficiti për vitin	220,747	2,280,308	2,501,055	136,114	719,535	855,649
Suficiti në fillim të vitit - riparaqitur	509,983	101,362	611,345	379,516	81,827	461,343
Kthimi i suficitit tek FKPK-MP	-	(2,300,000)	(2,300,000)	-	(700,000)	(700,000)
Suficiti në fund të vitit	730,730	81,670	812,400	515,630	101,362	616,992

Gjatë vitit 2019 Bordi Drejtues vendosi t'i kthejë 2,300,000 EUR tek mjetet pensionale të kontribuesve (FKPK-MP) nga suficiti i aktiviteve investuese, gjë që lë bilanc të suficitit të përgjithshëm neto prej 812,400 EUR më 31 dhjetor 2019. Gjatë vitit 2018 Bordi Drejtues vendosi t'i kthejë 700,000 EUR tek mjetet pensionale të kontribuesve (FKPK-MP) nga suficiti i aktiviteve investuese, gjë që lë bilanc të suficitit të përgjithshëm neto prej 616,992 EUR më 31 dhjetor 2018.

12 TARIFAT E NGARKUARA NDAJ MJETEVE PENSIONALE

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet investuese	6,941,657	6,447,812
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet operacionale	1,294,186	1,212,535
Gjithsej tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	8,235,843	7,660,347

Tarifat llogariten në baza ditore sipas formulës:

$$\text{Tarifa} = [\text{Mjetet bruto të pjesëmarrësve}] * [\text{Norma}] / [\text{Numri i ditëve kalendarike në vit}].$$

Gjithsej tarifa e ngarkuar mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve me qëllim të financimit të aktiviteteve të FKPK-së për fundvitin 31 dhjetor 2019 ishte 8,235,843 EUR (2018: 7,660,347 EUR).

Tarifat e aplikueshme vjetore për periudhën e raportimit, siç janë miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168, ishin si në vijim:

Prej	Deri	Tarifa për aktivitetet investuese	Tarifa për aktivitetet operacionale	Gjithsej tarifat
1 janar 2018	31 janar 2018	0.393% p.v.	0.081% p.v.	0.474% p.v.
1 shkurt 2018	15 maj 2019	0.381% p.v.	0.071% p.v.	0.452% p.v.
16 maj 2019	31 dhjetor 2019	0.370% p.v.	0.069% p.v.	0.439% p.v.

13 TË HYRAT NGA MJETET E TJERA

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
<i>Aktivitetet operative</i>		
Të hyrat nga interesi i investimeve në depozita dhe llogari rrjedhëse	121,765	82,072
Neto të hyrat nga refondimi i kontributeve	7,862	-
Të hyrat e tjera nga aktivitetet operacionale	3,195	-
	132,822	82,072
<i>Aktivitetet investuese</i>		
Rabati nga AXA-WFOI	39,100	15,595
Të hyrat e tjera nga aktivitetet investuese	2,108	-
	41,208	15,595
Gjithsej të hyrat nga mjetet e tjera	174,030	97,667

Kontributet pensionale që hyjnë në llogarinë e arkëtimit (llogaria e FKPK-MP në BQK) shndërrohen në njësi në ditën e arkëtimit. Herë pas here, transferimet bëhen gabimisht (pjesërisht ose plotësisht) nga paguesi, dhe kur kjo kuptohet FKPK, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-101, refondon shumën nominale të kontributit të gabuar. Sipas politikave të FKPK-së, diferencat neto midis (i) shumës nominale të refonduar, dhe (ii) vlerës së njërive përkatëse në ditën e refondimit; trajtohen për FKPK-0 si të hyra të tjera kur janë pozitive, dhe si shpenzime të tjera kur ato janë negative. Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019, të hyrat neto nga refondimi i kontributeve arriti në 7,862 EUR (2018: shpenzim neto në vlerë 4,559 EUR).

14 TARIFAT NETO TË INSTRUMENTEVE PËR INVESTIME TË HAPURA

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019			Për fundvitin 31 dhjetor 2018		
	Tarifa bruto	Rabati	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabati	Tarifa neto
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	365,610	(167,640)	197,970	986,158	(510,133)	476,025
BNY Mellon – RRF	1,246,615	-	1,246,615	488,895	-	488,895
AXA – GILB	153,678	(9,194)	144,484	394,407	(49,301)	345,106
Schroders – SISF	100,784	-	100,784	50,969	-	50,969
Schroders – GDG	293,788	-	293,788	813,018	-	813,018
Nordea 1 – GSEF	414,968	-	414,968	689,736	-	689,736
Nordea 1 – SRF	1,129,320	-	1,129,320	942,218	-	942,218
Amundi – 3M I	221,064	(84,790)	136,274	16,719	-	16,719
AXA – WFOI	238,363	-	238,363	716,717	-	716,717
BNP Paribas – PDP	450,555	(106,478)	344,077	1,014,653	(147,058)	867,595
Amundi – RPI2	161,370	-	161,370	253,115	-	253,115
Corp Bond Eur ETF	46,473	-	46,473	-	-	-
S&P500 Minvol ETF	64,637	-	64,637	-	-	-
Amun. EurCorp ETF	37,062	-	37,062	-	-	-
MSCI USA Qual ETF	2,768	-	2,768	-	-	-
Pictet – HDS	-	-	-	44,293	-	44,293
Gjithsej tarifat neto të instrumenteve të hapura	4,927,055	(368,102)	4,558,953	6,410,898	(706,492)	5,704,406

15 KOSTOJA E STAFIT

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Pagat e stafit	456,201	462,045
Kontributet pensionale të punëdhënësit	59,874	63,749
Kostoja e Kontratës Kolektive	42,176	39,029
Sigurimi shëndetësor	4,702	5,879
Puna jashtë orarit, bonuset dhe kostot e tjera të stafit	21,500	3,673
Gjithsej kostoja e stafit	584,453	574,375

16 SHPENZIMET PËR BORDIN DREJTUES

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Kompensimi për anëtarët	124,600	123,850
Takimet (udhëtimet/hotelet/kostot e tjera)	34,505	48,708
Sigurimi fiduciar	22,709	22,663
Kontributet pensionale të punëdhënësit	11,461	12,641
Gjithsej shpenzimet për Bordin Drejtues	193,275	207,862

17 SHËRBIMET PROFESIONALE/KONTRAKTORËT/KONSULENTËT

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Shërbimet e dizajnit dhe marrëdhënjeve me publikun	4,815	4,977
Shërbimet e auditimit të brendshëm	2,940	2,678
Shërbimet arkitektonike	2,007	1,801
Shërbimet e përkthimit dhe lektorimit	818	640
Shërbimet e noterëve/ligjore dhe të tjera	679	284
Gjithsej shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	11,259	10,380

18 NGJARJET PAS PERIUdhËS SË RAPORTIMIT

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka ndikuar rëndë në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset janë duke u detyruar të ndërpresin ose kufizojnë punën për periudha të gjata ose periudha të pacaktuara kohore. Masat e ndërmarra për të parandaluar përhapjen e virusit, përfshirë këtu edhe ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin social dhe mbylljen e shërbimeve jo esenciale kanë shkaktuar pengesa të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve po ashtu kanë përgjatur një luhatshmëri të lartë, si dhe dobësim të konsiderueshëm. Përderisa qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për t'i stabilizuar kushtet ekonomike, megjithatë kohëzgjatja dhe shtrirja e ndikimit nga pandemia COVID-19 dhe efektiviteti i reagimit nga qeveritë dhe bankat qendrore mbeten të paqarta në këtë kohë.

Rreziku i përgjithshëm ndaj operimit

Këto ngjarje e kanë penguar, por nuk e kanë ndalur, funksionimin normal të FKPK-së. Të gjitha operacionet janë duke u trajtuar, si dhe shërbimet janë duke u ofruar, përmes përdorimit të një pjese të stafit në zyrë dhe të tjerët që punojnë nga shtëpia. Duke qenë se FKPK-O nuk ka pasur ekspozim ndaj instrumenteve financiare të afektuara, andaj nuk ka pasur ndikim në pozicionin financiar të FKPK-O, ose të ardhurat e saj, dhe të dyja mbeten shumë të qëndrueshme.

FKPK-ja ka vendosur që këto ngjarje janë ngjarje pasuese që nuk kërkojnë përshtatje. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve nga (dhe për) vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 nuk janë përshtatur që të pasqyrojnë ndikimin e tyre.

Është e arsyeshme të vlerësohet me besueshmëri se, pavarësisht kohëzgjatjes dhe ashpërsisë së këtyre pasojave, nuk do të ketë ndikim në pozicionin financiar dhe rezultatet e FKPK-O për periudhat e ardhshme.

Më 31 dhjetor 2019, përpos të shpalosurave sipër, nuk ka ngjarje të tjera të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalosje të mëtejshme në këto pasqyra financiare.

ANEKS

8

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS MJETET PENSIONALE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË PJESËMARRËSVE	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-31

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton L.L.C.
Rexhep Mala 18
10000 Prishtine
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802

Për Bordin e Drejtorëve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale (“FKPK”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto të pjesëmarrësve dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që ka përfunduar më këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona në kuadër të këtyre standardeve janë të përshkruara më poshtë në seksionin Përgjegjësitë Auditorit për auditimin e pasqyrave në këtë raport. Ne jemi të pavaruar nga FKPK në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe gjithashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEK-së. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e FKPK, për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë FKPK-në, ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të FKPK-së.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtrimit, dizajnojmë dhe performojmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i moszbulimit të gabimeve materiale nga mashtrimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se risku i mashtrimit mund të përmbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të FKPK..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijmësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në dëshmitë e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që FKPK mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në dëshmitë tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që FKPK të ndërprejë operimin e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajten e pasqyrave financiare të veçanta duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale për, përpos të tjerave për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësi të rëndësishme eventuale në kontrollat e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Grant Thornton LLC


Prishtinë,
10 prill 2020



Suzana Stavrikj
Auditor ligjor





	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Mjetet			
Paraja në bankë	4	3,279,603	6,245,153
Kontributet dhe të arkëtueshmet e tjera	5	12,274,188	131,347,368
Investimet në fondet e hapura investuese	6	1,480,058,308	1,227,330,357
Fletobligacionet e Kosovës	7	298,483,698	208,510,864
Afatizimet bankare	7	185,620,151	119,344,093
		1,979,715,948	1,692,777,835
Detyrimet			
Detyrimet ndaj FKPK-O	8	553,143	410,601
Detyrimet për aksionet e riblera	9	650,497	424,779
Jo-kontributet	10	38,174	34,257
Interesi i pagueshëm	4	14,627	5,030
		1,256,441	874,667
Mjetet neto të pjesëmarrësve		1,978,459,507	1,691,903,168

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK dhe nënshkruar në emër të tyre më 31 mars 2020.


Z. Ruzhdi Morina
 Kryesues i Bordit Drejtues




Z. Adrian Zalli
 Drejtor Menaxhues


Z. Vërshim Hatipi
 Zëvendësdrejtor- Financa | Investime e Risk | TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Të hyrat			
Rritjet në fondet e hapura investuese – neto	6	150,898,794	-
Të hyrat e interesit nga fletobligacionet e Kosovës	7	5,299,465	2,353,410
Të hyrat e interesit nga afatizimet bankare	7	2,261,648	847,793
Të hyrat e tjera	11	2,300,000	700,000
		160,759,907	3,901,203
Shpenzimet			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	12	(8,235,843)	(7,660,347)
Shpenzimet e interesit të parasë së gatshme në BQK	4	(99,699)	(66,673)
Rëniet në fondet e hapura investuese – neto	6	-	(88,540,994)
		(8,335,542)	(96,268,014)
Neto (rritja) në provizionet për humbjet e pritura kreditore	7	(178,140)	(415,300)
Rritja / (Rënia) në mjetet neto të pjesëmarrësve		152,246,225	(92,782,111)

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Kontributet e Pjesëmarrësve	Fitimet e Mbajtura	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2018	1,308,285,047	336,336,533	1,644,621,580
Kontributet	173,852,170	-	173,852,170
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(24,832,011)	(6,515,483)	(31,347,494)
Riblerjet si pasojë e kthimit të mjeteve të paalokuara	(1,223,238)	(399,260)	(1,622,498)
Riblerjet si pasojë e refundimeve	(826,887)	8,408	(818,479)
(Rënia) në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	(92,782,111)	(92,782,111)
Më 31 dhjetor 2018	1,455,255,081	236,648,087	1,691,903,168
Kontributet	187,548,325	-	187,548,325
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(41,850,770)	(10,733,164)	(52,583,934)
Riblerjet si pasojë e refundimeve	(646,415)	(7,862)	(654,277)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	152,246,225	152,246,225
Më 31 dhjetor 2019	1,600,306,221	378,153,286	1,978,459,507

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale			
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve		152,246,225	(92,782,111)
<i>Korrigjimet për:</i>			
(Rritja) / Ulja tek fondet e hapura (neto nga tarifat e ndalura)		(149,157,214)	91,922,763
Lëvizja neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	7	178,140	415,300
Të hyrat nga interesi	7	(7,561,113)	(3,201,203)
Shpenzimet e interesit	4	99,699	66,673
		(4,194,263)	(3,578,578)
Interesi i arkëtuar		5,873,117	2,048,667
Interesi i paguar		(90,102)	(65,261)
		1,588,752	(1,595,172)
<i>Lëvizja e kapitalit punues:</i>			
Rritja i detyrimeve për tarifa	8	137,870	18,801
Rritja / (Ulja) e detyrimeve për jo-kontribute	10	3,917	(15,041)
Ulja / (Rritja) në të arkëtueshmet nga tërheqjet dhe maturimet		120,000,000	(111,907,440)
Rrjedhja neto e parasë (e përdorur) nga operacionet		121,730,539	(113,498,852)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
(Shtesat) në fondet e hapura investuese	6	(1,431,956,161)	(422,575,982)
Tërheqjet nga fondet e hapura investuese	6	1,328,385,424	581,473,372
(Shtesat) në fletobligacione të Kosovës	7	(140,001,490)	(177,350,917)
Maturimi i fletobligacioneve të Kosovës (kryegjëja)	7	50,800,454	64,278,922
(Shtesat) në afatizimet bankare	7	(141,538,000)	(106,000,000)
Maturimi i afatizimeve bankare (kryegjëja)	7	76,000,000	37,401,000
Rrjedhja neto e parasë (e përdorur) nga aktivitetet investuese		(258,309,773)	(22,773,605)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Kontributet e pranuar të pjesëmarrësve		186,612,628	172,656,152
Tërheqjet e kursimeve		(52,225,969)	(42,985,423)
Refondimet		(772,975)	(820,371)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese		133,613,684	128,850,358
(Zvogëlimi) në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj		(2,965,550)	(7,422,099)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		6,245,153	13,667,252
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	3,279,603	6,245,153

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplimentuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168 dhe Nr. 05/L-116; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga ekspertë të investimeve dhe pensioneve, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 04/L-101, një anëtar pa të drejtë vote do të përfaqësojë interesat e Qeverisë. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, Bordi i Drejtorëve ka funksionuar pa anëtarin pa të drejtë vote.

Këto pasqyra financiare janë për FKPK – Mjetet pensionale (ose "FKPK-MP") e që janë kursimet pensionale (mjetet pensionale) të kontribuuesve. Pasqyrat financiare për FKPK- Operacionet (ose "FKPK-O"), i cili është subjekti i menaxhimit dhe administrimit të kursimeve pensionale (mjeteve pensionale) të kontribuuesve, janë përgatitur veçmas për pasqyrat financiare për mjetet e pensioneve.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhjes

Pasqyrat financiare të FKPK-MP janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-MP i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare në bazën akruale sipas konventës së kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i aseteve dhe detyrimeve financiare të matura me VDFH. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në EUR, e cila është valuta funksionale dhe raportuese e FKPK-MP. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshtatjes me prezantimin e vitit aktual.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

i) Aplikimi fillestar i standardit të ri si dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën aktuale të raportimit

Standardi i ri si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, ishin në fuqi për periudhën aktuale:

- **IFRS 16 "Qiratë"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- Ndryshimet në standarde të ndryshme: Pasoja tatimore të pagesave në instrumentet e klasifikuara si ekuitet (ndryshimet në SNK 12); Plani i ndryshimit, zhdukja ose zgjidhja (Ndryshimet në SNK 19), Kostot e huazimit të pranueshme për kapitalizim (Ndryshimet në SNK 23); Interesat afatgjatë në asociime dhe ndërmarrësi të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28); Interesat e mbajtura më parë në operacione të përbashkëta (Ndryshimet në SNRF 3 dhe SNRF 11); Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9) - të gjitha në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019;
- KIRFN 23 **"Pasiguritë mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat"** - në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

Implementimi i standardeve të mësipërme nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-MP.

ii) Standardet e reja si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara që ende nuk janë përvetësuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja në vijim dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, janë publikuar por ende nuk kanë hyrë në fuqi:

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar);
- **Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)** - në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020;
- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo-rrjedhëse (Ndryshimet në SNK 1) - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

FKPK-MP ka zgjedhur të mos përvetësojë këto standarde, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime përpara se ato të hyjnë në fuqi. FKPK-MP parashikon që përvetësimi i këtyre standardeve dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-MP në periudhën e zbatimit fillestar.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Instrumentet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si asete, detyrime ose ekuitet në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra apo shpenzime. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-MP ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë, qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një aset dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare

Metodat e matjes

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Kostoja e amortizuar dhe norma efektive e interesit

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën aseti ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryegjësë, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj vlere fillestare dhe shumës së maturimit dhe, për asetet financiare, përshtatjet për çdo provizion të dëmtimit.

Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrzet flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nëpërmjet jetës së pritur të asetit ose detyrimit financiar në vlerën bartëse bruto të një aseti financiar (koston e amortizuar para çfarëdo provizioni për dëmtim) ose koston e amortizuar të një detyrimi financiar. Llogaritja nuk merr parasysh humbjet e pritura të kreditit dhe përfshin kostot e transaksionit, primet ose zbritjet dhe tarifatat e pikat e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, siç janë tarifatat e origjinës.

Kur FKPK-MP rishikon vlerësimet për flukset monetare të ardhshme, vlera bartëse e aseteve ose detyrimeve financiare përkatëse është e rregulluar për të pasqyruar vlerësimin e ri të skontuar duke përdorur normën efektive të interesit fillestare. Çdo ndryshim njihet në fitim ose humbje.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën bruto të bartur të aseteve financiare, përveç:

- Pasuritë financiare të blera me, ose me origjinë nga, kredit të dëmtuar (BOKD);
- Pasuritë financiare që nuk ishin BOKD, por më pas u bënë me kredit të dëmtuar ("Faza 3"), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (dmth. pas provizionit ECL).

Njohja fillestare dhe matja

Asetet dhe detyrimet financiare njihen kur FKPK-MP bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit, datën kur FKPK-MP zotohet për blerjen ose shitjen e asetit.

Në njohjen fillestare, FKPK-MP mat një aset ose detyrim financiar me vlerën e saj të drejtë plus ose minus, në rastin e një aseti ose detyrimi financiar që nuk matet me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që janë në rritje dhe që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit e asetit ose detyrimit financiar, siç janë tarifatat dhe komisionet.

Kostot e transaksionit të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes pasqyrohen si shpenzime në fitim dhe humbje. Menjëherë pas njohjes fillestare, një provizion i humbjes së pritshme kreditore (HPK) njihet për asetet financiare të matura me koston e amortizuar dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj), gjë që rezulton në një humbje kontabël që njihet në fitim dhe humbje për një aset të sapo njohur.

Kur vlera e drejtë e aseteve dhe detyrimeve financiare ndryshon nga çmimi i transaksionit me njohjen fillestare, FKPK-MP njihet diferencat si në vijim:

- Kur vlera e drejtë dëshkohet me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik (dmth. një input i Nivelit 1) ose bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, diferenca njihet si fitim ose humbje;
- Në të gjitha rastet e tjera, diferenca shtyhet dhe afati i njohjes së fitimit ose humbjes së ditës së shtyrë përcaktohet individualisht. Ai amortizohet përgjatë jetës së instrumentit, shtyhet derisa vlera e drejtë e instrumentit të mund të përcaktohet duke përdorur të dhëna të vëzhgueshme nga tregu, ose kur ajo realizohet nëpërmjet shlyerjes.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.1. Asetet financiare

i) Klasifikimi dhe matja pasuese

FKPK-MP klasifikon asetet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme matëse:

- *Kostoja e amortizuar*: Pasuritë që mbahen për arkëtim të flukseve monetare kontraktuale ku ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (VPKI) dhe që nuk janë klasifikuar në VDFH, maten me koston e amortizuar. Vlera e bartur e këtyre aseteve korrigjohet për çfarëdo provizionimi të njohur dhe të matur për humbjet e pritura kreditore. Të ardhurat e interesit nga këto asete financiare përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit;
- *Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)*: Asetet financiare që mbahen për arkëtim të flukseve monetare kontraktuale si dhe për shitjen e atyre aseteve, ku flukset monetare të aseteve përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe të interesit dhe që nuk janë klasifikuar në VDFH, maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Lëvizjet në vlerën e bartur merren përmes ATGj, përveç njohjes së fitimeve ose humbjeve nga provizionimi, të ardhurat nga interesi dhe fitimet ose humbjet në këmbim valutor të instrumenteve që njihen në fitim dhe humbje. Kur aseti financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGj riklasifikohet nga ekuiteti në fitim dhe humbje dhe njihet në 'Të ardhurat neto nga investimet'. Të ardhurat nga interesi i këtyre aseteve përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit;
- *Vlera e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (VDFH)*: Asetet që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose VDATGj maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe nuk është pjesë e një plasmani mbrojtës, njihet në fitim ose humbje dhe paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes tek 'Të ardhurat neto të tregtimit' në periudhën në të cilën shfaqet, përveç nëse buron nga instrumente borxhi të klasifikuara me vlerë të drejtë ose që nuk mbahen për tregtim, në të cilin rast ato paraqiten ndaras tek 'Të ardhurat neto nga investimet'. Të ardhurat nga këto asete financiare përfshihen në 'Të ardhurat nga interesi' duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Instrumentet e borxhit

Instrumentet e borxhit janë ato instrumente që përmbushin përkufizimin e një detyrimi financiar nga perspektiva e emetuesit, të tilla si huatë, obligacionet e qeverisë dhe të korporatave dhe të arkëtueshmet tregtare të blera nga klientët në marrëveshjet e faktoring-ut pa rekurs.

Klasifikimi dhe matja pasuese e instrumenteve të borxhit varen nga:

- modelin e biznesit të FKPK-MP për menaxhimin e asetit; dhe
- karakteristikat e rrjedhës së parasë të aktivitetit.

Në bazë të këtyre faktorëve, FKPK-MP klasifikon instrumentet e borxhit në njërin nga kategoritë e matjes: (a) Kostoja e amortizuar; (b) VDATGj; ose (c) VDFH. FKPK-MP ka klasifikuar instrumentet e saj të borxhit të përbërë nga investime në bonot dhe obligacionet e Thesarit të Kosovës, si dhe investimet në afatizimet bankare të vendosura me bankat tregtare në Kosovë, të matura me koston e amortizuar. FKPK-MP nuk ka instrumente borxhi të klasifikuara si VDATGj ose VDFH.

Modeli i biznesit: modeli i biznesit pasqyron se si FKPK-MP menaxhon asetet në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare, dhe instrumentet klasifikohen në një nga tri kategoritë e matjeve të përmendura më lart. Si e tillë, investimet në afatizimet bankare si dhe ato në bonot dhe obligacionet e Thesarit të Kosovës klasifikohen me kosto të amortizuar.

VPKI: ku modeli i biznesit është t'i mbajë asetet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe të shesë, FKPK-MP vlerëson nëse flukset monetare të instrumentit financiar përfaqësojnë vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (Testi VPKI). Gjatë vlerësimit, FKPK-MP shqyrton nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, dmth. interesi përfshin vetëm konsideratën për vlerën kohore të parasë, rrezikun e kredisë, rreziket e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit që është në përputhje me marrëveshjen bazë të huadhënies. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk përputhet me një marrëveshje bazë të huadhënies, instrumenti financiar përkatës klasifikohet dhe matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

FKPK-MP riklasifikon investimet në instrumente borxhi kur dhe vetëm kur ndryshon modeli i tij i biznesit për menaxhimin e këtyre aseteve. Riklasifikimi bëhet nga fillimi i periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit. Këto ndryshime pritët të jenë shumë të rralla dhe asnjë nuk ka ndodhur gjatë periudhës.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.1. Asetet financiare (vazhdim)

i) Klasifikimi dhe matja pasuese (vazhdim)

Instrumentet e aksionit dhe fondet e hapura investuese

Instrumentet e aksionit janë instrumente që plotësojnë përkufizimin e kapitalit nga perspektiva e emetuesit; që është, instrumente që nuk përmbajnë një detyrim kontraktual për të paguar dhe që reflektojnë një interes të mbetur në asetet neto të emetuesit. Shembuj të instrumenteve të aksionit përfshijnë aksionet e zakonshme me të cilat FKPK-MP nuk posedon, por edhe aksionet në fonde të hapura investive të cilat FKPK-MP i mban.

FKPK-MP klasifikon dhe më pas mat të gjitha investimet e tilla me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, përveç rasteve kur menaxhmenti i FKPK-MP, në njohjen fillestare, pakthyeshem e përcakton një investim në aksione me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur këto investime nuk mbahen vetëm për qëllime të gjenerimit të kthimit nga investimet. Në raste të tilla, çfarë nuk ka pasur asnjë gjatë periudhës raportuese, fitimet ose humbjet në vlerën e drejtë njihen në HTGj dhe nuk riklasifikohen më pas në fitim ose humbje, as kur ato heqen. Humbjet nga dëmtimet (zhvlerësimet), dhe anulimet e humbjeve nga dëmtimet, nuk raportohen ndaras nga ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë. Dividendët, kur paraqesin kthim nga këto investimeve, vazhdojnë të njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera kur përmbushet e drejta e FKPK-MP për t'i pranuar ato pagesa.

FKPK-MP ka klasifikuar investimet e saj në fondet e hapura si të matura në VDFH dhe nuk ka investime të kapitalit të klasifikuar si VDHTGj.

Fitimet ose humbjet nga investimet në fondet e hapura të matura në FVPL dhe janë përfshirë si të hyra ose shpenzime në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

ii) Dëmtimi

FKPK-MP mbi bazën e parashikimit vlerëson humbjet e pritshme kreditore (HPK) të lidhura me asetet e instrumenteve të borxhit të bartura me kosto të amortizuar. FKPK-MP në çdo datë raportimi nje një provizion humbjesh për humbjet e tilla. Matja e HPK pasqyron:

- Një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme;
- Vlerën kohore të parasë; dhe
- Informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të tepërta në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

iii) Çregjistrimi jo përmes modifikimit

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga asetet kanë skaduar, ose kur ato janë transferuar dhe ose (a) FKPK-MP transferon substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, ose (b) FKPK-MP as nuk transferon e as nuk mban substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe FKPK-MP nuk ka mbajtur kontroll. Nuk pati raste të tilla gjatë periudhës raportuese.

3.2.2. Detyrimet financiare

i) Klasifikimi dhe matja pasuese

Në periudhën aktuale dhe paraprake të raportimit, detyrimet financiare klasifikohen dhe më pas maten me koston e amortizuar.

ii) Çregjistrimi

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

3.2.3. Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i rëndit asetet dhe detyrimet financiare në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për asete dhe detyrime identike;
 Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, mënjanë nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e aseteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe
 Niveli 3: shënimet hyrëse për asetet e detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Në datën e raportimit, instrumentet financiare të FKPK-MP të matura sipas vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

Klasa e investimeve	Niveli	Më	Më
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
		EUR	EUR
Fondet e hapura investuese	1	1,480,058,308	1,227,330,357

Matjet e vlerës së drejtë të listuara sipër janë periodike. Nuk ka pasur lëvizje të mjeteve në mes të niveleve gjatë viteve që kanë përfunduar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

Vlera e drejtë e aseteve të tjera financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përafrojnë vlerat e tyre kontabël për shkak të maturitetit afatshkurtër.

3.3 Vlerësimet dhe gjykimet e konsiderueshme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Menaxhmenti gjithashtu duhet të ushtrojë gjykim në zbatimin e politikave kontabël të FKPK-MP. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme.

Ky shënim shpalosë fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit dhe kompleksitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit që kanë një rrezik të theksueshëm për të rezultuar në përshtatje materiale gjatë vitit të ardhshëm financiar. Informata të hollësishme për secilën nga këto vlerësime dhe gjykime përfshihen në shënimet përkatëse së bashku me informacionin në lidhje me bazën e llogaritjes për çdo element të linjës së prekur në pasqyrat financiare.

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore

Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore për asetet financiare të matura me koston e amortizuar dhe VDHTGJ është një sferë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të theksueshme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë (p.sh. gjasat e mospagesës së Thesarit të Kosovë dhe humbjet që rezultojnë). Shpjegimi i këtyre inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit të përdorura në matjen e HPK është detajuar më tej në Shënimin 3.8.5, i cili gjithashtu përcakton ndjeshmëritë kyçe të HPK ndaj ndryshimeve në këto elemente.

Disa gjykime të rëndësishme gjithashtu janë të nevojshme për zbatimin e kërkesave të kontabilitetit për matjen e ECL, si:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë;
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e HPK;
- Vendosja e numrit të peshave relative të skenarëve parashikues për çdo lloj produkti / tregu dhe HPK-në përkatëse; dhe
- Krijimi i grupeve të aseteve të ngjashme financiare për qëllime të matjes së HPK.

3.4 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Për qëllime të rrjedhjes së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit deri në tre muaj. Përfashtim bëjnë investimet në depozita bankare pa datë maturimi por me afat paralajmërimi dhe të cilat Bordi Drejtues nuk ka për qëllim t'i shesë.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Kontributet

Kontributet e pranuar nga pjesëmarrësit llogariten në bazë akruale.

3.6 Tërheqjet e kursimeve dhe refondimet

Tërheqjet e kursimeve, ose pagesat e benefiteve, të cilat u paguhen pjesëmarrësve ose pasardhësve të tyre, si dhe refondimet e kontributeve të gabuara, njihen në periudhën në të cilën njësitë përkatëse janë riblerë.

3.7 Tatimi

Mjetet pensionale të FKPK-së janë të lira nga tatimi në fitim i korporatave.

3.8 Menaxhimi i riskut financiar

Detyrimet ndaj pjesëmarrësve të FKPK-MP janë gjithmonë në vlerë të njëjtë me vlerën neto të aseteve të pjesëmarrësve, pra nuk ka hendek financimi për benefitet e ardhshme, për ç'arsye FKPK-MP nuk bën vlerësime aktuale. Detyrimet e FKPK-MP nuk përbëhen nga asnjë instrument financiar, p.sh. mjete të huazuara nga institucione të tjera financiare, çfarë edhe e bën jo të nevojshëm menaxhimin e riskut për pjesën e detyrimeve të FKPK-MP.

Kur është në pyetje vlerësimi i riskut të instrumenteve financiare të cilat përbëjnë pjesën e aseteve të FKPK-MP, pjesa dërrmuese e investimeve janë përmes instrumenteve për investime të hapura, që nënkupton se menaxhimi i riskut në baza ditore i është besuar menaxhuesve të këtyre instrumenteve. Si rezultat, asetet financiare të FKPK-MP i ekspozohen drejtpërdrejt vetëm një numri të vogël rreziqesh (kryesisht riskut të çmimit) dhe atë vetëm me një pjesë të kufizuar të mjeteve, të cilat rreziqe Bordi Drejtues synon t'i menaxhojë përmes politikës së investimeve.

Politika e investimeve kërkon mbi të gjitha që mjetet e investuara, qoftë direkt a indirekt, të jenë të diversifikuara mirë nëpër emetues dhe klasa të aseteve, si dhe në qasje investuese të fondeve të hapura investuese. Tutje, si mënyrë për menaxhim të risqeve direkte, politika vendos kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në klasa instrumentesh të caktuara (me vetëm aksione: 55%; me klasa mikse të aseteve: 55%; me vetëm fletobligacione duke përfshirë obligacionet e Thesarit të Kosovës: 35%; dhe tregje të parasë dhe bonote Thesarit të Kosovës: 50%); si dhe kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente me qasje të caktuar investuese (me Kthim drejtimor/Kthim pa përshtatje për risk: 60%; me Target risku/Menaxhim risku/Kthim absolut: 68%; dhe me të ardhura: 70%). Në përputhje me këtë kornizë Bordi Drejtues merr vendime të rrisëose zvogëlojë ekspozimin ndaj një instrumenti të caktuar për investime të hapura varësisht nga performanca dhe plasmanet e instrumentit, ose korrelacionit të tij me instrumentet e tjera, si dhe bindjet për perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme për klasën e aseteve dhe qasjen investuese të instrumentit në fjalë. FKPK-ja nuk aranzhon kontrata në avancë (*forwards*), shkëmbime (*swaps*) ose derivate të tjera (*derivatives*) për të menaxhuar dhe kontrolluar këto risqe për mjetet e FKPK-MP.

Departamenti i Investimeve dhe Riskut i FKPK-së në baza të rregullta analizon pajtueshmërinë e investimeve, direkte si dhe indirekte përmes portofoliovë të instrumenteve për investime të hapura, me politikat investuese të FKPK-së. Risku dhe luhatshmëria e investimeve direkte dhe indirekte po ashtu vlerësohen në baza të rregullta. Të gjeturat shqyrtohen nga Komisioni i investimeve i Bordit Drejtues të FKPK-së, dhe shërbejnë si ndihmë në vendimmarrje për investimet. Në vijim prezantohen rreziqet kryesore të cilave direkt iu ekspozoheshin asetet e FKPK-MP në datat e raportimit:

3.8.1 Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit është risku që vlera reale e rrjedhave të ardhshme të parasë nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Në datën e raportimit FKPK-MP kishte investime direkte në fletobligacione të Thesarit të Kosovës si dhe depozita me afat me bankat komerciale të cilat kishin normë fikse të interesit, ndërsa nuk kishte investime direkte në instrumente financiare me normë variable të interesit.

	Më 31 dhjetor 2019		Më 31 dhjetor 2018	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR
Normë fikse				
Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës	298,483,698	-	208,510,864	-
Afatizimet bankare	185,620,151	-	119,344,093	-
Gjithsej	484,103,849	-	327,854,957	-

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8.2 Risku i çmimit

Përkundër uljes së moderuar të ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të vlerës së drejtë të instrumenteve për investime të hapura, risku i çmimit vazhdon të jetë faktori më i rëndësishëm i riskut direkt ndaj asetëve të investuara të FKPK-MP. FKPK-MP përmes politikës së investimeve tenton të menaxhojë këtë risk duke i shpërndarë investimet në instrumente për investime të hapura pa korreleacion me njëra-tjetër, e që në portofolet e tyre investuese kanë klasa të ndryshme të instrumenteve financiare si dhe qasje dhe objektiva të ndryshme investuese.

Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të çmimit të instrumenteve të hapura për investime

Sikur çmimet e instrumenteve për investime të hapura të ishin 5% më të larta/ulëta në datën e raportimit, atëherë mjetet neto të pjesëmarrësve do të rriteshin/ulëshin me 74,002,915 EUR (2018: 61,366,009 EUR).

Rënia maksimale (*maximum drawdown*) për portofolin e FKPK-MP për periudhën 1 vjeçare të përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte 4.8% ndërsa për periudhën 3 vjeçare ishte 8.2% (2018 8.2% dhe 8.2% përkatësisht).

Raporti i luhatshmërisë kundrejt performancës për periudhën 1 vjeçare të përfunduar më 31 dhjetor, 2019 ishte 3.81; ku luhatshmëria vjetore ishte 2.3% dhe performanca +8.87% (2018: -1.06, 5.0% dhe -5.28% përkatësisht). Nga ana tjetër raporti për periudhën 3 vjeçare ishte 0.87; ku luhatshmëria vjetore ishte 3.7% ndërsa performanca vjetore 3.17% (2018: 0.39, 4.5% dhe 1.75% përkatësisht).

3.8.3 Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e parave të gatshme të mjaftueshme, disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet instrumenteve adekuate kreditore dhe aftësinë për arkëtim në kohë - brenda afateve të përcaktuara - të shumave të arkëtueshme nga palët e treta.

Mesatarja mujore e riblerjeve nga FKPK-MP përmes tërheqjeve të kursimeve dhe refondimeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte 4,436,518 EUR (2018: 2,747,499 EUR). Kontributet mesatare mujore të arkëtuara për vitin, në shumën prej 15,551,052 EUR (2018: 14,388,013 EUR), vazhduan të jenë dukshëm më të larta sesa të dalurat mujore.

Investimet e matura me vlerë të drejtë (instrumentet e hapura për investime) mund të tërhiqen brenda 1 deri 5 ditëve por janë paraqitur si investime afatgjata. Investimet e FKPK-MP në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës kanë një afat origjinal të maturimit deri në dhjetë vjet, ndërsa afatizimet bankare kanë afat origjinal të maturimit prej 1 dhe 3 vjetëve.

Tabela e mëposhtme paraqet maturimet kontraktuale të mbetura të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPK-MP.

	Më 31 dhjetor 2019			Më 31 dhjetor 2018		
	Deri 1 vit	1-5 vjet	5-10 vjet	Deri 1 vit	1-5 vjet	5-10 vjet
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Mjetet financiare						
Paraja në bankë	3,279,603	-	-	6,245,153	-	-
Fondet e hapura	-	-	1,480,058,308	-	-	1,227,330,357
Thesari i Kosovës	77,695,694	200,332,878	20,455,126	50,863,036	136,400,021	21,247,807
Afatizimet bankare	112,949,255	72,670,896	-	76,243,274	43,100,819	-
Kontributet dhe të arkëtueshmet e tjera	12,274,188	-	-	131,347,368	-	-
	206,198,740	273,003,774	1,500,513,434	264,698,831	179,500,840	1,248,578,164
Detyrimet financiare						
Llogaritë e pagueshme	1,256,441	-	-	874,667	-	-
	1,256,441	-	-	874,667	-	-
Hendeku i maturimit	204,942,299	273,003,774	1,500,513,434	263,824,164	179,500,840	1,248,578,164

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8.4 Risku valutor

Në datën e raportimit plasmanet në fletobligacionet e Thesarit të Kosovës si dhe afatizimet në banka ishin të gjitha në valutën EUR. Si mjet për menaxhimin e riskut valutor në instrumentet për investime të hapura, politika e investimeve e FKPK lejon vetëm deri në 10% të mjeteve të FKPK-MP të jenë të investuara në instrumente jo të denominuara në EUR ose pa mbrojtje në EUR.

Instrumentet për investime të hapura në të cilat FKPK-ja kishte investime në datën e raportimit ishin të gjitha të denominuara në EUR ose me mbrojtje në EUR; ku menaxhuesit e këtyre instrumenteve përdorin derivate të valutës për të menaxhuar dhe kontrolluar riskun valutor. Një përjashtim për këtë është iShares MSCI US Qual ETF e cila ka aksione me bazë USD pa mbrojtje dhe që përfaqësonin 2.4% të mjeteve në datën e raportimit (2018: zero).

Meqë ka patur ekspozim të vogël direkt ndaj riskut valutor në datën e raportimit, nuk janë bërë analiza sensitiviteti në efektin e ndryshimeve të valutës në të ardhurat gjithëpërfshirëse për fund vitin më 31 dhjetor, 2018 dhe 2019.

3.8.5 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-MP nëse një klient ose palë tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale. Risku kreditor kryesisht buron direkt nga investimet në fletobligacionet e Thesarit të Kosovës si dhe afatizimet bankare, dhe përfaqëson riskun e dytë më të lartë për mjetet e FKPK-MP.

Matja e riskut kreditor

Vlerësimi i ekspozimit kreditor për qëllime të administrimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve, pasi ekspozimi ndryshon me ndryshimet në kushtet e tregut, përveç flukseve monetare dhe kalimin e kohës. Vlerësimi i riskut kreditor nënkupton vlerësim të mëtejshëm në lidhje me gjasat që të ndodhin mospagesat.

FKPK-MP mat riskun kreditor duke përdorur Probabilitetin e Mospagesës (PM), Ekspozimin në Mospagesë (ENM) dhe Humbjen marrë Parasysh Mospagesën (HPM). Kjo është metoda e përdorur me qëllim të matjes së Humbjes së Pritshme Kreditore (HPK) sipas SNRF 9.

Ekspozimet e kredive janë kategorizuar në një nga tre fazat, varësisht nga rritja e rrezikut kreditor që nga njohja fillestare e instrumenteve përkatëse të bartura me koston e amortizuar, përkatësisht: bonot / obligacionet e thesarit të Kosovës si dhe depozitat me afat me bankat komerciale.

Kur ka një rritje të ndjeshme në riskun kreditor, një instrument zhvendoset nga humbja e pritur 12-mujore në humbje të pritur përgjatë jetës.

Gjatë vlerësimit, risku fillestar kreditor i një instrumenti financiar matet kundrejt riskut të tanishëm kreditor, duke marrë parasysh jetën e mbetur të instrumentit.

Në fazat një dhe dy, të ardhurat nga interesi janë interesi efektiv mbi vlerën e bartur bruto; në fazën e tretë është interesi efektiv në koston e amortizuar.

Për të llogaritur humbjet e pritshme 12-mujore dhe përgjatë jetës, për instrumente përkatëse aplikohet modeli për risk kreditor (PM, HPM), parashikimet e bilancit (parapagimet, tërheqjet e objektit) dhe normat e interesit (faktorët e zbritjes).

Nga ana e riskut kreditor, modelet PM dhe HPM duhet të plotësojnë modelin e dëmtimit (zhvlerësimit).

Modeli i PM vlerëson probabilitetin e mospagesës (PM) në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Konsiderohen të gjitha informatat relevante;
- Rrethanat e tanishme ekonomike reflektohen duke përdorur vlerësimin "më të mirë" më shumë se atë "konservator";
- Siguron gjasat e ndodhjes së parazgjedhur brenda 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së instrumentit;
- Përfshin parashikimet ekonomike të ardhshme.

Modeli HPM vlerëson përqindjen e humbjes në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Konsideron të gjithë informacionin e duhur dhe përfshin elemente të parashikimit;
- Reflekton rrethanat aktuale ekonomike (dmth., përdor vlerësimin më të mirë dhe jo vlerëimin e rënies ekonomike);
- Konsideron vetëm shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt mbledhjes së arkëtimit.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8.5 Risku kreditor (vazhdim)

Modeli i dëmtimit për fletobligacionet e Thesarit të Kosovës

Modeli i dëmtimit për Thesarin e Kosovës merr parasysh historikun e mospagesës të Thesarit të Kosovës (çfarë nuk ka pasur), si dhe garancitë kushtetuese dhe ligjore që detyrojnë qeverinë të japë përparësi për shlyerjen e borxhit publik para çfarëdo pagesash të tjera. Modeli gjithashtu merr parasysh nivelin e borxhit publik dhe jetën e mbetur të instrumentit. Secilit skenar i jepet një probabilitet përkatës, i cili më pas përdoret për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore.

Nëse një instrument zhvendoset nga faza e parë në fazat dy ose tre varet nga dëshmitë objektive të dëmtimit ose nga të dhënat bazike makroekonomike si:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të shtetit të Kosovës; ose
- vonesa ose delikuenca në pagesat e interesit ose të kryegjësë; ose
- po bëhet e mundur që shteti i Kosovës të hyjë në falimentim apo riorganizim financiar; ose
- borxhi ndaj BPV-së tejkalon 80%.

Duke marrë parasysh inputet e mësipërme, të gjitha instrumentet e Thesarit të Kosovës janë vlerësuar duke përdorur modelin e dëmtimit të fazës 1, atë 12-mujor, dhe nuk pati lëvizje në faza gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2019. Shtesat neto të provizioneve të dëmtimit gjatë vitit ishin 144,985 EUR, duke bërë që bilanci përfundimtar më 31 dhjetor 2019 të jetë 678,408 EUR (2018: shtesat neto 380,888 EUR, dhe bilanc përfundimtar prej 533,423 EUR).

Modeli i dëmtimit për depozitat me afat

Modeli i dëmtimit për depozitat me afat me bankat lokale merr parasysh historikun e mospagesës nga bankat (çfarë nuk ka pasur), koeficientët bazikë financiarë dhe matje tjera, si dhe jetën e mbetur të instrumentit. Secilit skenar i jepet një probabilitet përkatës, i cili më pas përdoret për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore.

Nëse një instrument zhvendoset nga faza e parë në fazat dy ose tre varet nga dëshmitë objektive të dëmtimit ose matësat bazë siç janë:

- vonesa ose delikuenca në pagesat e interesit ose të kryegjësë të depozitave; ose
- po bëhet e mundur që banka të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar; ose
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës incion revokimin e licencës së bankës; ose
- Koeficienti i tashëm bie nën 0.9; ose
- Raporti kredi / depozit tejkalon 1.1 ose bie nën 0.4; ose
- Koeficienti i mjaftueshmërisë së kapitalit bie nën 8.5%; ose
- Përqindja e kredive të këqija tejkalon 13%.

Duke pasur parasysh inputet e mësipërme, të gjitha depozitat me afat janë vlerësuar duke përdorur modelin e dëmtimit të fazës 1, atë 12-mujor, dhe nuk pati lëvizje në faza gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2019. Shtesat neto të provizioneve për humbjen e pritshme kreditore gjatë vitit ishin 33,155 EUR, duke bërë që bilanci përfundimtar më 31 dhjetor 2019 të jetë 92,856 EUR (2018: shtesat neto 34,412 EUR dhe bilanci përfundimtar prej 59,702 EUR).

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8.6. Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato asete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

	Më 31 dhjetor 2019		Më 31 dhjetor 2018	
	Vlera bartëse EUR	Vlera reale EUR	Vlera bartëse EUR	Vlera reale EUR
Mjetet financiare				
Paraja në bankë	3,279,603	3,279,603	6,245,153	6,245,153
Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës	298,483,698	299,162,106	208,510,864	209,044,287
Afatizimet bankare	185,620,151	185,713,007	119,344,093	119,403,795
Kontributet dhe të arkëtueshmet e tjera	12,274,188	12,274,188	131,347,368	131,347,368
	499,657,640	500,428,904	465,447,478	466,040,603
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme	1,256,441	1,256,441	874,667	874,667
	1,256,441	1,256,441	874,667	874,667

3.8.7 Ekspozimi përmes investimeve indirekte

Shumica e mjeteve të FKPK-MP janë të investuara përmes fondeve të hapura investuese të cilat tregtojnë me klasa të ndryshme të asetëve dhe zbatojnë politika të ndryshme të investimit dhe të riskut. Si rezultat, mjetet e FKPK-MP i ekspozohen rreziqeve të ndryshme për investimet indirekte varësisht nga mjetet ku investon fondi i hapur investues.

Lista e plotë e rreziqeve të cilave iu kanë ekspozohuar fondet e hapura investuesu më 31 dhjetor 2019, mund të gjindet në prospektusin përkatës të secilit instrument, ndërkohë që rreziqet kryesore janë përmbledhur në vijim:

Instrumenti	Risqet kryesore
Vanguard – GSIF	Risku i çmimit Shtetëror/politik I ndjekjes së indeksit
AXA – GILB	Risku kreditor I palës tjetër I normave të interesit
BNY Mellon – RRF	Risku i çmimit Kreditor I palës tjetër I normave të interesit Valutor
Schroders – GDG	Risku i çmimit I palës tjetër Valutor I derivateve I normave të interesit I levave financiare
Nordea 1 – GSEF	Risku i çmimit I palës tjetër Shtetëror/politik I derivateve
Nordea 1 – SRF	Risku i çmimit Kreditor I palës tjetër Shtetëror/politik I derivateve
AXA – WFOI	Risku kreditor I palës tjetër
BNP Paribas – PDP	Risku kreditor I likuiditetit I palës tjetër Operativ I derivateve
Amundi – RPI2	Risku kreditor I likuiditetit I palës tjetër I derivateve
Amundi – 3M-I	Risku kreditor I palës tjetër
Corp Bond Eur ETF	Risku i çmimit I palës tjetër Shtetëror/politik
S&P500 Minvol ETF	Risku i çmimit I palës tjetër Shtetëror/politik
Amun EurCorp ETF	Risku i çmimit I palës tjetër Shtetëror/politik
MSCI USA Qual ETF	Risku i çmimit I palës tjetër Shtetëror/politik Valutor

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8.7 Ekspozimi përmes investimeve indirekte (vazhdim)

Kur të gjitha investimet, direkte dhe indirekte, merren parasysh, ekspozimi i mjeteve të FKPK-MP më 31 dhjetor 2019 ishte si në vijim:

Valutat - EUR: 69.3%; USD: 21.3%; GBP: 3.0%; JPY: 1.3%; CAD: 1.3%; DKK: 1.1%; Tjerat (neto): 2.7%.

Klasa e asetëve – Aksione: 34.9%; Borxh thesaresh: 23.7%; Borxh korporatash: 20.5%; Tregu i parasë: 20.6%; Derivate neto: 0.3%.

Klasifikimi i rejtingut të investimeve direkte në instrumente të borxhit dhe të tregut të parasë, si dhe ato indirekte përmes fondeve të hapura, është dhënë më poshtë. Përfshirë janë investimet indirekte në fondet me instrumente borxhi, ose 4.93% e asetëve të FKPK-PA, për të cilat vlerësimi nuk mund të merret. Nuk përllogaritet provizion për investimet indirekte meqë në fondet përkatëse të hapura ato maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Përshkrimi	Vlerësimet përkatëse	Përqindja e mjeteve të FKPK-së më 31 dhjetor 2019	Përqindja e mjeteve të FKPK-së më 31 dhjetor 2018
<i>Investimet direkte</i>			
Thesari i Kosovës	-	15.20%	12.43%
Depozitat	-	9.44%	7.10%
		24.64%	19.53%
<i>Investimet indirekte në instrumente borxhi</i>			
Të klasit të parë	AAA	4.87%	6.97%
E lartë	AA+ AA AA-	2.31%	7.22%
Mesatare e lartë	A+ A A-	5.90%	3.28%
Mesatare e ulët	BBB+ BBB BBB-	7.98%	5.10%
Spekulative	BB+ BB BB-	2.13%	1.27%
Më spekulative	B+ B B-	0.37%	0.64%
Rrezik substancial	CCC+	0.01%	0.02%
Jashtëzakonisht spekulative	CCC	0.02%	0.01%
Në mospagesë, me pak gjasa për kthim	CCC- CC C	0.00%	0.00%
Pa vlerësim	-	0.43%	0.54%
		24.02%	25.05%
<i>Investimet indirekte në instrumente borxhi</i>			
Të klasit të parë	AAA	0.01%	6.97%
E lartë	AA+ AA AA-	1.05%	0.10%
Mesatare e lartë	A+ A A-	3.75%	1.57%
Mesatare e ulët	BBB+ BBB BBB-	2.55%	0.31%
Më spekulative	B+ B B-	-	0.01%
Pa vlerësim	-	0.17%	0.54%
		7.53%	1.99%

4 PARAJA NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	2,955,546	6,245,153
Erste Bank Austri (brokeri)	324,057	-
Gjithsej paraja në bankë	3,279,603	6,245,153

Nga 1 janar 2018 deri më 30 qershor 2019 interesi negativ vjetor prej -0.40%; nga 1 korrik deri më 17 tetor 2019 interesi negativ vjetor prej -0.5%; dhe nga 18 tetor deri më 31 dhjetor 2019 interesi negativ vjetor prej -0.60%; është aplikuar mbi bilansin ditor të llogarisë së FKPK-MP me Bankën Qendrore të Kosovës. Shpenzimi total i interesit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte 99,699 EUR, nga të cilat në datën e raportimit 14,627 EUR ishin të pagueshme ndaj BQK (2018: shpenzimet 66,673 EUR nga të cilat në datën e raportimit 5,030 EUR ishin të pagueshme).

5 KONTRIBUTET DHE TË ARKËTUESHMET E TJERA

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Kontributet e arkëtueshme	12,274,188	11,347,368
Të arkëtueshmet nga tërheqjet prej fondeve të hapura	-	120,000,000
Gjithsej kontributet dhe të arkëtueshmet e tjera	12,274,188	131,347,368

Kontributet e arkëtueshme kanë të bëjnë me kontributet të pranuar në llogarinë rrjedhëse në BQK deri më datën 18 të muajit pas datave të raportimit dhe të cilat nuk janë shndërruar në aksione në datat e raportimit.

Të arkëtueshmet nga fondet e hapura kanë të bëjnë me mjetet e tërhequra gjatë një periudhe të caktuar të raportimit por që janë arkëtuar në periudhën e ardhshme raportuese.

6 INVESTIMET NË FONDET E HAPURA INVESTUESE

a) Investimet në fondet e hapura (në EUR)

							2019
Fondi	Shënimi	Më 1 janar	Investimet e reja	Rritja ose ulja	Tarifat e mbajura	Tërheqjet	Më 31 dhjetor
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	363,676,626	55,204,616	48,969,050	(365,610)	(420,000,000)	47,484,682
BNY Mellon – RRF	6.2	145,256,365	102,000,000	23,180,606	-	-	270,436,971
AXA – GILB	6.3	97,593,865	13,345	2,074,769	(153,678)	(70,000,000)	29,528,301
Schroders – SISF	6.4	9,812,299	52,000,000	574,969	-	(62,387,268)	-
Schroders – GDG	6.5	55,893,343	-	5,244,959	-	(17,500,000)	43,638,302
Nordea 1 – GSEF	6.6	162,607,446	108,000,000	28,881,121	-	(173,000,000)	126,488,567
Nordea 1 – SRF	6.7	124,005,629	88,000,000	17,042,015	-	-	229,047,644
Amundi – 3M-I	6.8	59,847,864	733,065,632	(830,703)	(221,064)	(517,998,964)	273,862,765
AXA – WFOI	6.9	53,906,903	39,100	5,740,987	(238,363)	(17,500,000)	41,948,627
BNP Paribas – PDP	6.10	52,220,239	50,000,000	9,763,153	(450,555)	-	111,532,837
Amundi – RPI2	6.11	102,509,778	26,000,262	7,190,867	(161,370)	(49,999,192)	85,540,345
Corp Bond Eur ETF	6.12	-	61,995,980	(642,957)	(46,473)	-	61,306,550
S&P500 Minvol ETF	6.13	-	45,927,155	4,532,116	(64,637)	-	50,394,634
Amun EurCorp ETF	6.14	-	61,998,114	(792,988)	(37,062)	-	61,168,064
MSCI USA Qual ETF	6.15	-	47,711,957	(29,170)	(2,768)	-	47,680,019
Gjithsej investimet në fondet e hapura		1,227,330,357	1,431,956,161	150,898,794	(1,741,580)	(1,328,385,424)	1,480,058,308

							2018
Fondi	Shënimi	Më 1 janar	Investimet e reja	Rritja ose ulja	Tarifat e mbajura	Tërheqjet	Më 31 dhjetor
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	368,189,871	32,509,398	(36,036,485)	(986,158)	-	363,676,626
BNY Mellon – RRF	6.2	108,940,067	110,000,000	(1,683,702)	-	(72,000,000)	145,256,365
AXA – GILB	6.3	100,550,642	49,414	(2,611,784)	(394,407)	-	97,593,865
Schroders – SISF	6.4	10,275,294	-	(462,995)	-	-	9,812,299
Schroders – GDG	6.5	113,300,190	36,000,000	(10,406,847)	-	(83,000,000)	55,893,343
Nordea 1 – GSEF	6.6	146,966,855	21,000,000	(5,359,409)	-	-	162,607,446
Nordea 1 – SRF	6.7	242,568,079	-	(7,562,450)	-	(111,000,000)	124,005,629
Amundi – 3M-I	6.8	27,942,054	97,000,402	(78,317)	(16,719)	(64,999,556)	59,847,864
AXA – WFOI	6.9	109,973,876	40,015,595	(8,365,851)	(716,717)	(87,000,000)	53,906,903
BNP Paribas – PDP	6.10	130,010,203	22,000,000	(8,775,311)	(1,014,653)	(90,000,000)	52,220,239
Amundi – RPI2	6.11	86,295,734	64,001,173	(5,533,651)	(253,115)	(42,000,363)	102,509,778
Pictet – HDS		33,137,645	-	(1,664,192)	-	(31,473,453)	-
Gjithsej investimet në fondet e hapura		1,478,150,510	422,575,982	(88,540,994)	(3,381,769)	(581,473,372)	1,227,330,357

6 INVESTIMET NË FONDET E HAPURA INVESTUESE (VAZHDIM)

b) Investimet në fondet e hapura (në njësi)

					2019
Fondi	Shënimi	Më	Investimet e reja	Tërheqjet	Më
		1 janar			31 dhjetor
		Njësi	Njësi	Njësi	Njësi
Vanguard – GSIF	6.1	20,867,975	2,972,007	(21,651,536)	2,188,446
BNY Mellon – RRF	6.2	113,075,171	74,298,882	-	187,374,053
AXA – GILB	6.3	639,834	87	(455,392)	184,529
Schroders – SISF	6.4	65,229	333,840	(399,069)	-
Schroders – GDG	6.5	347,866	-	(104,545)	243,321
Nordea 1 – GSEF	6.6	6,708,228	3,898,672	(6,462,452)	4,144,448
Nordea 1 – SRF	6.7	6,873,926	4,664,998	-	11,538,924
Amundi – 3M-I	6.8	57	696	(493)	260
AXA – WFOI	6.9	398,808	271	(122,901)	276,178
BNP Paribas – PDP	6.10	364,794	298,579	-	663,373
Amundi – RPI2	6.11	21	5	(10)	16
Corp Bond Eur ETF	6.12	-	457,000	-	457,000
S&P500 Minvol ETF	6.13	-	7,323,737	-	7,323,737
Amun EurCorp ETF	6.14	-	270,745	-	270,745
MSCI USA Qual ETF	6.15	-	530,229	-	530,229

					2018
Fondi	Shënimi	Më	Investimet e reja	Tërheqjet	Më
		1 janar			31 dhjetor
		Njësi	Njësi	Njësi	Njësi
Vanguard – GSIF	6.1	19,118,503	1,749,472	-	20,867,975
BNY Mellon – RRF	6.2	84,626,790	85,736,732	(57,288,351)	113,075,171
AXA – GILB	6.3	639,513	321	-	639,834
Schroders – SISF	6.4	65,229	-	-	65,229
Schroders – GDG	6.5	647,516	209,452	(509,102)	347,866
Nordea 1 – GSEF	6.6	5,899,914	808,314	-	6,708,228
Nordea 1 – SRF	6.7	12,888,846	-	(6,014,920)	6,873,926
Amundi – 3M-I	6.8	24	95	(62)	57
AXA – WFOI	6.9	751,958	276,157	(629,307)	398,808
BNP Paribas – PDP	6.10	842,199	146,921	(624,326)	364,794
Amundi – RPI2	6.11	17	13	(9)	21
Pictet – HDS		180,498	-	(180,498)	-

6 INVESTIMET NË FONDET E HAPURA INVESTUESE (VAZHDIM)

6.1 Vanguard Investment Series plc - Global Stock Index Fund Euro hedged (ISIN: IE00B03HD316)

Ky fond kërkon të sigurojë rritjen afatgjate të kapitalit duke ndjekur performancën e Morgan Stanley Capital International (MSCI) World Free Index (indeksi), indeks ky i peshuar dhe bazuar në madhësinë e kapitalit të kompanive në vendet e zhvilluara. Politika e investimeve e Global Stock Index Fund është që kryesisht të investohet në aksione të zakonshme. Investimet e FKPK-së në këtë fond blejnë aksione sipas Vlerës Neto të Mjeteve (VNM) për aksion në ditën relevante të afazimit. Ky fond nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +24.50% (2018: -9.51%) Tarifa e menaxhimit kalkullohet çdo ditë me normë vjetore prej 0.25% (2018: 0.25%) të mjeteve. Fondi po ashtu ofron rabat prej 0.12% në tarifën menaxhuese (2018: 0.12%) e cila riinvestohet në muajin pasardhës, gjë e cila bën që tarifa neto menaxhuese që ngarkon fondin të jetë 0.13% (2018: 0.13%) e mjeteve në vit. Tërheqja e 420,000,000 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshiu fitimin e realizuar prej 141,769,973 EUR.

6.2 BNY Mellon - Real Return Fund (ISIN IE00B504KX99)

BNY Mellon Real Return Fund është instrument i kthimit absolut i cili investon mjetet pjesërisht në para, fletobligacione dhe pjesërisht në aksione. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet dhe interesat reflektohen në VNM-në e fondit. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +12.35% (2018: -0.21%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet çdo ditë sipas normës vjetore prej 0.60% të mjeteve me fondin dhe paguhet ndaras nëpërmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Gjithsej tarifën që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2019 kapin shumën prej 1,246,615 EUR (2018: 488,895 EUR). Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.3 AXA - Global Inflation Linked Bonds Eur (ISIN LU0227145629)

AXA Global Inflation Linked Bonds është një instrument i kthimit absolut që pjesën dërrmuese të mjeteve investon në bono të mbrojtura nga inflacioni të emetuara nga shtetet sovraane dhe korporatat. Fondi nuk paguan dividend, kështu që të gjitha përfitimet dhe interesat reflektohen në VNM. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +6.94% (2018: -2.99%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet çdo ditë me një normë vjetore prej 0.40% (2018: 0.40%) të mjeteve me fondin; mirëpo, kur vlera e mjeteve është më e lartë se 50 milionë EUR, ofrohet rabati në normë vjetore prej 0.05% të mjeteve me fondin i cili përllogaritet në baza ditore dhe riinvestohet në muajin e ardhshëm, duke bërë kështu që tarifa neto menaxhuese të jetë 0.35% e mjeteve në vit. Tërheqja e 70,000,000 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshiu fitimin e realizuar prej 8,045,150 EUR.

6.4 Schroders - International Strategic Bond Euro Hedged (ISIN LU0201824265)

Schroders International Strategic Bond është fond i përbashkët me seli në Luksemburg i cili operon përmes investimeve në bono dhe instrumente të tjera financiare me kthim fikse dhe variabil të denominuara në valuta të ndryshme që emetohen nga qeveritë, agjencitë qeveritare, agjencitë mbikombëtare dhe korporatat gjithandej nëpër botë. Fondi nuk paguan dividend, kështu që të gjitha të ardhurat reflektohen në çmimin ofertues të fondit. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin deri në tërheqjen e plotë më 13 gusht 2019 ishte +3.92% (2018: -4.51% për komplet vitin). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në fund të çdo tremujori me normë vjetore prej 0.50% të mjeteve (2018: 0.50%), dhe paguhet veçmas përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Megjithatë, për vlerat e mjeteve me fondin më të larta se 100 milionë EUR, norma vjetore e tarifës reduktohet në 0.45% të aseteve. Gjithsej tarifën që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fundvitin 31 dhjetor 2019 kapin shumën prej 100,784 EUR (2018: 50,969 EUR). Tërheqja e plotë e 62,387,268 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshiu fitimin e realizuar prej 2,190,514 EUR.

6.5 Schroders - Global Diversified Growth Fund (ISIN LU0776411141)

Schroders - Global Diversified Growth Fund, është fond që ka një portofolio me klasa mikse të aseteve. Fondi nuk paguan dividend, kështu që të gjitha të ardhurat reflektohen në çmimin ofertues të fondit. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +11.62% (2018: -8.17%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në fund të çdo tremujori me normë vjetore prej 0.65% të mjeteve, dhe paguhet veçmas përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Gjithsej tarifën që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 kapin shumën prej 293,788 EUR (2018: 813,018 EUR). Tërheqja e 17,500,000 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshiu fitimin e realizuar prej 176,846 EUR.

6.6 Nordea 1 - Global Stable Equity Fund (ISIN LU0257969260)

Nordea 1 - Global Stable Equity Fund është një fond aktiv që kryesisht përmban aksione të korporatave globale me kthime, dividenda dhe qarkullimetë parasë stabile. Megjithatë, fondin mund t'i mbajë deri në 1/3 e mjeteve në para të gatshme ose t'i investojë ato në bono ose në instrumente të tjera të borxhit me qëllim të menaxhimit të riskut. Fondi nuk paguan dividend andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndyshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +25.91% (2018: -2.69%). Tarifa e menaxhimit kalkullohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.43% të mjeteve dhe paguhet përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Shuma e përgjithshme e tarifave të ngarkuara nga menaxheri i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte 414,968 EUR (2018: 689,736 EUR). Tërheqja e 173,000,000 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshiu fitimin e realizuar prej 30,597,957 EUR.

6 INVESTIMET NË FONDET E HAPURA INVESTUESE (VAZHDIM)

6.7 Nordea 1 –Stable Return Fund X EUR (ISIN LU0539147214)

Nordea 1 - Stable Return Fund është një fond aktiv që përmban aksione dhe fletobligacione të korporatave globale dhe letra me vlerë të qeverive, dhesynon të gjenerojë kthim nga të dyja klasat e mjeteve duke menaxhuar në të njëjtën kohë risqet përmes përdorimit strategjik të derivateve financiare. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +10.03% [2018: -4.14%]. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej: 0.56% të mjeteve dhe paguhet përmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në. Shuma e përgjithshme e tarifave të ngarkuara nga menaxhuesi i fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte 1,129,320 EUR [2018: 942,218 EUR]. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.8 Amundi – 3M (I) (ISIN FR000703813)

Amundi – 3M (I) është fond që bën investime në instrumente të parasë së gatshme dhe i cili synon të ofrojë likuiditet dhe siguri të lartë si dhe shërben si alternativë ndaj mbajtjes së keshit në Bankën Qendrore të Kosovës. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha humbjet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit të njësisë gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte -0.28% [2018: -0.32%]. Tarifat e menaxhimit kalkulohen në baza ditore me normë vjetore prej 0.057% të mjeteve e cila ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Kur vlera mesatare e mjeteve në një tremujor kalendarik i tejkalon 50,000,000 EUR, fondi ofron një rabat tarifor prej 0.012% të mjeteve i cili kryesisht re-investohet. Tërheqja e 517,998,964 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshinë humbjen e realizuar prej 535,321 EUR.

6.9 AXA - Optimal Income I EUR (ISIN: LU0184635471)

AXA - Optimal Income Fund është një fond aktiv që përmban aksione dhe fletobligacione të korporatave dhe letra me vlerë të qeverive, kryesisht nga Evropa, i cili ka për qëllim të gjenerojë një kthim absolut në planin afatgjatë nga të dyja këto klasa të instrumenteve financiare. Me qëllim të menaxhimit të riskut, përdorimi në shkallë të vogël i derivateve është i lejuar. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +12.37% [2018: -7.58%]. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.55% të mjeteve [2018: 0.55%] dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Tërheqja e 17,500,000 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshinë fitimin e realizuar prej 586,626 EUR.

6.10 BNP Paribas IP – Parvest Diversified Dynamic (ISIN: LU0102035119)

BNP Paribas IP – Parvest Diversified Dynamic është një fond me klasa mikse të mjeteve. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +17.79% [2018: -7.27%]. Tarifat e menaxhimit dhe të tjera kalkulohen në baza ditore me normë vjetore prej 0.76% të mjeteve e cila ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Deri më 31 mars 2019 fondi ofronte një rabat ndaj tarifave prej 0.11% të mjeteve, që i bën tarifat vjetore neto të ngarkuara nga ky fond 0.65% të mjeteve. Nga 1 prilli 2019 fondi ofron një rabat ndaj tarifave prej 0.22% të mjeteve, që i bën tarifat vjetore neto të ngarkuara 0.54% të mjeteve. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.11 Amundi – Amundi Rendement Plus I2 (ISIN: FR0011027283)

Amundi Rendement Plus I2 që është një fond me klasa mikse të mjeteve. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit për njësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishte +8.34% [2018: -4.38%]. Tarifat e menaxhimit dhe të tjera kalkulohen në baza ditore me normë vjetore prej 0.20% të mjeteve e cila ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Tërheqja e 49,999,192 EUR nga ky fond gjatë vitit 2019 përfshinë fitimin e realizuar prej 414,150 EUR.

6.12 iShares Core € Corp Bond UCITS ETF EUR (Dist) (ISIN: IE00B3F81R35)

Corp Bond Eur ETF është një fond i tregtuar në bursa dhe në përbërje ka bonot të korporatave të denominuara në euro, dhe së pari u investua në të gjatë gushtit 2019. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit të njësisë që nga investimi fillestar dhe deri më 31 dhjetor 2019 ishte -1.11%. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.20% të asetëve dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.13 iShares Edge S&P 500 Minimum Volatility UCITS ETF EUR Hedged (Acc) (ISIN: IE00BYX8XD24)

S&P500 Minvol ETF është një fond i tregtuar në bursa dhe në përbërje ka aksione të S&P500 me luhatshmëri të ulët, dhe së pari u investua në të gjatë qershorit 2019. Fondi paguan dividend andaj të gjitha përfitimet nuk reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit të njësisë që nga investimi fillestar dhe deri më 31 dhjetor 2019 ishte +9.73%. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.25% të asetëve dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6 INVESTIMET NË FONDET E HAPURA INVESTUESE (VAZHDIM)

6.14 Amundi IS EURO Corporates ETF-C EUR (ISIN: LU1681039647)

Amun EurCorp ETF është një fond i tregtuar në bursa dhe në përbërje ka bonot të korporatave të denominuara në euro, dhe së pari u investua në të gjatë gushtit 2019. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit të njësishë që nga investimi fillestar dhe deri më 31 dhjetor 2019 ishte -1.34%. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.16% të aseteve dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.15 iShares Edge MSCI USA Quality Factor ETF (ISIN: US46432F3394)

MSCI USA Qual ETF është një fond i tregtuar në bursa dhe në përbërje ka aksione kualitative nga SHBA pjesë e MSCI World Index, dhe së pari u investua në të gjatë dhjetorit 2019. Fondi nuk paguan dividend, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM-në e fondit. Ndryshimi i çmimit të njësishë që nga investimi fillestar dhe deri më 31 dhjetor 2019 ishte -0.07%. Tarifa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore me një normë vjetore prej 0.15% të aseteve dhe ndalet nga fondi, d.m.th. e redukton VNM-në. Gjatë vitit 2019 nuk kishte tërheqje të mjeteve nga ky fond.

6.13 Tarifat dhe rabatet e instrumenteve për investime të hapura

		Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019			Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018		
		Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	365,610	(167,640)	197,970	986,158	(510,133)	476,025
BNY Mellon – RRF	6.2	1,246,615	-	1,246,615	488,895	-	488,895
AXA – GILB	6.3	153,678	(9,194)	144,484	394,407	(49,301)	345,106
Schroders – SISF	6.4	100,784	-	100,784	50,969	-	50,969
Schroders – GDG	6.5	293,788	-	293,788	813,018	-	813,018
Nordea 1 – GSEF	6.6	414,968	-	414,968	689,736	-	689,736
Nordea 1 – SRF	6.7	1,129,320	-	1,129,320	942,218	-	942,218
Amundi – 3M I	6.8	221,064	(84,790)	136,274	16,719	-	16,719
AXA – WFOI	6.9	238,363	-	238,363	716,717	-	716,717
BNP Paribas – PDP	6.10	450,555	(106,478)	344,077	1,014,653	(147,058)	867,595
Amundi – RPI2	6.11	161,370	-	161,370	253,115	-	253,115
Corp Bond Eur ETF	6.12	46,473	-	46,473	-	-	-
S&P500 Minvol ETF	6.13	64,637	-	64,637	-	-	-
Amun EurCorp ETF	6.14	37,062	-	37,062	-	-	-
MSCI USA Qual ETF	6.15	2,768	-	2,768	-	-	-
Pictet – HDS		-	-	-	44,293	-	44,293
Gjithsej tarifa e rabate		4,927,055	(368,102)	4,558,953	6,410,898	(706,492)	5,704,406

7 FLETOBLIGACIONET E KOSOVËS DHE AFATIZIMET BANKARE

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Fletobligacionet e Kosovës		
Para provizioneve për humbjet e pritura kreditore	299,162,106	209,044,287
Provizionet për humbjet e pritura kreditore	(678,408)	(533,423)
Pas provizioneve për humbjet e pritura kreditore	298,483,698	208,510,864
Afatizimet bankare		
Para provizioneve për humbjet e pritura kreditore	185,713,008	119,403,795
Provizionet për humbjet e pritura kreditore	(92,857)	(59,702)
Pas provizioneve për humbjet e pritura kreditore	185,620,151	119,344,093
Fletobligacionet e Kosovës dhe afatizimet bankare	484,103,849	327,854,957

Provizionet për humbjet e pritura kreditore për instrumentet e borxhit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë nxjerrë në përputhje me modelin e humbjes së pritur kreditore siç detajohet në politikat e rëndësishme kontabël.

Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 për instrumentet e sipërme ishin:

	Fletobligacione të Kosovës	Afatizimet bankare	Instrumentet e borxhit
	EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2018	152,535	25,290	177,825
Shtesat e provizioneve për shkak të plasmaneve të reja	444,842	53,157	497,999
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit / çnjohjes	(63,954)	(18,745)	(82,699)
Lirimi i provizioneve për shkak të ndryshimit të riskut kreditor	-	-	-
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	380,888	34,412	415,300
Më 31 dhjetor 2018	533,423	59,702	593,125
Shtesat e provizioneve për shkak të plasmaneve të reja	269,870	71,295	341,165
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit / çnjohjes	(124,885)	(38,140)	(163,025)
Lirimi i provizioneve për shkak të ndryshimit të riskut kreditor	-	-	-
Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	144,985	33,155	178,140
Më 31 dhjetor 2019	678,408	92,857	771,265

7 FLETOBLIGACIONET E KOSOVËS DHE AFATIZIMET BANKARE (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2019, investimet e FKPK-MP në instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës të matura me kosto të amortizuar, përbëheshin nga 30 letra me vlerë me sasi nominale prej 297,230,000 EUR, me afat original të maturimit prej 12 muaj deri në 10 vjet, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 2.49 vjetësh dhe normë mesatare / kupon prej 1.91%. Më 31 dhjetor 2018 ato përbëheshin nga 25 letra me vlerë me sasi nominale prej 209,060,000 EUR, me afat original të maturimit prej 6 muaj deri në 10 vjet, jetëgjatësi të mbetur mesatare prej 2.79 vjetësh dhe normë mesatare / kupon prej 1.79%. Bonot e thesarit të Kosovës nuk kanë rejting.

Më 31 dhjetor 2019 investimet e FKPK-MP në depozitat me afat të matura me koston e amortizuar përbëheshin nga 33 depozita me banka me afat original të maturimit midis 1 dhe 3 vjet, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 1.16 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 1.48%. Bankat janë të gjitha banka komerciale të licencuara që veprojnë në Republikën e Kosovës (Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, Turkish Enterprise Bank, NLB Bank, Raiffeisen Bank Kosovo, ProCredit Bank, ISh Bankasi, dhe Banka Ekonomike).

Më 31 dhjetor 2018, investimet në depozitat me afat matur me koston e amortizuar përbëheshin nga 20 depozita me afat original të maturimit midis 1 dhe 3 vjet, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare prej 1.19 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 1.55%.

	Fletobligacione të Kosovës	Afatizimet bankare	Instrumentet e borxhit
	EUR	EUR	EUR
Më 1 janar 2018	94,892,605	50,554,121	145,446,726
Plasmanet e reja	177,350,917	106,000,000	283,350,917
Interesi i fituar	2,353,410	847,793	3,201,203
Interesi / kuponët e pranuar	(1,426,258)	(622,409)	(2,048,667)
Kryegjëja e maturuar	(64,278,922)	(37,401,000)	(101,679,922)
Lëvizja neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	(380,888)	(34,412)	(415,300)
Më 31 dhjetor 2018	208,510,864	119,344,093	327,854,957
Plasmanet e reja	140,001,490	141,538,000	281,539,490
Interesi i fituar	5,299,465	2,261,648	7,561,113
Interesi / kuponët e pranuar	(4,382,682)	(1,490,435)	(5,873,117)
Kryegjëja e maturuar	(50,800,454)	(76,000,000)	(126,800,454)
Lëvizja neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	(144,985)	(33,155)	(178,140)
Më 31 dhjetor 2019	298,483,698	185,620,151	484,103,849

8 DETYRIMET NDAJ FKPK-0

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve e rabatet - të pagueshme	553,030	415,160
Plus / (Minus): Diferenca nga refondimet e kontributeve të gabuara	113	(4,559)
Neto detyrimet ndaj FKPK-0	553,143	410,601

Më 31 dhjetor 2019 bilanci i tarifës së pagueshme në vlerë prej 553,030 EUR ka të bëjë me tarifën e FKPK-së të ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve të cilat nuk u transferuan tek FKPK-0 deri në datën e raportimit (2018: 415,160 EUR). Detyrimet për tarifa i shtohet ose zbritet diferenca midis vlerës së njësisë të tërhequra për qëllim të refondimeve (vlera e tërhequr) dhe shumën e refunduar tek përfituesi (kontributi nominal). Më 31 dhjetor 2019, bilanci i diferencave nga rimbursimet ishte 113 EUR, duke bërë që detyrimet neto ndaj FKPK-0 të jenë në shumën 553,143 EUR (2018: përkatësisht -4,599 EUR dhe 410,601 EUR).

Refondimet ndodhin kur, ajo që fillimisht është konsideruar si kontribut pensional dhe njësitë janë emtuar për të, dëshmohet të jetë paguar gabimisht ose të jetë mbipaguar. Në këto raste vetëm vlera nominale i refundohet paguesit.

9 DETYRIMET PËR AKSIONET E RIBLERA

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Detyrimet për refondime	6,976	130,346
Detyrimet për tërheqje të kursimeve	643,521	294,433
Gjithsej detyrime për aksionet e riblera	650,497	424,779

Më 31 dhjetor 2019 bilanci i mjeteve të pagueshme për shkak të refondimeve dhe të tërheqjeve të kursimeve (benefiteve) që nuk ishin transferuar tek përfituesit përkatës deri në datën e raportimit ishte 650,497 EUR (2018: 424,779 EUR).

10 JO-KONTRIBUTET

Transferet hyrëse në llogarinë e FKPK-MP në BQK për mbledhje kontributesh, të cilat në momentin e procesimit të ekstraktit bankar identifikohen se nuk janë kontribute pensionale (janë paguar gabimisht ose janë mbipagesa), klasifikohen si jo-kontribute dhe për to nuk emtohen aksione. Në të gjitha rastet e tjera për transferet hyrëse të kontributeve fillimisht emtohen aksione, e nëse më pas dëshmohet se ato kanë qenë arkëtime të gabuara, ato refundohen. Më 31 dhjetor 2019 bilanci i jo-kontributeve që nuk ishin kthyer ishte 38,174 EUR (2018: 34,257 EUR).

11 TË HYRAT E TJERA

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2019 Bordi Drejtues i FKPK-së vendosi t'i kthejë tek mjetet pensionale 2,300,000 EUR nga suficiti i FKPK-O për aktivitetet investuese (2018: 700,000 EUR).

12 TARIFAT E NGARKUARA MBI LLOGARITË E PJESËMARRËSVE

	Për fundvitin 31 dhjetor 2019	Për fundvitin 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Tarifa për aktivitetet investuese	6,941,657	6,447,812
Tarifa për aktivitetet operacionale	1,294,186	1,212,535
Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	8,235,843	7,660,347

Tarifat llogariten në baza ditore sipas formulës:

$$\text{Tarifa} = [\text{Mjetet bruto të pjesëmarrësve}] * [\text{Norma}] / [\text{Numri i ditëve kalendarike në vit}].$$

Gjithsej tarifa e ngarkuar mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve me qëllim të financimit të aktiviteteve të FKPK-së për fundvitin 31 dhjetor 2019 ishte 8,235,843 EUR (2018: 7,660,347 EUR).

Tarifat e aplikueshme vjetore për periudhën e raportimit, siç janë miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168, ishin si në vijim:

Prej	Deri	Tarifa për aktivitetet investuese	Tarifa për aktivitetet operacionale	Gjithsej Tarifat
1 janar 2018	31 janar 2018	0.393% p.v.	0.081% p.v.	0.474% p.v.
1 shkurt 2018	15 maj 2019	0.381% p.v.	0.071% p.v.	0.452% p.v.
16 maj 2019	31 dhjetor 2019	0.370% p.v.	0.069% p.v.	0.439% p.v.

13 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	Numri i llogarive	Numri i llogarive
Llogari pa tërheqje të kursimeve	618,218	582,740
Llogari me tërheqje të kursimeve	51,755	43,947
Gjithsej llogari	669,973	626,687

Një llogari me tërheqje të kursimeve paraqet llogaritë e kursimeve pensionale prej të cilave janë tërhequr kursimet pensionale për shkak se: (i) pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit (65 vjeçare) ose është bërë i paaftë për punë, ose (ii) pasardhësit, të konsideruar si trashëgimtarë të ligjshëm, kanë trashëguar kursimet pensionale të pjesëmarrësit të vdekur. Nga 669,973 pjesëmarrësit për të cilët FKPK-ja kishte hapur llogari të kursimeve pensionale deri në datën e raportimit, 379,827 sosh kishin kontribute që i përkisnin vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2019 (2018: 344,453 nga 626,687 llogaritë e hapura).

Kontributet në FKPK paguhen nga punëdhënësit në emër të të punësuarve të cilët janë rezidentë të Kosovës, me normën e kontributimit prej së paku 5% të të ardhurave bruto të punonjësit për të dy, punëdhënësin dhe të punësuarin. Së bashku me kontributet vullnetare, maksimumi që punëdhënësi dhe i punësuarit secili mund të kontribuojnë është 15% e të ardhurave bruto të punonjësit.

Punëdhënësit kanë për obligim të ngarkojnë në portalin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) listën e pagave në mënyrë që të sigurojnë fletëpagesën për një muaj të caktuar. Të vetëpunësuarit i bëjnë pagesat në baza tremujore. ATK-ja i mundëson FKPK-së të ketë qasje në këto shënime duke qenë gjithashtu përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve të punëdhënësve, si dhe për sforcimin e përmbushjes përmes lëshimit të gjobave ndaj punëdhënësve delikuentë.

Prejse portali i ATK-së për deklarim elektronik u iniciua dhe u bë obligativ në vitin 2012, shumica e kontributeve shpërndahen në llogari individuale që në tentimin e parë. Megjithatë, në disa raste, pagesa e kontributeve të bëra nga punëdhënësit nuk shoqërohet me informacion të saktë dhe / ose të mjaftueshëm; duke rezultuar në kontribute jo të alokuara në llogaritë individuale të pjesëmarrësve.

Kontributet e pa alokuara më 31 dhjetor 2019 arritën në 2,405,299 EUR (2018: 1,293,572 EUR). Arsyet kryesore përfshijnë: (i) punëdhënësi ka bërë pagesën, por nuk ka dorëzuar listën e kontribuesve; (ii) punëdhënësi ka dorëzuar listën e kontribuesve, por bën nënpagesë dhe / ose mbipagesë; (iii) informacioni personal i kontribuesve në listën e kontribuesve (ID dhe / ose emri) nuk është i vlefshëm; (iv) gjobat dhe interesat për pagesa të vonuara (që i paguhen ATK-së) përfshihen në pagesa; dhe (v) burimi i pagesës (punëdhënësi) nuk është identifikuar ende.

Administrata e FKPK-së bën çmos për të zgjidhur rastet e kontributeve të paalokuara. Nëse megjithatë, kanë kaluar gjashtë ose më shumë vite nga pagesa e kontributit dhe përkundër përpjekjeve më të mira të administratës kontributi mbetet i pa alokuar, paragrafi 3 i nenit 3 të Ligjit Nr. 05/L-116 për ndryshimin e paragrafit 7.11 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë, lejon riblerjen e njësive të kontributeve të tilla dhe vlerat që rezultojnë nga tërheqjet e tilla t'i paguhen Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) përmes Administratës Tatimore të Kosovës. Gjatë vitit 2019 nuk kishte riblerje sipas këtij provisioni, duke bërë që vlerat për bartje në BKK të jenë zero EUR (2018: 1,622,498 EUR).

Gjithsej kontributet e paalokuara si përqindje e gjithsej kontributeve të arkëtuara paraqiten në vijim:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
	EUR	EUR
Kontributet e paalokuara (të njësuar në datën e raportimit)	2,405,299	1,293,572
Kontributet kumulative të njësuar deri në datën e raportimit	1,781,446,174	1,594,824,669
Kontributet e paalokuara si përqindje e kontributeve të njësuar deri në datën e raportimit	0.135%	0.081%

13 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE (VAZHDIM)

Një metodë tjetër e vrojtimit të progresit të procesit të alokimit është krahasimi i fondeve të alokuara dhe mjeteve neto nën menaxhim të njësuara, si në vijim:

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
		Vlera në EUR	Vlera në EUR
Mjetet neto të pjesëmarrësve		1,978,459,507	1,691,903,168
<i>Përshtatur për:</i>			
Kontributet e arkëtueshme të panjësuar në datën e raportimit	5	(12,274,188)	(11,347,368)
Bilancin e provizionit për humbjet e pritura kreditore	7	771,264	593,125
Mjetet neto të njësuara të pjesëmarrësve		1,966,956,583	1,681,148,925
Bilanci i fondeve në llogaritë individuale		1,964,366,263	1,679,863,025
Përqindja e mjeteve neto të njësuara të pjesëmarrësve në llogaritë individuale		99.87%	99.92%

14 TËRHEQJA NË FAZA E BENEFITEVE

Sipas Rregullores për tërheqje të kursimeve pensionale, të ndryshuar nga BQK-ja në gusht 2017 pjesëmarrësit që me rastin e pensionimit në llogaritë e tyre në FKPK kanë bilanc më të lartë se pragu prej 3,000 EUR duhet t'i tërheqin kursimet e tyre në faza, mirëpo kanë edhe opcionin që 20% të bilancit ta tërheqin menjëherë (2018: pragu prej 3,000 EUR). Pjesëmarrësit pranojnë pagesa mujore në shumën prej 1% të vlerës së përgjithshme të llogarisë së tyre në momentin e pensionimit ose 200 EUR, cilado që është më e lartë (2018: 1% ose 200 EUR, cilado që është më e lartë). Rregullat mbi tërheqjet në faza vlejné përderisa anuitetet nuk ofrohen në Kosovë. Në momentin e pensionimit i gjithë bilanci i llogarisë së pjesëmarrësit, minus pjesën e tërhequr menjëherë, transferohet në bankën komerciale të kontraktuar për të ofruar shërbimin e tërheqjes në faza, dhe mjetet e tilla nuk llogariten më si mjete të FKPK-MP. Personat që në momentin e pensionimit kanë bilanc më të ulët sesa pragu vazhdojnë t'i përfitojnë kursimet në një pagesë të vetme.

15 PASQYRA E LËVIZJEVE SË NJËSIVE TË PJESËMARRËSVE

	Shënime	2019	2018
		Njësitë	Njësitë
Më 1 janar		1,211,680,717	1,115,941,202
Njësitë e emetuara për kontributet e arkëtuar		126,442,738	119,032,107
Njësitë e riblera për shkak të tërheqjeve të kursimeve		(35,588,488)	(21,572,925)
Njësitë e riblera për shkak të refondimeve		(441,768)	(569,693)
Njësitë e riblera për shkak të mjeteve të pa alokuara		-	(1,149,974)
Më 31 dhjetor		1,302,093,199	1,211,680,717
Neto mjetet e njësuara të pjesëmarrësve	13	1,966,956,583	1,681,148,925
Vlera e mjeteve neto për aksion në datën e raportimit		EUR 1.5106	EUR 1.3875

16 NGJARJET PAS PERIUdhËS SË RAPORTIMIT

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka ndikuar rëndë në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset janë duke u detyruar të ndërpresin ose kufizojnë punën për periudha të gjata ose periudha të pacaktuara kohore. Masat e ndërmarra për të parandaluar përhapjen e virusit, përfshirë këtu edhe ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin social dhe mbylljen e shërbimeve jo esenciale kanë shkaktuar pengesa të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve po ashtu kanë përjetuar një luhatshmëri të lartë, si dhe dobësim të konsiderueshëm. Përderisa qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për t'i stabilizuar kushtet ekonomike, megjithatë kohëzgjatja dhe shtrirja e ndikimit nga pandemia COVID-19 dhe efektiviteti i reagimit nga qeveritë dhe bankat qendrore mbeten të paqarta në këtë kohë.

Rreziku i përgjithshëm ndaj operimit

Këto ngjarje e kanë penguar, por nuk e kanë ndalur, funksionimin normal të FKPK-së. Të gjitha operacionet janë duke u trajtuar, si dhe shërbimet janë duke u ofruar, përmes përdorimit të një pjese të stafit në zyrë dhe të tjerët që punojnë nga shtëpia. Pozicioni financiar i FKPK-MP mbetet shumë i qëndrueshëm marrë parasysh natyrën afatgjatë të investimeve, likuiditetin e lartë të instrumenteve të përdorura për investime, dhe nivelit të ulët të tërheqjeve krahasuar me kontributet e arkëtuara që nevojiten për t'i realizuar ato tërheqje.

FKPK-ja ka vendosur që këto ngjarje janë ngjarje pasuese që nuk kërkojnë përshtatje. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve nga (dhe për) vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 nuk janë përshtatur që të pasqyrojnë ndikimin e tyre. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, e as ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e FKPK-MP për periudhat e ardhshme.

Rënia e vlerës së drejtë të investimeve

Marrë parasysh këto ngjarje, Bordi Drejtues i FKPK-së ka ndërmarrë masa për të ulur në mënyrë drastike alokimet në aksione në favor të parasë së gatshme. Kjo ka ndihmuar që të amortizohet ndikimi i rënies së çmimeve të investimeve me vlerë të drejtë në portofolin e përgjithshëm të FKPK-MP. Çmimi i njësishëm të FKPK-MP u ul për -4.66% për vitin deri më 31 mars 2020, gjersa në periudhën e njëjtë indekset kryesore botërore kanë rënë mes -30% dhe -20%. Pas një serie të tërheqjeve dhe rënies së çmimeve të investimeve me vlerë të drejtë, më 31 mars 2020 ekspozimi ndaj investimeve me vlerë të drejtë ishte në vlerë 1,364,353,783 EUR.

Këto ndryshime pasuese në vlerën e drejtë të investimeve të FKPK-MP nuk reflektohen në pasqyrat financiare më dhe për 31 dhjetor 2019.

Më 31 dhjetor 2019, përpos të shpalosurave sipër, nuk ka ngjarje të tjera të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalosje të mëtejshme në këto pasqyra financiare.

AUTOR:
JETON DEMI

DIZAJNI DHE FAQOSJA:
TESA GASHI

FOTOGRAFIA E BALLINËS:
KORTEZI E ARBEN LLAPSHTICËS

E MIRATOI PUBLIKIMIN:
BORDI DREJTUES I FKPK-SË

ADRESA
Rr. "Agim Ramadani" #182-184
10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL DHE UEB
info@trusti.org
www.trusti.org

